



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor
“Inxhinieri Mekanike”
“Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Altin Dorri

Dr. Erald Piperi

Maj/2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për Programin e studimit: Bachelor në “Inxhinieri Mekanike”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare (Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Inxhinieri Mekanike” ¹
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 832, datë 04.06.2008 si Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) në Inxhinieri Mekanike , me drejtime: “ <i>Inxhinieri Mekanike</i> ” dhe “ <i>Inxhinieri Navale</i> ”
5	Urdhëri/Vendim/VKM i riorganizimit:	-
6	Regjistrimi i formës së diplomës:	UMASR Nr. 439, datë 09.09.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	S’ka
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	JO
13.1	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13.2	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
15	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Për vitin akademik 2020-2021 Stafi akademik përbëhet nga: 21 PAE /0 PAK
16	Numri i studentëve (per tre vitet e fundit):	113 Studentë
17	Komente / të tjera:	-

¹ Në dokumentin e hapjes, VKM Nr. 832, datë 04.06.2008, ky program hapet si **Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) në Inxhinieri Mekanike**, me drejtime: “*Inxhinieri Mekanike*” dhe “*Inxhinieri Navale*”. Në Urdhërin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 439, datë 09.09.2011, për aprovimin e modelit të diplomës, aty pasqyrohen si dy programe të ndryshme. Gjithashtu në VKM-të e kuotave në të gjithë vitet këto programe kanë pasur kuota të pavaruara nga njëra tjetra, ç’ka sipas UV dëshmon se nuk është një program studimi me dy profile, por janë dy programe të ndryshme studimi. Njëkohësisht edhe në vendimet e Senatit ato trajtohen si programe të ndryshme studimi. Bazuar sa më lart, ky program është ndarë më vete.

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike ofruar nga Universiteti Vlorës është hapur duke u mbështetur në VKM Nr. 832, datë 04.06.2008. Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjive Detare (DITD), pjesë e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore.

Si bazë për hapjen e këtij programi ka qenë: përvoja e fituar nga programi studimit në Inxhinieri Navale, kualifikimet e stafit akademik në këtë fushë, nevojat e industrisë dhe ekonomisë rajonale për këtë program studimi si dhe bashkëpunimet me partnerët akademikë vendas dhe ndërkombëtarë. Hapja e këtij programi studimi është mbështetur tërësisht në kuadrin ligjor për arsimin e lartë në RSH. Fillimisht si model për programin mësimor është shfrytëzuar nga univeristetet amerikane, ndërsa aktualisht po punohet për t'u përafuar me kurrikulat e universiteteve rajonale (në Ballkan dhe më gjerë). Gjithë ndryshimet e kryera janë bërë duke u mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi (VKM nr. 41, datë 24.01.2018). Programi studimit është i organizuar në module lëndore të cilat kanë peshën e tyre shprehur në kredite ECTS. Në total programi ka 180 kredite ECTS.

Qëllimi i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike është të formojë inxhinierë të ardhshëm mekanikë të aftë: *të konceptojnë, projektojnë, zhvillojnë, prodhojnë, drejtojnë dhe mirëmbajnë makineri dhe sisteme mekanike të thjeshta dhe komplekse që përdoren në çdo fushë të jetës, duke përfshirë dhe kompetenca profesionale në disipinat karakterizuese të inxhinierisë mekanike, si: Teknologji Mekanike, Projektim Sistemesh Mekanikë, Sisteme Termikë dhe Fluidikë, etj.* Përmes njohurive të fituara në këtë program inxhinieri ardhshëm është i aftë të zgjidhë probleme komplekse që do të përballen në sektorin e mekanikës.

DITD si njësia bazë për ofrimin e këtij programi studimi ka në organikën e vet një staf akademik prej 10 pedagogësh, nga të cilët 2 Prof. Asoc., 4 Lektorë (Doktorë Shkencash) dhe 4 Asistentë Lektorë (Master Shkencor). Stafi ndihmës ka 1 laborant (karakter mësimor) dhe 1 staf ndihmës me karakter administrativ. Ky staf është një garanci për mbarëvajtjen dhe ardhmërinë e këtij programi studimi.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i akreditimit të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike ka filluar qysh në vitin 2019 përmes etapave të vlerësimit të brendëshëm dhe kërkesës së Rektorit të Univeristetit Vlorës drejtuar ASCAL përmes aplikimit online në sistemin AMS (formulari aplikimit ngarkuar elektronikisht dhe përcjellë me shkresën nr. Prot. 687/1, datë 22.07.2019). Pas shqyrtimit nga ASCAL të përputhshmërisë ligjore lidhur me këtë program dërgohet në Universitetin e Vlorës axhenda për këtë proces akreditimi. Në muajin Mars 2020 ASCAL përzgjedh dy vlerësuesit e jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike:

Prof. Asoc. Altin Dorri

Dr. Erald Piperi

Në datë 9.6.2020 është organizuar në ambjentet e ASCAL trajnim me dy vlerësuesit e jashtëm lidhur me procedurat që ndiqen për këtë proces si dhe dokumentacionin e nevojshën për tu analizuar dhe dokumentacioni që do të prodhohet nga ky proces akreditimi. Vlen të theksojmë se për shkak të pandemisë COVID-19 ky proces është shtyrë për tu mbyllur në fillim të viti 2021.

Hartimi Raportit Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) ka kaluar në këto faza:

- Hartimi planit të punës me detyrat e secilit anëtar të grupit,
- Studimi dhe analizimi dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e ASCAL nga Universiteti Vlorës, për të vlerësuar çdo kriter dhe standart,
- Realizimi vizitës (online) të GVJ në ambjentet e Universitetit të Vlorës (gjatë periudhës 4-5 Shkurt 2021),
- Hartimi raportit draft (RVJ),
- Hartimi I raportit përfundimtar (RVJ),

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, ME. Renata Qatipi.

Shënim: Për shkak të Pandemisë së COVID-19, komunikimi me IAL Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132 datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91 datë 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190 datë 19.03.2020.

Më datë 06.05.2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare, Nr. 1/38 Prot., datë 06.05.2021 "Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm", Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

UV përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft-Raportin, me shkresë Nr. 815/1 Prot., datë 12.05.2021 "Përcjellje e komenteve mbi draft Raportin e vlerësimit të jashtëm".

Në këtë dokument institucioni ka komente për Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm. GVJ, pasi u njoh me komentet e UV sqaron si më poshtë:

Konstatimi i GVJ në Draft Raport [Standardi II.5. (Kriteri 1)]:

Nga verifikimi i personelit akademik i përfshirë në mësimdhënje, konstatohet një qëndrueshmëri në stafin akademik.

Nga verifikimi i të dhënave statistikore, u konstatua se për vitet e fundit 100 % e ngarkesës mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv. Numri mesatar i lëndëve/moduleve semestrale që mban një pedagog është 5 lëndë, Evidence RVB, tabela 4.

Mbështetur në udhëzimin 37, datë 04.12.2018, pika a.ku jepet riformulimi i pikës 6 të Udhëzimit 29 lejohet të mbahen deri në 3 (tre) lëndë në semester".

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 219 Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Page 4

Komenti GVB-DITD: GVB-DITD sygjeron një riformulim të kësaj pike si më poshtë:

Nga verifikimi i të dhënave statistikore, u konstatua se për vitet e fundit 100 % e ngarkesës mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv. Numri mesatar i lëndëve/moduleve semestrare që mban një pedagog është 5 lëndë, përgjatë vitit akademik (2 semestra). Evidence RVB, tabela 4.

Mbështetur në udhëzimin 37, datë 04.12.2018, pika a.ku jepet riformulimi i pikës 6 të Udhëzimit 29 lejohet të mbahen deri në 3 (tre) lëndë në semestër.

Komenti i GVJ: GVJ pasi rishyrtoi dokumentacionin, e merr në konsideratë komentin e IAL dhe Raporti ndryshon.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinieri Mekanike”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Hapja e këtij programi studimi është mbështetur tërësisht në kudarim ligjor për arsimin e lartë në RSH [shih Evidenca I.1]. Programi i studimit Bsc. Inxhinieri Mekanike jo vetëm që nuk bie ndesh me Interesat Kombëtare Shqiptare, por synon të mbështes zhvillimet rajonale në Rajonin e Jugut, duke qenë i vetmi Universitet Rajonal, që ofron programe studimi në fushën e Inxhinierisë Mekanike. Ky program është hartuar në harmoni të plotë me dokumentat bazë të Universitetit të Vlorës [Statutin e UV, Rregulloren e Universitetit Ismail Qemali të Vlorës, si dhe planin Strategjik të Zhvillimit të tij]. Kështu program mbështetet në misionin e UV për të përgatitur specialistë të lartë dhe shkencëtarëve të rinj, në përputhje me prioritetin e zhvillimit të vendit [Neni 3 i Statutit të UV]. Në Statutin e UV [Neni 4 i Statutit, Evidenca A] theksohet se UV ka për qëllim zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës, ekonomisë në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për rritjen e mirëqënies dhe dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente. Gjithashtu në Rregullren e UV dhe në Strategjinë e Zhvillimit të UV [Evidencat B dhe C] cilësohet se: i) ofron programe rigorozë edukimi që synojnë të zhvillojnë mjeshtëritë, njohuritë, dhe aftësitë e duhura për të bërë një jetë aktive dhe të sukseshme si dhe për të qënë qytetarë të mirë [Neni 4 i Rregullores së UV]; ii) politika e zhvillimit të UV-së, orientohet në krah të politikave kombëtare [Pika 2.4 e Strategjisë Zhvillimit të UV].
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Dokumenti bazë i UV [Statuti i UV] cilëson qartësisht se baza e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor janë: traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, të gërshetuara me standartet më të mira botërore përgjithësisht dhe ato Europiane në vecanti [Neni 5, Evidenca A]. Në këtë kuadër dhe programi studimi në Inxhinierinë Mekanike synon të ruajë dhe konsolidojë traditën në fushën e Inxhinierisë Mekanike dhe ta vendos atë në funksion të zhvillimeve të vendit dhe rajonit përmes formimit të specialistëve të lartë në fushën mekanike me formim akademik sipas standarteve dhe zhvillimeve kombëtare dhe ndërkombëtare.
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi studimit Bachelor në Inxhinieri mekanike është hartuar plotësisht në përputhje me qëllimin dhe misionin e UV [Neni 3 i Statutit të UV]. Kështu në Statutin e UV [Neni 6] cilësohet se programet e studimit dhe projektet shkencore që hartohen prej tij “janë në përputhje me objektivat e tij të politikës arsimore, të kërkimit shkencor, të mësimdhënies dhe në respektim të lirisë së secilit” [Evidenca A]. Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike ka specifikë të veçantë sepse është i vetmi program studimi që ofrohet në Universitetet Rajonale duke i mundësuar UV-së krijimin e një profili të veçantë institucional në dallim nga Universitetet e tjera Rajonale. [Evidenca I.1]

Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Hartimi dhe hapja e këtij program studimi është bërë duke patur parasysh nevojat e industrisë dhe ekonomisë rajonale (rajoni Vlorë - Fier) për këtë program studimi si dhe bashkëpunimet me partnerët akademikë vendas dhe ndërkombëtarë. Ky program studimi është hapur pas krijimit të traditës nga Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare duke ofruar programe studimi inxhinierike si ai në Inxhinieri Navale, i hapur qysh me krijimin e Universitetit të Vlorës [Evidenca I.2].			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Në dokumentat bazë të UV, si Statuti i UV-së [Neni 3] dhe Rregullorja e UV-së [Neni 4] cilësojnë në mënyrë të qartë se mësimdhënia në Universitetin e Vlorës shkon kah politikës dhe strategjisë Institucionale të zhvillimit të Universitetit [shih Evidencat A dhe B]. Po ashtu dhe Strategjia e zhvillimit të UV-së përcakton se roli dhe misioni i UV-së, bazohet në këto shtylla kryesore: Mësimdhënia dhe Studimi; Profili Institucional; Edukimi i vlerave, Kërkimi Shkencor; Infrastruktura; Bashkëpunimi/ Partneriteti; Ndërkombëtarizimi; Sigurimi i Cilësisë dhe Standarteve; Përfshirje dhe përgjegjësi sociale [Evidenca C]. Po në këtë linjë dhe vetë Strategjia e Zhvillimit të Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare (DITD) [Evidenca I.3], është hartuar në përputhje të plotë me Strategjinë Institucionale.</p> <p>Programi i Studimit Bsc.Inxhinieri Mekanike është konceptuar në harmoni me statutin, rregulloren dhe me strategjinë e zhvillimit të UV-së dhe DITD-së. [Evidenca I.1]. Karakteristikat e këtij programi studimi, burimet njerëzore në dispozicion të programit të studimit, projektet ndërkombëtare në të cilat Departamenti është i përfshirë [Evidenca I.5], shkojnë kah zbatimit dhe përmbushjes së objektivave strategjike të parashikuara në strategjinë e zhvillimit të UV-së.</p>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Si njësi bazë përgjegjëse për realizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike është Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare (DITD) [Evidenca I.1, I.5 dhe I.6]. DITD është njësi bazë akademike e Universitetit Ismail Qemali të Vlorës [Neni 10 Statuti i UV-së, Evidenca A] dhe si pjesë e strukturës organizative të Fakultetit të Shkencave Teknike [neni 4- Rregullore e FSHT-së, Evidenca I.5].</p> <p>Ky program studimi ka si dokument bazë të tij rregullator “Rregullorja e programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike”, e cila përcakton respektimin e dokumentave bazë të UV (Statutit dhe Rregullores së UV-së), si dhe të gjithë kuadrit ligjor në fuqi [Evidenca I.1]. Fushat dhe drejtimet akademike në mësimdhënie përcaktohen në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Teknike (FSHT) (Neni 3) [Evidenca I.5].</p>

<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Emërtesa e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike përputhet plotësisht me profilin institucional dhe drejtimet akademike të UV, FSHT dhe DITD, duke mos çenuar profilin institucional dhe akademik të UV. Neni 1 i Rregullores së Programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike [Evidenca I.1] përcakton qartësisht se ai është ndërtuar në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e UV-së, Rregulloren e FSHT-së, Rregulloren e DITD-së, si dhe kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, gjë që mundëson që ky program studimi të ofrohet në përputhje me drejtimet akademike të institucionit si dhe të zbatohet duke respektuar kuadrin ligjor dhe institucional në fuqi.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

<p>Standardi I.3 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Objektivat e programi të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike janë përcaktuara në nenin 4 të Rregullores së programit të studimit, ku përfshihen edhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të këtij programi studimi [Evidenca I.1]. Në nenin 4 të Rregullores së programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekanike”, cilësohet qëllimi i programit që është: <i>të formojë inxhinierë mekanike që të jenë në gjendje të konceptojnë, projektojnë, zhvillojnë, prodhojnë, drejtojnë dhe mirëmbajnë makineri dhe sisteme mekanike të thjeshta dhe komplekse, që përdoren në të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë kryesisht njohuri dhe kompetenca profesionale në disiplinat karakterizuese si projektimin e sistemeve fluidike dhe termike, mekanikën e materialeve, projektimin e sistemeve mekanike, motorët me djegie të brendshme.</i> Gjithashtu ky program studimi është hartuar sipas modeleve dhe eksperiencave të universiteteve të huaja partnere si dhe Universitetit Politeknik të Tiranës. Kjo ka lehtësuar dhe garantuar një mobilitet më të mirë kombëtar dhe ndërkombëtar Universitar.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Një ndër prioritetet dhe qëllimet e UV-së është që të informojë dhe orientojë studentët drejt një karriere sa më të suksesshme. Për këtë UV qëndron në koherencë të plotë me zhvillimet në vend dhe ato rajonale, duke ndjekur vazhdimisht ndryshimet e kërkesavë të biznesit, të cilat shërbejnë si bazë dhe një feedback i nevojshëm për ndryshimet në programet mësimore apo dhe për hapjen e programeve të reja. Pranë UV-së për këtë qëllim është ngritur dhe funksionon prej vitesh Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA). Qëllimi kryesor i kësaj qendre është që të informojë, orientojë dhe mbështesë studentët e UV-së, për t'i paraprirë një karriere të suksesshme.</p> <p>Në këtë linjë dhe DIDT, si një nga njësitë më të vjetra dhe të kualifikuara të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe UV-së, ka një eksperiencë dhe nivel të lartë kualifikimi në fushat e inxhinierisë mekanike dhe navale, gjë që i mundëson të përditësojë programet për të përmbushur nevojat lidhur me aftësitë dhe kompetencat e tregut të punës. Shumë nga këto kompetenca janë</p>

	<p>të pasqyruara në këto dokumenta të rëndësishëm: Strategjia e DITD [Evidenca I.3], Guida e Studentit [Evidenca I.7], Rregullore e programit të studimit [Evidenca I.1]. Për realizimin me sukses të këtyre proceseve UV dhe DITD në veçanti ka qënë në kontakt dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në projekte të ndryshme [shih Evidenca I.4] si dhe në dokumente të tjera si Guida e studentit, [Evidenca I.7], Raportet e analizës vjetore, p.sh. 2018, 2019 [Evidenca I.8].</p> <p>UV/ DITD nuk ka realizuar studime të mirëfillta për tregun e punës, si përpara hyrjes dhe pas daljes së studentëve. UV/DITD nuk ka bërë një studim të tregut nëpërmjet pyetësorëve, por meqënëse programi mban parasysh zhvillimin ekonomik të vendit dhe perspektivën e zhvillimit evropian, kemi arritur në përfundimin se për këtë profesion janë të interesuar studentët, si brënda ashtu edhe për shqiptarët jashtë vendit. Një analizë e tregut të punës në mënyrë indirekte është munduar të kryhet përmes realizimit të praktikave mësimore të studentëve dhe feedback-ut të ardhur nga kompanitë dhe firmat ku kryhet kjo praktikë. Gjithshtu përmes dhomave të tregëtisë të rajonit Fier-Vlorë janë përpjekur të marrin listën dhe kontakte me kompani që operojnë në fushën e inxhinierisë mekanike [shënime gjatë vizitës monitoruese në UV].</p> <p>UV nëpërmjet Qendrës së Karrierës dhe Alumni organizon pothuaj çdo vit panairin e Punës, tashmë kthyer në një traditë në UV. Qëllimi i tij është:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të ofrojë mundësi për punëdhënësit dhe studentët të cilët janë të interesuar të vendosin marrëdhënie pune. 2. Të përqëndrojë mundësitë për angazhimin e studentëve, në kohë të plotë, në kohë të pjësëshme dhe praktika profesionale. 3. Përmes panairit të Punës i jepet mundësia kompanive të promovojnë shërbimet e tyre, si dhe për të përzgjedhur studentët nëpërmjet realizimit të intervistave të punës më ta. [http://www.univlora.edu.al/alumni]. <p>Një nga funksionet QKA, është të gjurmojë ecurinë e studentëve të UV-së në tregun e punës, pasi ata përfundojnë studimet dhe diplomohen. Universiteti nuk disponon statistika zyrtare mbi punësimin e studentëve me detaje në çdo fushë edukimi, megjithatë ekziston një database [Evidenca I.9].</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike qoftë në structure por dhe në përmbajtjen lëndore të tij është në përputhje të plotë me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Rezultatet e pritshme të të nxënit dhe konceptet thelbësore pasqyrohen në syllabuset lëndore sipas formatit të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. [Evidenca I.10]. Kompetencat e fituara garantojnë që studentët të përvetësojnë dije, aftësi dhe shkathtësitë e nevojshme për t’ju përgjigjen nevojave të tregut të punës duke lehtësuar kështu punësimin e tyre. Në kuadër të projektit TEMPUS MARED (Modernising and harmonizing maritime education in Montenegro and Albania – MarED) është kryer riorganizimi i programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Navale (http://www.mared.ac.me/index-2.1.html).</p> <p>Por për shkak të ngjashmërisë shumë të madhe që kanë programet e studimit me njëra-tjetrën, ky riorganizim ka ndikuar edhe programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike. Gjatë riorganizimit është synuar që</p>

	programi të përafrohej në mënyrë të konsiderueshme me programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike të Universitetit Politeknik të Tiranës. Gjatë imlementimit të projektit MARED, është diskutuar dhe riformatimi e riorganizimi i programit Bachelor në Inxhinieri Mekanike me koleget e Universiteteve partnere të projektit, duke përfutuar kështu nga eksperiencia e tyre [Evidenca I.11].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Universiteti i Vlorës, është Institucion publik i Arsimit të Lartë dhe është krijuar në 10 tetor 1994, me VKM 105, datë 28.02.1994, në fillim me tre fakultete:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Fakultet i Tregëtisë 2- Fakulteti i Inxhinierisë Detare 3- Fakulteti i Infermierisë <p>Universiteti i Vlorës është riorganizuar me VKM Nr. 822, datë 05.12.2007 me emërtimin "Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, UV sot ka 4 fakultete:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Ekonomisë 2. Fakulteti i Shkencave Humane 3. Fakulteti i Shëndetit 4. Fakulteti i Shkencave Teknikë dhe Natyrore <p>Njësia bazë përgjegjëse për menaxhimin dhe mbarvajtjen e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike është DITD. VKM Nr. 832, datë 04.06.2008 si Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) në Inxhinieri Mekanike, me drejtime: "Inxhinieri Mekanike" dhe "Inxhinieri Navale". Që nga viti 2011 dy profilet janë trajtuar si programe më vete.</p> <p>Si bazë për hapjen e këtij programi ka qenë: përvoja e fituar nga programi studimit në Inxhinieri Navale (që prej vitit 1994), kualifikimet e stafit akademik në këtë fushë, nevojat e industrisë dhe ekonomisë rajonale për këtë program studimi si dhe bashkëpunimet me partnerët akademikë vendas dhe ndërkombëtarë [Evidenca I.11].</p> <p>Stafi akademik i DITD ka në përbërje të tij 10 anëtarë, nga të cilët: 2 Prof. Asoc, 4 Dr, 4 Msc, 1 personel ndihmës akademik mësues dhe 1 personel ndihmës administrativ. Seksioni i Inxhinierisë Mekanike-Navale, ka një staf akademik prej 2 Prof. Asoc, 3 Dr dhe 1 Msc. [Evidenca I.12; Evidenca I.13].</p> <p>Në funksion të këtij programi studimi DITD disponon ndër të tjera edhe një laborator të kompletuar me disa pajisje për testimin e materialeve, të cilat janë të vendosura në ambientet e Qendrës Kërkimore Shkencore të</p>

	Fakultetit të Shkencave Teknike [Evidenca I.14] [evidentime dhe shënimë gjatë vizitës monitoruese në UV të GVJ].			
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	<p>Aktiviteti mësimor kërkimor i DITD-së dhe vecanërisht i Programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike është në përputhje të plotë dhe në të njëjtën linjë strategjike me atë të UV dhe FSHT [Evidenca I.1; Evidenca I.3; Evidenca I.5; Evidenca I.6 dhe Evidenca I.15].</p> <p>Fusha akademike dhe kërkimore e njësisë kryesore (FSHT) është e përcaktuar në nenin 3 të rregullores së FSHT [shih Evidenca 1.5]. Gjithashtu objektivat e përgjithshme formuese të programit Bachelor në Inxhinieri Mekanike, të parashikuara në nenin 4 të rregullores së këtij programi studimi [shih Evidenca 1.1] janë në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore (FSHT) [Evidenca 1.5].</p>			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	<p>Aktiviteti mësimor-kërkimor i realizuar në kuadrin e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekanike” përputhet plotësisht dhe në të njëjtën linjë strategjike me atë të DITD, FSHT dhe UV [Evidenca 1.1; Evidenca 1.3; Evidenca C; Evidenca 1.5; Evidenca 1.6 dhe Evidenca 1.15].</p> <p>Fusha akademike dhe kërkimore e njësisë bazë DITD përcaktohet në nenin 2 të Rregullores së DITD-së [Evidenca 1.6]. Objektivat e përgjithshme formuese të programit Bachelor në Inxhinieri Mekanike, të parashikuara në nenin 4 të Rregullores së programit të studimit [Evidenca 1.1] janë në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë DITD [Evidenca 1.6]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>DITD është njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike si dhe për mbarëvajtjen e të gjitha programeve të studimit të ofuara prej tij. Për të realizuar këtë qëllim DITD bashkëpunon dhe bashkërendon punët me njësi të tjera bazë brenda njësisë kryesore FSHT dhe me njësi të tjera bazë të Fakultetit të Ekonomisë dhe Fakultetit të Shkencave Humane, të cilët kontribuojnë me mësimdhënie në këtë program studimi.</p> <p>Neni 6 i Rregullores së programit të studimit bachelor në Inxhinieri Mekanike (Kodifikimi i lëndëve në programin dhe planin mësimor) përcakton edhe përgjegjësitë e çdo njësie tjetër bazë kontribuese për zhvillimin e lëndëve përkatëse të përfshira në programin mësimor, referuar kodifikimit të lëndëve [Evidenca I.1]. Gjithashtu për të realizuar sa më mirë dhe me efikasitet kordinimin dhe mbështetjen e programit të</p>


	<p>studimit në nivel institucional universitar (njësia qëndore - UV), funksionojnë një sërë njësish ndihmës akademike me karakter administrativ, si Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore, Qendra Studimore Ndërdisciplinore e Zhvillimit Rajonal, Drejtoria e Edukimit për Ciklin I&II, Drejtoria e Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional, Sektori i Promovimit Akademik dhe Botimeve Shkencore [neni 13, Statuti UV-së, Evidenca A]. Pika 2 e nenit 13 të statutit të UV-së [Evidenca A] thekson faktin se këto njësi ndihmojnë në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit institucional. Po ashtu si mbështetjes të programeve të studimit shërbejnë dhe qëndrat kërkimore shkencore [neni 11, statuti UV-së, Evidenca A]. Gjithashtu në këtë linjë Qendra Ndërdisciplinore ka si qëllim të forcojë bashkëpunimin midis departamenteve dhe fakulteteve për nxitjen e inisiativave në zhvillimin e kurrikulave të karakterit ndërdisciplinor [Neni 12, pika c, Statuti UV, Evidenca A]. Objekti i punës së këtyre strukturave është objekt i analizave të raporteve vjetore institucionale [Evidenca I.8]</p> <p>Në kuadrin e bashkëpunimit me Qendrën Kërkimore Shkencore të Fakultetit të Shkencave Teknike, disa pajisje kërkimore të DITD-së janë të vendosura në ambientet e kësaj qëndre, gjë që garanton jo vetëm bashkëpunimin me vetë qendrën, por edhe me departamente të tjera që kontribuojnë në procesin e mësimdhënies në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave dhe procesit mësimor të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike, si dhe të të gjitha programeve të tjera të studimit të cilat DITD menaxhon, ka marrëdhënie të mira bashkëpunimi me institucione homologe jashtë vendit, të cilat janë konkretizuar edhe me projekte të përbashkëta bashkëpunimi me këto institucione [Evidenca I.4].</p> <p>Në rang vendi, duke qenë se Universiteti i Vlorës është i vetmi Universitet në Rajonin e Jugut që ofron studime në fushën e mekanikës, marrëdhëniet e bashkëpunimit kryesisht janë konkretizuar me Universitetin Politeknik të Tiranës, si të vetmet Universitete që ofrojnë programe studimi në këtë fushë. Për të konkretizuar këtë fakt theksojmë se shumica e stafit të DITD ka kryer kualifikimet shkencore (gradat dhe titujt shkencorë) pranë Universitetit Politeknik të Tiranës.</p> <p>Në planin strategjik të zhvillimit të DITD [Evidenca I.3, fq 8], janë evidentuar disa prej Universiteteve të Huaja me të cilët DITD ka bashkëpunuar në vite në kuadrin e projekteve ndërkombëtare, si: TEMPUS, ERASMUS, financime me programe ndërqeveritare, etj.</p> <p>Gjithashtu UV ka marrëdhënie bashkëpunimi edhe në kuadrin e mobiliteteve Individual Credit Mobility (ICM Erasmus) [Evidenca I.4]. Gjithashtu DITD ka marrëdhënie bashkëpunimi edhe me aktorë vendas të biznesit, që operojnë në fushën e mekanikës, ndërtimit dhe riparimit të anijeve, autoriteve portuale, shoqërive të shfrytëzimit dhe menaxhimit të anijeve, prej të cilave merr një feedback mjaft të rëndësishëm për rishikimin e kurrikulave por dhe për punësimin e studentëve në përfundim të studimeve [Evidenca I.2]</p>

<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>DITD si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike harton analiza vjetore. Këto analiza janë product që vijnë nga diskutimet në mbledhje të hapura me asamblenë e personelit akademik të DITD dhe raportet mësimore të personelit akademik. Gjithashtu ky raport merr në analizë edhe bashkëpunimet e DITD-së në kuadrin e bashkëpunimeve në projekte ndërkombëtare, ku analizohen përfitimet e DITD-së nga këto bashkëpunime [Evidenca I.8].</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Si bazë për realizimin e praktikave mësimore të studentëve në programin e studimeve bachelor në Inxhinieri Mekanike shërbejnë marrëveshjet në kuadër të bashkëpunimeve të DITD-së me komunitetin e Biznesit [Evidenca I.16]. Përveç këtyre marrëveshjeve, për mbarëvajtjen e procesit të praktikës mësimore, me fillimin e vitit akademik, DITD angazhon një personel akademik, në rolin e udhëheqësit të praktikës mësimore. Ky personel midis detyrave të tjera evidenton dhe vendos kontakte me ndërmarrje të mundshme, pranë të cilave studentët mund të zhvillojnë praktikatat mësimore, të cilat u bëhen të ditura paraprakisht atyre. Udhëheqësi i praktikës mësimore koordinon punën me studentët, drejtuesit e fakultetit dhe drejtuesit e ndërmarrjes.</p> <p>Ky koordinim formalizohet nëpërmjet marrëveshjeve zyrtare, në të cilat qartësohen saktësisht detyrat dhe përgjegjësitë e palëve [Evidenca I.17]. Neni 4 dhe 6 i marrëveshjes sanksionojnë nevojën e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të udhëheqësit të praktikës mësimore (UV) dhe drejtuesit të praktikës mësimore në ndërmarrje, me qëllim mbarëvajtjen e procesit të praktikës mësimore.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>DITD është përpjekur të ofrojë trajnime profesionale te metejshme, kryesisht në kuadrin e projekteve ndërkombëtare. Kështu në kuadrin e projektit MARED Tempus, janë ofruar kurse të formimit të vazhduar të cilat synonin trajnime të formimit profesional në fushën e navigacionit detar [shih Evidenca I.18].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<p>Standardi II.1 Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike, është hartuar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi për arsimin e lartë. Aktualisht ky</p>

<p>module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>program është i formatuar dhe riorganizuar në përputhje të plotë me VKM. Nr. 41, datë 24.01.2018” <i>Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë</i>”. Programi mësimor është i organizuar në module lëndore, të cilat janë të vlerësuara në kredite ECTS [Evidenca I.1]. Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike, neni 2 dhe neni 20 përcaktojnë elementët bazë të krediteve, sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS), si dhe korrespondencës së kreditit me orët totale të punës së studentit (ngarkesë në auditor + ngarkesën jashtë auditorit), numrin total të krediteve në një vit akademik (60 ECTS), ngarkesën javore, etj.. Në totalin e tij ky program studimi ofrohet me 180 ECTS.</p> <p>Të gjitha elementët janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar edhe në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike [Evidenca I.1].</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p>	<p>Neni 4 i rregullores së programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike [Evidenca I.1], përcakton se ky program studimi synon që të formojë <i>inxhinierë mekanike që të jenë në gjendje të: konceptojnë, projektajnë, zhvillojnë, prodhojnë, drejtojnë dhe mirëmbajnë makineri dhe sisteme mekanike të thjeshta dhe komplekse, që përdoren në të gjitha fushat e jetës. Programi i studimit Bsc. Inxhinieri Mekanike, finalizohet me diplomimin e studentëve me titullin Bachelor në Inxhinieri Mekanike. duke përfshirë kryesisht njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale në disipinat karakterizuese si më poshtë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ <i>Projektimin e Sistemeve Fluidike dhe Termike,</i> ✓ <i>Mekanikën e Materialeve,</i> ✓ <i>Projektimin e Sistemeve Mekanike,</i> ✓ <i>Motorët me Djegie të Brendshme.</i> <p>Meqenëse fusha e mekanikës është një fushë e gjerë, ajo ka si bazë të saj njohuri të shkencave të natyrës si: fizika, matematika, kimia, informatika si dhe të disiplinave bazë inxhinierike. Për ta plotësuar figurën e inxhinierit të ardhshëm mekanik, ai është plotësuar me njohuri nga disiplina të tjera inxhinierike. Gjithashtu programi i studimit është hartuar për t’u dhënë studentëve njohuritë bazë të disiplinave të inxhinierisë mekanike, si fluidodinamika, termodinamika, mekanika teorike, mekanika e materialeve, projektimet e sistemeve mekanike, etj. Ky spektër i gjerë i njohurive formuese që jep ky program studimi është një garanci që studenti të fitojë kompetenca profesionale të qëndrueshme, kështu do të jetë në gjendje të përballet me aspekte të ndryshme multidisiplinare të fushës së mekanikës.</p> <p>Shumllojshmëria e njohurive që jep programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike, i ofron studentit mundësi të ndryshme për studimet e ciklit të dytë. Mundësitë e punësimit që ofron programi i studimit Bsc. në Inxhinieri Mekanike jepen hollësisht në Guidën e studentit [Evidenca I.7; fq 10].</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike është një program studimi i organizuar duke marrë në konsideratë praktikën më të mirë të Universitetve me të cilët UV dhe në veçanti DITD bashkëpunon. Ai është riorganizuar në mënyrë paralele me programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Navale në kuadrin e projektit TEMPUS MARED “Modernizimi dhe</p>

<p>kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Harmonizimi i Edukimit Detar në Shqipëri dhe Mal të Zi”, në një partneritet prej 17 institucionesh, nga të cilët 8 Institucione të Arsimit të Lartë (prej të cilëve 5 Universitete nga vende të Bashkimit Europian dhe pjesa tjetër e partneritet e përbërë nga përfaqësues nga Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, Instituteve të Transportit, Qendrave të Zhvillimit të Teknologjive të reja, si dhe Ministrive nga Shqipëria dhe Mali i Zi [http://www.mared.ac.me/index-3.1.html]. Ky partneritet ka siguruar thithjen e mendimeve qoftë nga bota akademike, qoftë nga bota e biznesit për t’u dhënë studentëve njohuri të qëndrueshme teorike të nevojshme për punësimin e tyre. Në këtë program studimi përveç njohurive teorike në modulet bazë jepen dhe njohuri aplikative (përmes moduleve karakterizuese) të lidhura ngushtë me sektorin e prodhimit në fushën përkatëse.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike, në rregulloren e tij [Evidenca I.1] thekson se ky program synon “që të formojë inxhinierë mekanike që të jenë në gjendje të konceptojnë, projektojnë, zhvillojnë, prodhojnë, drejtojnë dhe mirëmbajnë makineri dhe sisteme mekanike të thjeshta dhe komplekse, që përdoren në të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë kryesisht njohuri dhe kompetenca profesionale në disiplinat karakterizuese të fushës së inxhinierisë mekanike si Projektimin e Sistemeve Fluidike dhe Termike, Mekanikën e Materialeve, Projektimin e Sistemeve Mekanike, Motorët me Djegie të Brendshme”. Kjo gjë reflektohet dhe në planin mësimor të programit të studimit [Evidenca I.10] ku në përmbajtjet lëndore jepen njohuri, aftësi teorike dhe profesionale, të tilla që studentët të jenë në gjendje të zgjidhin problemet komplekse inxhinierike aktuale dhe të perspektivës të sektorit mekanik. Një garanci më shumë është dhe vetë niveli i lartë i kualifikimit të stafit akademik të DITD-së [Evidenca II.1] për tu transmetuar studentëve njohuritë e nevojshme për aftësimin dhe plotësimin e tyre si inxhinier të ardhshëm mekanik.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Riorganizimi i fundit dhe struktura për programin e Studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike është bërë në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për Elementët e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Kjo gjë reflektohet dhe në dokumentat bazë të këtij program si “Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike” [Evidenca I.1]. Neni 1 i rregullores përcakton qartë bazën ligjore që rregullon veprimtaritë në këtë program studimi, e cila është në përputhje të plotë me aktet ligjore, nënligjore dhe Institucionale në fuqi. Rregullorja gjithashtu parashikon të gjithë elementët rregullativ të veprimtarive dhe të strukturës në Programin e Studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) [Neni 20 i Rregullores, Evidenca I.1]; ✓ kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit; ✓ objektivat formues dhe kompetencat profesionale; [Neni 4 i Rregullores, Evidenca I.1]; ✓ veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit [Neni 9 i Rregullores, Evidenca I.1];


	<ul style="list-style-type: none"> ✓ kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi [Neni 5 i Rregullores, Evidenca I.1]; ✓ planin mësimor [Evidenca I.1]; ✓ kuotat e pranimit dhe grupet mësimore [Neni 19 i Rregullores Evidenca I.1]; ✓ programin lëndor (Syllabus-et) [Evidenca I-10]; [Neni 7 i Rregullores, Evidenca I.1]. 								
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Veprimtaritë formuese të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike janë të përcaktuara në përputhje me kategoritë e përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për Elementët e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. (Pika 2.5 e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018) [Evidenca I.1]. Në programin e studimit janë të përcaktuara edhe kreditet për secilën prej kategorive të veprimtarive formuese, në referencë të peshës së tyre, të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 (Shtojca Nr 1-Tabela 1 e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018). [Evidenca I.1]</p> <p>Konkretisht veprimtaritë formuese të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike janë të grupuara lëndët si më poshtë:</p> <p>A. LËNDË BAZË (15% - 20%) – 36 kredite, (20%)</p> <p>B. LËNDË KARAKTERIZUESE (50% - 55%) – 96 kredite, (53%)</p> <p>C. LËNDË NDËRDISIPL/INTEGRUESE (12%-15%) – 21 kredite, (12%)</p> <p>D. LËNDË PLOTËSUESE (10% - 15%) – 21 kredite, (12%)</p> <p>E. DETYRIME PËRMBYLLËSE (3% - 5%) – 6 kredite, (3%)</p> <p>Këto lëndë sipas kategorive të veprimtarive formuese përkatëse janë të pasqyruara në planin mësimor të programit të studimit [Evidenca I.1]. Ky program studimi është i organizuar në 3 vite akademike, 6 semestra me një total prej 180 Kredite ECTS, ku cdo semestër ka 30 kredite ECTS secili. Në planin mësimor gjithashtu pasqyrohen ngarkesa totale e orëve, ngarkesa në auditor, ngarkesa jashtë auditorit, ngarkesa javore (leksione, seminare, laboratore) dhe detyra kursi.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë është akredituar për herë të parë me Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 71, datë 21.09.2017, me kohëzgjatje 3 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 30.09.2020.</p> <p>Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë është ri-akredituar me Vendimin e Bordit të Akreditimit, BA Nr. 50, datë 27.11.2020, me kohëzgjatje 5 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 26.11.2025.</p>

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Departamentin e Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare funksionon duke qenë i organizuar në grupe mësimore-kërkimore. Vetë grupet janë të organizuara mbi bazë programesh mësimore. Përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit mësimor, në të gjithë komponentët e tij, në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike është seksioni i Inxhinierive Mekanike dhe Navale.</p> <p>Grupet mësimore ngrihen dhe funksionojnë në përputhje me Vendimin e Senatit Nr 79, datë 12.12.2016 “Për funksionimin e grupeve mësimore të përkohshme/të përherëshme kërkimore-shkencore dhe standardet e shpërndarjes së ngarkesës mësimore vjetore në auditor” [shin Evidenca II.3], si dhe Rregulloren e DITD-së [Evidenca I.6]. Grupet mësimore kërkimore drejtohen nga përgjegjësi i tyre [Evidenca II.3], i cili koordinon me Drejtuesin e Departamentit për mbarëvajtjen e procesit mësimor në këtë program studimi, duke luajtur në këtë mënyrë edhe rolin e koordinatorit për programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Organizimi, struktura dhe funksionimi i njësive kryesore parashikohet në Statutin e UV [Evidenca A] dhe Rregulloren e UV [Evidenca C]. Organizimi i brendshëm i Fakultetit të Shkencave Teknikë pasqyrohet në Rregulloren e FSHT-së [Evidenca I.5].</p> <p>Njësia Bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike është Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare (DITD). Ndërsa njësia kryesore përgjegjëse për këtë Program Studimi është Fakulteti i Shkencave Teknikë (FSHT), i cili përbëhet nga 7 njësi bazë, të cilat plotësojnë kriteret ligjore për funksionim, si më poshtë [Evidenca I.5 dhe Evidenca II.2]:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Matematikës 2. Departamenti i Fizikës 3. Departamenti i Kimisë 4. Departamenti i Biologjisë 5. Departamenti i Shkencave Kompjuterike 6. Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare 7. Departamenti i Shkencave Detare <p>Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Neni 23, pika 2 e këtij ligji kërkon që Fakulteti organizohet në së paku tri njësi bazë, ku dy prej të cilave janë departamente, pra FSHT e plotëson këtë kërkesë të ligjit dhe standarteve.</p> <p>Gjithashtu departamenti në përmbushje të kërkesave të Ligjit 80/2015, neni 25, pika 4 duhet të ketë të paktën 7 anëtarë ku 3 minimalisht duhet të jenë me grada ose tituj. Konkretisht Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare ka një personel akademik prej 10 anëtarësh, prej të cilëve 2 Prof. Asoc, 4 Dr, 4 Msc, duke përmbushur në këtë mënyrë kërkesat ligjore për funksionimin e kësaj njësie bazë si dhe një personel ndihmës akademik [shih Evidenca II 2].</p> <p>Në ndihmë të këtyre njësive bazë është edhe administra e Fakultetit sic parashikohet në Nenin 5 të Rregullores së FSHT [Evidenca I.5]. Autoritet</p>

	<p>drejtuese në FSHT janë Dekani dhe Drejtuesit e Departamenteve [Evidenca I.5, Neni 4]. Drejtues të tjerë janë dhe Zv. Dekanët [Evidenca I.5, Neni 4].</p> <p>Në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 25, pika 5, si dhe Rregullores së Departamentit [Evidenca I.6, Neni 7] DITD është i organizuar në Grupe Mësimore – Kërkimore. Numri dhe përbërja e grupeve mësimore, përcaktohet nga DITD, numri minimal i anëtarëve të grupit përcaktohet nga aktet ligjore, nënligjore dhe institucionale [Evidenca I.6, Neni 7]. Seksionet në Departamentin e Inxhinierive dhe Teknologjive Detare janë [Evidenca II.4]:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Seksioni i Inxhinierive Mekanike dhe Navale ➤ Seksioni i Inxhinierisë Elektrike <p>Kështu Organizimi, Struktura dhe Funkcionimi i Njesisë Kryesore Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, si dhe i Njesisë Bazë Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare është në përputhje të plotë me aktet ligjore, nënligjore dhe institucionale në fuqi.</p>																		
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>FSHT si njësi kryesore dhe DITD si njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për numrin dhe kualifikimin e stafit të tyre akademik. Kështu Statuti i UV [Evidenca A, Neni 9].</p> <p>Për vitin aktual 2020-2021, Personeli Akademik Efektiv (PAE) në rang Fakulteti, janë 73 pedagogë, të ndarë në 69 PAE dhe 7 PAK, kualifikimi i të cilëve është:</p> <table border="1" data-bbox="718 1075 1276 1321"> <thead> <tr> <th></th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Profesor</td> <td>1</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc</td> <td>8</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Doktor/Docent</td> <td>31</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>29</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td></td> <td>69</td> <td>7</td> </tr> </tbody> </table> <p>Konkretisht në FSHT të gjitha departamentet plotësojnë detyrimet ligjore lidhur me numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik [shih Evidenca II.2]. Për gjatë viteve të fundit DITD, ka të dhënat si më poshtë:</p> <p><u>Në vitin akademik 2017–2018:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 12 PAE (2 Prof. Asoc., 4 Dr. dhe 6MSc). - 2 PAK (1 Prof.Dr. dhe 1 MSc). <p><u>Në vitin akademik 2018–2019:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 11 PAE (2 Prof. Asoc., 4 Dr. dhe 5 MSc). - 3 PAK (3 MSc). <p><u>Në vitin akademik 2019–2020:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 10 PAE (2 Prof. Asoc., 4 Dr. dhe 4 MSc) - 3 PAK (3 Msc); 		PAE	PAK	Profesor	1	-	Prof. Asoc	8	2	Doktor/Docent	31	2	Msc.	29	3		69	7
	PAE	PAK																	
Profesor	1	-																	
Prof. Asoc	8	2																	
Doktor/Docent	31	2																	
Msc.	29	3																	
	69	7																	




	<p><u>Në vitin akademik 2020–2021:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 10 PAE (2 Prof. Asoc., 4 Dr. dhe 4 MSc) - 3 PAK (ne proces rekrutimi). <p>Drejtuesi i DITD, është me titull akademik “Profesor i Asociuar”, i kategorisë “Profesor” në përputhje me nenin 45, pika 3 të LAL 80/2015.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Njësia kryesore FSHT dhe njësia bazë DITD disponojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike. Kështu FSHT dhe DITD disponojnë dokumentat bazë të programit të studimeve Bachelor në Inxhinieri Mekanike si: program mësimor, plani mësimor dhe syllabuset e lëndëve. Kështu në programin mësimor janë të listuar lëndët me kreditet përkatëse, të grupuara sipas kategorive të veprimtarive formuese (lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/ integruese, lëndë plotësuese, detyrime plotësuese) [Evidenca I.1] Ndërsa në planin mësimor që DITD disponon pasqyrohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ lëndët e programit mësimor, të grupuara sipas semestrave dhe viteve akademike, ✓ kreditet e lëndës, ✓ ngarkesa javore (leksione, seminare, detyra kursi, laboratore) ✓ ngarkesa totale (ngarkesa në auditor + ngarkesën jashtë auditorit) [Evidenca I.1] <p>Ndërsa syllabuset e lëndëve pasyrojnë gjithashtu kontrollin e dijeve dhe mënyra e vlerësimit [Evidenca I.10]. Objektivat formues dhe kompetencat profesionale të programit të studimit përcaktohen sipas Nenit 4 të Rregullores së programit të studimit [Evidenca I.1]. Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit pasqyrohen në Nenin 9 të Rregullores së programit të studimit [Evidenca I.1]. DITD sipas përcaktimeve të Nenit 19 të Rregullores së programit të studimit [Evidenca I.1] i propozon Dekanatit të FSHT dhe ky më pas Senatit të UV kuotat dhe kriteret për pranimin e studentëve [Evidenca II.5].</p> <p>Me fillimin e vitit akademik DITD miraton shpërndarjen e ngarkesës, [Evidenca II.6], mbi bazën e së cilës hartohet edhe orari mësimor dhe merren masat për mbarëvajtjen e procesit mësimor [Evidenca II.7]</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit [Evidenca I.1], është e organizuar në lëndë, praktikë, trajnim profesional dhe tezë diplome (ose provim formimi), të cilat janë të grupuara sipas kategorive të mëposhtme:</p>

<p>përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ LËNDË BAZË, ose lëndë të kategorisë A. ➤ LËNDË KARAKTERIZUESE, ose lëndë të kategorisë B. ➤ LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE. ➤ LËNDË PLOTËSUESE. ➤ DETYRIME PËRMBYLLËSE. <p>Kategorizimi dhe pesha e lëndëve janë në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, për elementët e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Kurrikula e programit mësimor Bachelor në Inxhinieri Mekanike [Evidenca I.1] është e organizuar në bazë lëndësh, të ndara këto në semestra dhe vite akademike. Çdo lëndë ka peshën e saj të pasqyruara me kredite ECTS. Kreditet ECTS janë të pasqyruara edhe në syllabusin përkatës të cdo lënde. [Evidenca I.10]. Lëndët zhvillohen në bazë semestrash ku cdo semestër ka 30 ECTS. Viti akademik ka 60 ECTS secili dhe programi zgjat 3 vite me 180 ECTS në total.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Si një ndër elementët bazë, programi mësimor Bachelor në Inxhinieri Mekanike përmban edhe planin mësimor [Evidenca I.1], i cili është i organizuar në semestra dhe vite akademike. Gjithashtu plani mësimor përmban edhe të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me ngarkesën mësimore, ngarkesën në auditor dhe ngarkesën jashtë auditorit.</p> <p>Ngarkesa javore në auditor është 25 orë në javë. Informacionet e tjera lidhur me frekuentimin dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve pasqyrohen në syllabuset e lëndëve. Për vlerësimin e dijeve të përfituara prej studentëve përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhduar me atë përfundimtar [Evidenca I.10].</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Dokumenti bazë që rregullon organizimin dhe funksionimin e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike është Rregullorja e tij [Evidenca I.1]. Gjithashtu në Nenin 15, pikat 4 dhe 5 të Rregullores së DITD [Evidenca I.6] përcaktohen kriteret e përgjithshme dhe specifike për t'u pranuar në programet e studimit të ciklit të parë në DITD. Kanë të drejtë për t'u pranuar në programet e studimeve të ciklit të parë, kandidatët të cilët kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me Vendim të Senatit Akademik të Universitetit të Vlorës, në përputhje me Vendimet e Këshillit të Ministrave [Evidenca II.5]. Brenda afateve të përcaktuara nga Institucioni, DITD mund të propozojë kriteret shtesë specifike të pranimit të studentëve në programet e studimit të ciklit të parë të ofruara prej saj [Evidenca I.6]. Kriteret dhe kuotat e pranimit bëhen publike përmes publikimit të vendimeve të SA në faqen zyrtare online të UV-së (https://univlora.edu.al), publikimit të kuotave e kriterëve në portalin U-Albania, faqeve zyrtare në rrjetin social Facebook të UV-së.</p> <p>Universiteti i Vlorës (UV), Fakulteti i Shkencave Teknike (FSHT) dhe Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare (DITD) u ofrojnë mundësi studentëve për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve ndërmjet programeve të të njëjtit cikël brenda UV-së, ose nga Institucione të tjera të Arsimit të Lartë. Neni 56 dhe 58 i Rregullores së UV-së [Evidenca C] jep me hollësi procedurat e transferimit dhe ekuivalentimit të krediteve.</p>

	Të drejtën për transferime studimesh e kanë studentët që kanë siguruar të paktën 30 kredite. Të gjitha llojet e transferimeve bëhen mbi bazën e kërkesës dhe dokumentacionit të studentit duke plotësuar një formular tip. Një Komision ad-hoc i ngritur nga DITD është përgjegjës për njohjen dhe transferimin e studimeve [Evidenca I.1, Neni 20 dhe Evidenca II.8].			
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Si bazë për zhvillimin e lëndës shërben programi i saj (syllabusi lëndës). Qysh në fillim të semestrit përkatës pedagogu përkatës i lëndës harton dhe dorëzon për miratim pranë drejtuesit të njësisë bazë syllabusin përkatës të lëndës, në të cilin paraqitet përmbajtja tematike e lëndëve, të dhënat mbi lëndën, mënyrën e vlerësimit, kontrollin e dijes, literaturën e detyruar etj. [Evidenca I.10]. Syllabusi u bëhet i ditur studentëve me fillimin e zhvillimit të lëndës nga pedagogu përkatës i ngarkuar për të zhvilluar atë lëndë [Evidenca I.1]. Format i Syllabusit, përmban të gjithë elementët sipas përcaktimeve të shtojcës 2 të Vendimit nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave: “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë [Evidenca I.6 dhe Evidenca I.10].			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Neni 24 i Rregullores së Brendëshme të funksionimit dhe organizimit të DITD-së [Evidenca I.6] parashikon që DITD të bëjë ndryshime në programin mësimor, sa herë që ka propozime konkrete, të shoqëruara me argumentimin përkatës. Gjithashtu rregullorja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike [Evidenca I.1] parashikon në përmbajtjen e saj mënyrën sesi ndryshohen dhe përmirësohet përmbajtja e këtij program studimi. Syllabuset e lëndëve hartohen dhe miratohen me fillimin e cdo semestri nga drejtuesi i njësisë bazë dhe pedagogu i lëndës mund të bëjë ndryshime përsa i përket përmbajtjes tematike të lëndës, literaturës së nevojshme, mënyrës së vlerësimit, etj. [Evidenca I.10].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin e studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa dhe struktura e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike, është e organizuar në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore, konkretisht me VKM Nr 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programit të studimit”, si dhe sistemit Evropian të transferimit të krediteve ECTS. Programi është organizuar në semestra dhe vite akademike. Ngarkesa e cdo lënde dhe orëve të punës së studentit është e shprehur në kredite. Cdo semester ka 30 kredite. 1 krediti i korrespondon 25 (njëzet e pesë) orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij. Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh nga një student është 60 (gjashtëdhjetë) kredite ose 1500 (një mijë e pesëqind) orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij. Nga

	<p>fondi prej 1500 orësh, 750 orë i përkasin ngarkesës në auditor të studentit, që i korrespon një ngarkese javore prej 25 orësh në javë. [Evidenca I.1]. Ora e mësimit është 50 minutëshe. Çdo semestër ka 15 javë mësimore.</p> <p>[Evidenca II.7]</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktikave në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike, janë të tilla që mundësojnë arritjen e njohurive, kompetencave dhe aftësive të nevojshme të studentëve për punësim. Vetë objektivi dhe qëllimi programit të studimit është që student të oriebttohet sa më shpejt drejt tregut të punës [Evidenca I.1]. Për këtë qëllim programi përmban lëndë, të cilat t'i përgjigjen jo vetëm emërtesës së programit por dhe objektivave formues të tij, të cilat synojnë që t'u japin njohuri studentëve për një karrierë të suksesshme inxhinierike në industrinë mekanike, duke u dhënë atyre njohuri dhe kompetenca profesionale të qëndrueshme në disiplinat kryesore të fushës. Syllabuset e lëndëve hartohen dhe miratohen cdo vit akademik, duke bërë edhe përditësime të mundshme nga pedagogu i lëndës, sa herë që ato janë të nevojshme. [Evidenca I.1; Evidenca I.10]. Këto elementë të programit të kombinuara edhe me kualifikimin e mirë dhe përvojën e gjatë të stafit akademik të DITD-së [Evidenca II.1] janë baza për të siguruar që përmbajtja e lëndëve të garantojë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme të studentëve për tregun e punës.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Programi dhe plani mësimor Bachelor në Inxhinieri Mekanike është organizuar në mënyrë të tillë që lëndët, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundësojnë arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional. Kështu radha e zhvillimit të lëndëve ndjek një rrjedhë llogjike dhe të balancuar mes semestrave dhe viteve akademikë. [Evidenca I.1]. Ngarkesa totale e programit është e shpërndarë uniformisht, ku cdo semestër është i vlerësuar me 30 kredite, me një ngarkesë semestrale 750 orë (brenda dhe jashtë auditorit), nga të cilat 375 orë në auditor. Ngarkesa javore mësimore e studentit është 25 orë në javë. Kjo ngarkesë mësimore javore i korrespondon vlerësimin të 1 krediti ECTS përafërsisht për leksionet 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit (përafërsisht 1 orë përgatitje për 1 orë leksion), seminarët/ushtrimet 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit (përafërsisht 1 orë përgatitje për 1 orë seminare/ushtrime). Shpërndarja e lëndëve është bërë e tillë që lëndët, njohuritë, aftësitë dhe shrehitë që fitohen të jenë në vijimësi të njëra tjetrës. Studenti, në 15 javë të procesit mësimor në auditor, gjatë leksioneve merr njohuritë e duhura rreth tematikave të caktuara, kurse gjatë seminareve studentët analizojnë çështjet e leksionit, ose mund të punojnë në zgjidhjen e pjesëve ushtrimore aplikative, në funksion të tematikave dhe tipologjive të lëndëve. Në planin mësimor të këtij programi studimi [Evidenca I.1] për secilën lëndë gjejmë të pasqyruara shpërndarjen e orëve, në leksione dhe seminare në auditor, studimin individual të studentit, si dhe vlerësimin përkatës të tyre në kredite. Pjesa më e madhe e lëndëve janë të vlerësuara me 6 kredite dhe kanë një ngarkesë mësimore javore prej 3 leksionesh dhe 2 seminaresh. Kështu viti i parë përmban lëndë të formimit bazë si: Matematikë, Fizikë, Kimi, etj, viti i dytë përmban lëndë të formimit të përgjithshëm inxhinierik dhe/ose integruese me fusha të tjera,</p>




	<p>kurse lëndët e formimit karakterizues dhe specifik janë të vendosura në vitin e tretë. Kjo shpërndarje e lëndëve siguron jo vetëm një përmbushje më të mirë të objektivave formuese të programit të studimit dhe arritjen e rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional, por ajo lehtëson edhe transferimet e studimeve në këtë program studimi.</p> <p>Në pjesën më të madhe të lëndëve inxhinierike kanë në programet e tyre dhe detyra kursi, laboratore të cilat synojnë të zhvillojnë aftësitë komunikuese të studentëve dhe nxisin që ata të përvetësojnë procesin e kërkimit dhe të aftësimin profesional. Gjithashtu ngarkesa javore mundëson një kohë të mjaftueshme për përgatitjen e cdo lënde dhe për rrjedhojë në arritjen e rezultateve të dëshiruara.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Siç është theksuar dhe më lart programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike, në strukturën e tij është në përputhje të plotë me VKM Nr 41. datë 24.01.2018, ku pesha dhe ngarkesa e veprimtarive formuese, e shprehur në kredite është në përputhje të plotë me veprimtaritë formuese të parashikuara për programet e studimit të ciklit të parë, të parsqyruara në shtojcën Nr 1, të kësaj VKM-je. Lëndët në programin mësimor të tyre përmbajnë aspekte teorike (që zhvillohen përmes leksioneve) dhe aspekte praktike e aplikative (që zhvillohen përmes seminareve, ushtrimeve dhe laboratoreve), ku për pjesën më të madhe të lëndëve raporti teori/praktikë është në raportin 60%/40%, [Evidenca I.10].</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike është hartuar kryesisht duke patur në konsideratë programe të ngjashme të Inxhinierisë Mekanike të universiteteve të huaja me të cilat DITD ka bashkëpunuar (vlen të përmendet bashkpunimi në kuadrin e projektit Tempus MARED (http://www.mared.ac.me/index-3.2.html), si dhe të bashkëpunimeve të mëparshme të DITD-së. Gjithashtu ky program është munduar të përafrohet me programin e Bachelorit në Inxhinierisë Mekanike të Universitetit Politeknik të Tiranës, kjo dhe në përmbushje të kërkesave të nenit 86 pika 2 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja sipas veprimtarive formuese në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike, është në përputhje të plotë me (VKM Nr 41. datë 24.01.2018, “Për elementët e programit të studimit” [Evidenca I.1]. Gjithashtu përafrimi i programit me programe të ngjashme të Inxhinierisë Mekanike mundëson jo vetëm transferimin e studimeve, mobilitet të studentëve pranë Universiteteve të huaja, por edhe punësimin në një treg pune jo vetëm kombëtar, por edhe ndërkombëtar.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit Bsc. Inxhinieri Mekanike [Evidenca I.1], Neni 7, pika 2, përcakton se syllabuset hartohen dhe u bëhen të ditur studentëve me fillimin e cdo semestri, c’ka i krijon mundësi pedagogëve përkatës, të bëjnë përditësimet e nevojshme në funksion të arritjes së objektivave të programit, problematikave të hasura nga kurset pararendëse, si dhe përfshirjes në to të arritjeve më të fundit të fushës. Gjithashtu analiza e performancës së programit të studimit është pjesë e analizës vjetore të Departamentit, [Evidenca I.8]. Syllabuset e lëndëve janë objekt i rishikimeve vjetore nga titullarët e tyre [Evidenca I.10]. Për më tepër eksperiencat dhe bashkëpunimet ndërkombëtare,</p>

	si dhe mobilitet e stafit akademik të DITD, në kuadrin e projekteve ndërkombëtare, kanë ndikuar në pasurimin dhe përmirësimin e syllabuseve.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	Qëllimi kryesor programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike është që të formojë inxhinierë mekanikë të aftë të konceptojnë, projektojnë, zhvillojnë, prodhojnë, drejtojnë dhe mirëmbajnë makineri dhe sisteme mekanike të thjeshta dhe komplekse, që përdoren në të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë kryesisht njohuri dhe kompetenca profesionale në disiplina karakterizuese si: projektimin e sistemeve fluidike dhe termike, mekanikën e materialeve, projektimin e sistemeve mekanike, motorët me djegie të brendshme, etj. [Evidenca I.1]. Përgjithësisht objektivi i programeve të studimit në ciklin të parë dhe në vecanti Bachelori në Inxhinieri Mekanike është marrja e njohurive bazë mbi metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme, por edhe për formimin e shprehive të vecanta në fushën e inxhinierisë mekanike, që i përkasin nivelit 6 të kualifikimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Meqenëse fusha e mekanikës është një fushë që mund të integrohet me fusha të tjera inxhinierike programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike është hartuar për t'u dhënë studentëve njohuri të shkencave të fizikës dhe matematikës, si dhe të disiplinave bazë inxhinierike. Për sa u përket disiplinave inxhinierike programi i studimit është hartuar për t'u dhënë studentëve njohuritë bazë të disiplinave të inxhinierisë mekanike, si dhe atyre karakterizuese të kësaj fushe [Evidenca I.7]. Garantimi i dhënies së dijeve bëhet përmes lëndëve përkatëse të programit.			
Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Mundësia e studentit për të vazhduar studimet në programet e studimit të ciklit të dytë përcaktohet qartësisht në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike [Evidenca I.1, Neni 4], qoftë në UV por dhe univeristete të tjera brenda ose jashtë vendit. Gjithashtu diploma Bachelor në Inxhinieri Mekanike është në përputhje me nivelin 6 të kualifikimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, duke mundësuar punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Kontribut kryesor për ristrukturimin e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike kanë qenë diskutimet që janë zhvilluar paralelisht me riorganizimin e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Navale, në kuadrin e programit TEMPUS MARED - Modernizing and Harmonizing Maritime Education in Montenegro and Albania. Këto diskutime janë kryer gjithashtu dhe me një partneritet të gjerë duke përfshirë Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, Administratën Detare Shqiptare, Institutin e Transportit, Portin Detar, si dhe shoqatat e teknologjive të reja. Propozimet e këtyre partnerëve kaq në qenë dobiprurëse, sepse kanë mundësuar marrjen parasysh të sygjërimeve nga partnerët të lidhur drejtpërdrejtë, ose indirekt me tregun e punës, në sektorin mekanik dhe sektorë të tjerë të lidhur me të. (http://www.mared.ac.me/index-3.2.html). Kontribut të rëndësishëm kanë dhënë dhe pyetësrit e studentëve në fund të cdo semestri [Evidenca III.19]. Gjithashtu një feedback të rëndësishëm kanë dhënë dhe Panari i punës [Evidenca V.9].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.

Personeli akademik PAE dhe PAK i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikimin e duhur për këtë program studimi. Minimumi i kualifikimit të personelit akademik, për këtë program studimi të ciklit të parë, në përputhje me LAL 80/2015 është Master i Shkencave. Kjo kërkesë ligjore plotësohet plotësisht.

Në realizimin e programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekanike” janë përfshirë personel akademik efektiv, personel akademik me kontratë dhe personel ndihmës akademik. Në katër vitet e fundit angazhimi i personelit akademik në mësimdhënie, në këtë program studimi dhe kualifikimi i tyre përkatësisht është si më poshtë: [Evidencat tabelat e perditësuar]:

Kualifikimi	2017-2018		2018-2019		2019-2020		2020-2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof	-	-	-	-	-	-	-	-
Prof As	3	-	4	-	3	-	5	-
Dr.PhD	5	-	7	-	8	-	8	-
Msc (dr ne proces)	6	-	5	-	4	-	2	-
Msc	6	-	8	-	7	-	6	-
Totale	20	-	24	0	22	-	21	-

Nga verifikimi i personelit akademik i përfshirë në mësimdhënie, konstatohet një qëndrueshmëri në stafin akademik.

Nga verifikimi i të dhënave statistikore, u konstatua se për vitet e fundit 100 % e ngarkesës mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv. Numri mesatar i lëndëve/moduleve semestrale që mban një pedagog është 5 lëndë përgjatë vitit akademik (2 semestra), Evidence RVB, tabela 4.

Mbështetur në udhëzimin 37, datë 04.12.2018, pika a.ku jepet reformulimi i pikës 6 të Udhëzimit 29 lejohet të mbahen deri në 3 (tre) lëndë në semestër.

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Personeli akademik PAE dhe PAK i angazhuar në realizimin e programit të studimit Bachelor në inxhinieri Mekanike ka kualifikimin e duhur.

Drejtuësja e DIDT, zotëron titullin akademik “Prof. Asoc” në përputhje të plotë me kërkesat e LAL 80/2015, neni 42, pika 3.

DIDT është i përbërë nga dy grupe mësimore/kërkimore ku drejtues i grupit mësimor/kërkimor “Inxhinieri Mekanike-Navale” është Inxhinieri Mekanike [Evidenca II.4].

Për rritjen e nivelit të kualifikimit dhe përditësimin e njohurive në këtë fushë, stafi akademik ka realizuar trajnime në fusha specifike pranë Universiteve të huaja, si Universiteti i Triestes (IT), Napolit (IT), Genoves (IT), Aalesund University College (NORÉAY) [Evidenca II.1]. Po ashtu stafi akademik i DIDT-së në realizimin e punimeve të tyre të doktoratës dhe masterit shkencor dhe masterit të nivelit të dytë (SHPU) ka realizuar pjesën kërkimore në fushat e Inxhinierisë Mekanike dhe Navale.

<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Niveli kualifikimit të stafit të DITD që mbulon programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike por edhe stafi i departamenteve të tjerë që japin mësim në këtë program kanë minimalisht kualifikimin shkencor Master i Shkencave, duke plotësuar kështu kërkesat ligjore [Evidenca II.1, II.2 dhe Evidenca I.9]. Po ashtu dhe fusha akademike dhe kërkimore e përgjithshme dhe specifike e stafit akademik të Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare është fusha e inxhinierive mekanike dhe navale (strukturat inxhinierike, materialet, sistemet inxhinierike, arkitektura navale, impiantet dhe sistemet energjetike, transporti, etj) [Evidenca II.1]. Këto fusha studimi dhe kërkimi të stafit akademik të DITD-së, janë në përputhje të plotë me natyrën dhe specifikat e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike, si dhe të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Navale [Evidenca I.1].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Mënyra sesi kryhet praktika profesionale në institucione/ndërmarrje prodhimi apo shërbimi sipas profilit të përgatitjes së studentit, përcakthet qartësisht në rregullorja e brendshme e funksionimit dhe organizimit të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike [Neni 21, Evidenca I.1]. Në këtë rregullore theksohet se praktikat profesionale zhvillohen nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti, sipas marrëveshjeve tip që lidhen për këtë qëllim [Evidenca I.17]. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, personeli akademik që drejton atë, ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me qendrën apo biznesin ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit një relacion për punën e kryer, e cila vlerësohet nga pedagogu që e drejton praktikën pasi merr edhe mendimin e qendrës ku është kryer ajo.</p> <p>Përpara fillimit të praktikës mësimore nënshkruhet një marrëveshje tip midis Fakultetit të Shkencave Teknike (FSHT) dhe Ndërmarrjes ku studenti do të kryejë praktikën mësimore. [Evidenca I.17]. Gjithashtu Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjive Detare dhe Fakulteti i Shkencave Teknike kanë edhe marrëveshje kuadër me komunitetin e biznesit për mbarëvajtjen e procesit të praktikës mësimore. [Evidenca I.16]. Edhe për punimin e temës së diplomës në nenin 17 dhe 18 të Rregullores së këtij program studimi jepen modalitetet e nevojshme për këtë veprimtari [Evidenca I.1]. Diplomimi ndjek një procedurë të caktuar.</p> <p><i>[Evidenca III.18 dhe III.27] dhe drejtohet nga një pedagog udhëheqës [Evidenca III.30].</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>DITD dhe FSHT si njësi përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike kanë në përbërjen e vet personel ndihmës akademik që asiston personelin akademik dhe mirëmban laboratorin dhe mjediset e tjera në dispozicion të tyre [Evidenca II.2]. Inventari paisjeve në funksion të laboratoreve jepen në Evidencën I.14. DITD në funksion të mësimdhënies në programet e studimit që menaxhon, disponon laboratorin e dhomës së motorrit Transas Engine Room simulator (https://www.nauticexpo.com/prod/transas-marine-international/product-22918-416003.html), i siguruar në kuadrin e projektit TEMPUS MARED - Modernizing and Harmonizing Maritime Education in Montenegro and Albania. Simulatori përdoret në shumë lëndë karakteristike të fushës navale, si dhe edhe në lëndë të programeve të tjera të studimit, si Bachelor në Inxhinieri Mekanike dhe Bachelor në Inxhinieri Elektrike. Gjithashtu një pjesë e pajisjeve laboratorike të nevojshme për testimin e materialeve janë të vendosura në ambientet e Qendrës Kërkimore Shkencore</p>

	të Fakultetit të Shkencave Teknike, e cila ka stafin përkatës që shërben pranë kësaj qendre. [Tabela 1, Aneks]. Për lëndët të cilat janë jashtë Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare si: Fizikë, Kimi, Informatikë, shfrytëzohen labororet e njërive të tjera bazë të cilat kanë personelin përkatës ndihmës akademik. [Tabela 1, Aneks]. Vlen të theksojmë se DITD duhet të plotësojë me bazë laboratorike dhe lëndët karakterizuese inxhinierike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin AMS të ASCAL, nga takimet me drejtues të njërive kryesore dhe bazë, rezulton se Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë trajnon dhe udhëzon stafin për metodat inovative të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit. UV-ës zhvillon trajnime të ndryshme të vazhdueshme lidhur me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies duke nxitur përdorimin e metodave të reja sipas specifikave të fushës përkatëse. Referuar Planit Strategjik të UV-së 2018-2024, UV synon që të krijojë një sërë vlerash institucionale, të cilat do të pasurojnë infrastrukturën akademike dhe atë institucionale në përgjithësi. Kjo do të ndihmojë në përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	GVJ konstatoi se njësia bazë dhe njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe vlerësimit institucional (NJSBCVI), zhvillojnë mekanizma monitorimi me qëllim vlerësimin periodik dhe të vazhdueshëm të aftësive mësimdhënëse, duke përcaktuar edhe objektivat për të ardhmen. Këto mekanizma fokusohen kryesisht në pyetësorët e studentëve që organizohen dy here në vit, në fund të cdo semestri. Vlerësimi bëhet për lëndën si edhe për performancën e pedagogut. Gjithashtu UV organizon edhe pyetësorë për stafin akademik në lidhje me mësidhenien, studendët, etj. NJSBCVI përpilon raportin e analizës së pyetësorëve, formulari i të cilit është miratur me Vendim Senati Nr 53, datë 20.4.2017 i cili ka për qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikat më të mira. Të dhënat e pasqyruara në këtë raport

	<p>shërbejnë si një instrument i rëndësishëm për Njësitë Kryesore/Bazë për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore aty ku shihet e nevojshme.</p> <p>Duke qënë se Raporti i Analizës së Pyetësorit është viti i dytë rradhazi që përpilohet, për vitin akademik 2018-2019, përveç përpunimit statistikor të pyetjeve të mbyllura të pyetësorit, realizohet gjithashtu një analizë krahasuese si midis përgjigjeve të studentëve në lëndë të ndryshme brenda të njëjtës pyetje edhe midis rezultateve të vitit akademik 2017-2018, duke evidentuar ato pyetje ku ka ndryshime të dukshme.</p> <p>Referuar Procedurës së Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për lëndët e çdo Programi Studimi në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, miratuar me Vendim Senati Nr. 21, datë 08.05.2018, NJSBCVI përveç Raportit të Analizës përpilon dhe projekt propozimet dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë duke e përcjellë me tej pranë strukturave përkatëse të parashikuara në procedurën e analizës së pyetësorëve. Referuar procedurës së sipërcituar raporti i rezultateve të pyetësorëve si dhe rekomandimet e përpiluara prej NJSBCVI-së ju përcillen njësisive kryesore, të cilat realizojnë më tej një konsultim të gjerë me stafin akademik, duke e bërë të gjithë procesin e përmirësimit të programit të studimit nëpërmjet pyetësorit të studentëve transparent dhe gjithëpërfshirës. Njësitë kryesore diskutojnë rezultatet respektive duke dhënë propozime përkatëse, të cilat diskutohen në mbledhjen e Rektoratit</p> <p><i>EVIDENCA III-1_Vendimin Senati Nr.84, datë 12.12.2016.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA III-2_Vendim Senati Nr.8 datë 14.02.2018.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA III-3_Vendim Senati Nr.53, datë 20.04.2017.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA III-4_Vendim Senati Nr. 21, datë 08.05.2018.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion, rezultoi se studentët para përfundimit të cdo semestri përfshihen në sondazhet për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Drejtuesit e njesisë kryesore dhe asaj bazë janë të angazhuar për trajtimin e ankimimeve, nëpërmjet procedurave të cilat janë të sanksionuara dhe në rregulloren e UV-ës nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrjes së studentëve në procesin e anketimit për çdo lëndë; • Garantimit të së drejtës së studentit për ankimimin e rezultatit të vlerësimit të dijës sipas procedurës së përcaktuar në Rregulloren e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë <p><i>EVIDENCA III-6_Vendimi Senatit Nr. 94, datë 13.10.2017.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional, Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional, si struktura përgjegjëse brenda Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, e bën publike rezultatet e vlerësimit, https://univlora.edu.al/te-gjitha-postimet/ [Njoftim 11.12.2019], duke e përcjellë zyrtarisht pranë çdo njësie bazë, respektivisht për programet e studimit që kjo e fundit mbulon, duke i dhënë në këtë mënyrë secilit pedagog</p>

	të njihet me rezultatet e vlerësimit prej anketimit të studentëve, duke evidentuar pikat e dobta dhe të forta.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	<p>NJSBCVI si njësi përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në UV-ës, realizon sondazhet e studentëve dhe harton raportin vjetor me gjetjet e këtij studimi i cili i komunikohet drejtuesve të institucionit. Rezultatet e pyetësorit diskutohen në departament me stafin akademik, e me fokus në shkëmbimin e përvojës në organizimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, mbështetur në praktikat më të mira, si edhe përmirësimin e mësimdhënies dhe elementëve të tjerë didaktikë dhe të komunikimit.</p> <p>UV promovon shembuj të praktikave të mira, nxit e inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies e kërkimit shkencor nëpërmjet mbështetjes financiare dhe jo vetëm. Shembull i kësaj mbështetjeje është rimbursimi i shpenzimeve për kërkimin shkencor (pjesëmarrje në konferenca shkencore e publikime në revista shkencore), apo dhe evidentimi i personelit akademik të disa prej pedagogëve të këtij departamenti,</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Referuar rregullores së programit “Bachelor” në Inxhinieri Mekanike, syllabuseve të lëndëve si dhe takimeve me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se në këtë program studimi, përdoren forma alternative leksione/seminare/ projekte/detyra kursi. Për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksionet: 100.4 kredite - Seminarët: 65.2 kredite - Laboratore/Ushtime: 2.4 kredite - Praktika mësimore: 6 kredite - Teza e diplomës: 6 kredite <p>Praktika mësimore zhvillohet si lëndë e veçantë ku një ditë e javës i dedikohet kësaj lënde. Këto forma mësimdhënie janë të miratuara nga institucioni dhe pasqyrohen në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Mes specifikimeve që ka rregullorja dhe përcaktimeve të këtyre formave në syllabus, GVJ konstaton se ka përputhshmëri.</p> <p>Secila lëndë e përfshirë në këtë plan mësimor shoqërohet prej një syllabusi i cili ndër të tjera jep informacion në lidhje me format e kontrollit të dijës, numrin e kontrolleve të pjesshme.</p> <p><i>EVIDENCA I-10_Syllabuset e lëndëve.pdf</i></p>

<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Referuar takimeve me studentë dhe stafin akademik të programit rezulton se, stafi akademik i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke përshatur dhe ofruar mundësi dhe forma alternative të mësimdhënies, të kontrollit të dijes dhe duke qenë proaktiv për të përmirësuar mësimdhënien e tij. Kështu u konstatua nga takimi me studentët se përveç leksioneve, gjatë seminareve përpos kontrollit të njohurive nëpërmjet pyetjeve/përgjigjeve, diskutimeve, aplikohen edhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> • rastet studimore, • detyrat individuale, • analizat krahasuese mes praktikave më të mira në kontekstin e bizneseve shqiptare
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Nga takimi me përfaqësuesit e institucionit rezulton se Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, me synimin e përmirësimit të kompetencave didaktike, të metodologjive të mësimdhënies, ka zhvilluar leksione të hapura apo trajnime edhe për stafin akademik. Partneriteti në projektet Erasmus + (mobilitete staf vendas dhe të huaj në UV) i ka krijuar mundësi stafit akademik të këtij programi për tu angazhuar në universitetet e tjera partnere në trajnime dhe mësimdhënie në to. Kjo ka ndihmuar stafin akademik në përmirësim dhe në shtimin e eksperiencës në fushën dhe metodat e mësimdhënies.</p> <p>GVJ, referuar CV-ve, fushave të ekspertizës, eksperiencës së stafit, takimeve me studentët dhe perceptimeve të tyre, është i mendimit se, stafi akademik i programit zotëron kompetencat e duhura të mësimdhënies. Një pjesë e stafi është me tituj dhe grada shkencore sikurse edhe me eksperiencë dhe ekspertizë në fushat përkatëse të lëndëve ku ata janë të përfshirë në mësimdhënie. Institucioni ka në qëndër të vëmendjes përfshirjen e studentëve në përmirësimin e cilësisë së personelit akademik dhe të metodave të mësimdhënies. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë nëpërmjet anketave të studentëve, paraqitjes dhe shqyrtimit të ankesave dhe opinionëve të studentëve, synon vlerësimin dhe vendos objektivat për përmirësimin e metodave didaktike.</p> <p>Informacioni i siguruar nga studentët, gjatë vizitës në institucion dëshmon se stafi akademik përdor metoda të ndryshme interaktive për të ndërthurur teorinë me praktikën, por edhe për të rritur atraktivitetin e orëve të mësimin.</p> <p><i>EVIDENCE II -1 _CV Stafi-1.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA II-1 _CV Stafi-2.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ, referuar CV-ve, fushave të ekspertizës, eksperiencës së stafit, takimeve me studentët dhe perceptimeve të tyre, është i mendimit se Personeli akademik i Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare i angazhuar në mësimdhënie, është i kualifikuar sipas profilit të lëndës që zhvillon, i përket kategorisë profesor, doktor dhe Msc. me një angazhim të konsiderueshëm në punën kërkimore shkencore.</p> <p>Punësimi i personelit akademik efektiv apo me kontratë është bërë konform bazës ligjore në fuqi, Ligj Nr 80/2015, Neni 64, pika 1, Neni 57, pika 2, e cila fillon me indentifikimin e nevojave për staf, përcaktimin e kriterëve të punësimit të propozuara nga njësia bazë konform nevojave, miratimin nga titullari i institucionit, dhe shpalljen e kërkesave për personel akademik.</p>

		<i>EVIDENCA III-10_Procedurë punësimi.pdf</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	<p>Rraporti i analizës së pyetësorëve, i përpiluar prej NJSBCVI, ka për qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikatat më të mira. Të dhënat e pasqyruara në këtë raport shërbejnë si një instrument i rëndësishëm për njësitë kryesore/bazë për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore aty ku shihet e nevojshme. Ky raport, përcillet tek secili prej anëtarëve të personelit akademik.</p> <p>Raporti i analizës së pyetësorëve, i përpiluar prej NJSBCVI, ka për qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikatat më të mira. Të dhënat e pasqyruara në këtë raport shërbejnë si një instrument i rëndësishëm për njësitë kryesore/bazë për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore aty ku shihet e nevojshme. Ky raport, përcillet tek secili prej anëtarëve të personelit akademik.</p>				
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.	<p>Informacioni i siguruar nga studentët, gjatë vizitës në institucion dëshmon se stafi akademik përdor metoda të ndryshme interaktive për të ndërthurur teorinë me praktikën, por edhe për të rritur atraktivitetin e orëve të mësimin.</p> <p>Rezultati i pyetësorit tregon se 65% e studentëve janë shprehur se pedagogu inkurajon dialogun diskutimin në orën e mësimin. Po ashtu pyetjes se pedagogu inkurajon mendimin kritik i janë përgjigjur pozitivisht 76% e studentëve, https://univlor.edu.al/te-gjitha-postimet/ (Njoftim dt. 11.12.2019).</p>				
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.	<p>Nga takimi i GVJ me studentët, u shprehen se ata angazhohen në realizimin e detyrave individuale dhe në grup përgjatë gjithë lëndës dhe kjo është mënyrë shumë e mirë e cila inkurajon sensin e autonomisë të studentit. Përgjatë kohës së punës për këto detyra, studentit mbështetet me udhëzime dhe orientime prej pedagogut të lëndës si nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë gjatë orës së mësimin apo orarit të takimit me studentët, konsultimeve, që secili pedagog ka të përcaktuar në programin lëndor, që është bërë i ditur për studentët qysh në prezantimin e parë me lëndën, por edhe nëpërmjet komunikimit elektronik përmes postës elektronike zyrtare personale (emër.mbiemër@univlor.edu.al) të pedagogëve dhe studentëve. Këto forma dhe metoda të mësimdhënies, mbështetur në këto mënyra komunimi ndihmojnë në ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>				
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
				X	

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të	Nga vizita në institucion u konstatua që e gjithë infrastruktura e cila ishte në funksion të procesit mësimor dhe plotëson të gjitha standardet. Të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve, janë të mjaftueshme, duke pasur parasysh edhe

<p>cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>numrin e grupeve të studentëve. Referuar RVB dhe vizitës në institucion, rezulton se godina permban salla për leksione, për seminare dhe bibliotekë. Këto ambiente rezultojnë të jenë në standardet e duhura. Te gjitha ambientet janë me ndriçim, ajrosje dhe mirëmbahen rregullisht nga personeli i Sektorit të Shërbimeve, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.</p> <p><i>EVIDENCA III-12_Struktura e universitetit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës online në institucion, rezulton se sallat në dispozicion të procesit mësimor, disponojnë infrastrukturë dhe logjistikë të pranueshme dhe të nevojshme, poste ulje, tavolina, pod lekturimi, white board, videoprojektor. Një pjesë e pedagogëve të grupit mësimor të Inxhinierisë Mekanike janë të pajisur nga institucioni me videoprojektor, laptop për përdorim në sallën e mësimimit</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Referuar RVB, dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë përdor sisteme të ndryshme informatike mënyrë komunikimin duke përmëndur:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Platformën dixhitale “Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Mësimor të UV-së” Vendim i Senatit Akademik Nr. 101, datë 06.12.2017 me akronimin UVMS (University of Vlora Management System); • Lidhjen e internetit ëi-fi e cila ofrohet pjesërisht në hapësirën e godinës C në dispozicion të Fakultetit të Shkencave Teknike, në të cilin zhvillohet procesi mësimor për këtë program studimi; • Adresat zyrtare të email-it të pedagogëve dhe studentëve (emër.mbiemër@univlora.edu.al), nëpërmjet të cilave realizohet komunikimi pedagog - student dhe anasjelltas, për komunikim, ndarje/caktim detyrash, konsultim, dorëzim detyrash, etj. <p><i>EVIDENCA III-13_Vendim Senati Nr. 101, datë 06.12.2017.pdf</i></p> <p>I gjitha stafi akademik efektiv në zyrën e tij, por edhe stafi me kohë të pjesshme në postet e përcaktuara për ta, janë të pajisur me kompjuter dhe të gjitha mjetet e nevojshme për mbarëvajtjen e punes. Salla e bibliotekës gjithashtu është e pajisur edhe me kompjutera ku studentët mund të punojnë për detyrat e kursit apo për projektet etj.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ nga takimet me stafin akademik, drejtues të njësisë kryesore dhe atë bazë si dhe referuar syllabuseve të lëndëve, konstaton se të gjitha lëndët, kanë literaturën e 5 viteve të fundit. Ndërkohë referuar vizitës në bibliotekën e institucionit, studentët kanë mundësi të sigurojnë këtë literaturë bazë dhe ndihmëse në formën fizike të teksteve mësimore, formateve të ciklit të leksoneve (i cili vihet në dispozicion për studentët prej pedagogut të lëndës në formë të printuar pa pagesë ose elektronike), si edhe në formën elektronike të tekstit mesimor në gjuhë të huaj. Ky i fundit vjen si link apo faqe interneti e sygjeruar prej pedagogut, ku studentët mund ta shkarkojnë pa pagesë, vetëm lexojnë apo edhe të kenë mundësinë ta blejnë online si tekst të ri apo të përdorur (për të gjithë ata që duan dhe kanë mundësinë e blerjes).</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet</p>	<p>Me qëllim garantimin e një numri të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit për studentët, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë ka marrë disa masa konkrete për realizimin e bibliotekës online.</p>

<p>kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Po ashtu në kuadër të një nisme të ndërmarrë nga Konsullata e Përgjithëshme e Italisë në Vlorë si dhe biznesit privat Petrolifera është bërë i mundur sigurimi i një fondi librash bashkëkohore kryesisht për DITD dhe detarinë.</p> <p><i>EVIDENCA III-14_Vendim Senati Nr. 83, datë 18.07.2017.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA III-15_Dhurim tekstesh unversitare Fakultetit të Inxhinierisë.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, mbështetur prej MASR, ka mundur për stafin dhe studentët shërbimin e bibliotekës on-line “ULIBRARY”. Në faqen ëeb të universitetit, personeli akademik dhe studentët kanë mundësi të aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit, duke ndjekur udhëzimet e manualit.</p> <p>Ndërkohë referuar vizitës në bibliotekën e institucionit, për digjitalizimin e standardizuar dhe të unifikuar të librit/tekstit mësimor apo artikujve shkencorë të nevojshëm jemi në proces unifikimi me Rrjetin e Bibliotekave Universitare me lider Bibliotekën e Akademisë së Shkencave. Kjo nisme është në kuadrin e Planit Kombëtar për digjitalizimin e Bibliotekave Universitare dhe atyre të rrjetit, për digjitalizimin e tekstit nga botuesi/ enti botues si dhe për tekstin e digjitalizuar nga specialisti i Bibliotekës.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>GVJ nga takimet me stafin akademik, drejtues të njësisë kryesore dhe atë bazë dhe nga vizita nëpër mjediset e laboratoreve u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Procesi mësimor për studentët të cilët ndjekin programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në Inxhinieri Mekanike zhvillohet në ambientet e godinës C. • Laboratori i simulimit të dhomës së motorrit - Engine Room Simulator i dedikuar për Departamentin e Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare mundëson që një pjesë e leksioneve (për lëndët që i kanë të nevojshme) të zhvillohen në këtë laborator duke përdorur programe soft specifike sipas kërkesave të vetë lëndës. • Studentët shfrytëzojnë gjithashtu laboratorët e departamenteve të tjera sipas lëndëve përkatëse (psh. kimi, fizikë, informatikë). <p>Kjo është një mënyrë e mirë për të integruar lehtësisht rezultatet e kërkimit shkencor me procesin mësimdhënës.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Universiteti i Vlorës përdor disa platforma online. Aktualisht, nëpërmjet platformës online UVMS (Sistemi menaxhimit të informacionit) https://uvms.univlora.edu.al, bëhet e mundur komunikimi i personelit akademik të UV-së me studentët për secilën prej lëndëve të planit mësimor të programit të studimit të ciklit të parë dhe të dytë. Kjo bëhet e mundur falë hapësirës personale (account) të secilit përdorues të këtij sistemi (në rastin konkret personeli akademik dhe studentët). Pedagogu i lëndës ka mundësinë të upload-ojë në sistem materiale mësimore (leksione/prezantime ppt, detyra për studentët dhe komunikime të tjera). Studentën nxiten prej pedagogut të lëndës për përdorimin e këtij sistemi jo vetëm për marrjen e informacionit (të tipit: orari i leksioneve / seminareve, vlerësimet në lidhje me kontrollin e dijeve etj.).</p> <p>Gjatë kohës së karantinës (përiudhës së pandemisë Covid 2019) pedagogë dhe studentë të programit të studimit kanë përdorur platforma online për zhvillimin e</p>

	<p>procesit mësimor. Disa prej këtyre platformave kanë qënë Google Classroom, Google meeting, Zoom, Jitsi, You Tube Mekanike-online, etj.</p> <p><i>EVIDENCA III-17_Manuali i përdorimit të UVMS si pedagogë.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Personeli akademik i UV-së si dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm (nëpërmjet platformës elektronike të UVMS-së) ndër të tjera edhe për të patur akses në dokumentacionin elektronik (p.sh shkarkimi i faturës së tarifës së shkollimit). Aksesi në këtë dokumentacion bëhet nëpërmjet përdorimit të hapësirës vetjake të dedikuar për secilin përdorues të UVMS ose përdorimit të adresa elektronike personale zyrtare (emër.mbiemër@univlora.edu.al).</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Në zbatim të Rregullores së Programit të Studimit të Ciklit të Parë “Bachelor” në Inxhinieri Mekanike, Rregullore e Programit të Studimit Bsc. Inxhinieri Mekanike personeli akademik i caktuar për udhëheqjen e studentëve në punimin e temës së diplomës, orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, si dhe i asiston dhe mbështet ata përgjatë gjithë kohës së punimit.</p> <p><i>EVIDENCA I-1_Programi dhe rregullorja e programit në Bsc Inxhinieri Mekanike, Kurikula e programit mësimor shoqëruar me abstraket e lëndëve_compressed.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA III-18_Procedurë e Diplomimit me temë diplome.pdf</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>UV ka hartuar politika, si dhe ka ngritur struktura në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Në kuadër të zbatimit të këtyre politikave, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standarteve të cilësisë, NJSBCVI ka përpiluar raportin e analizës së pyetësorëve të studenteve, https://univlora.edu.al/te-gjitha-postimet/ (Njoftim dt. 11.12.2019), [Evidenca L] i cili ka për qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikat më të mira.</p> <p>GVJ konsultoi raportin vjetor për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor i cili konsiderohet një formë që i shërben plotësisht të këtij kriteri, por GVJ është e mendimit se: NJSBC duhet të hartojë, në mënyrë të posaçme dhe të detajuar për gjithë aktivitetin e vet, mekanizmat e përdorur dhe identifikimin e praktikave të mira /problematikave dhe të propozojë/adresojë zgjidhje për to.</p> <p>GVJ është e mendimit se institucioni duhet të përmirësojë ndjeshëm dokumentimin e vazhduar të proceseve të realizuara për përmirësimin e cilësisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <i>EVIDENCA I-8_Analizat Vjetore 2017, 2018, 2019.pdf</i>

	<ul style="list-style-type: none"> • <i>EVIDENCA III-19_Analizë dhe rekomandime mbi raportin e pyetësorit të studentëve.pdf</i>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Nga takimi me GVB, me përgjegjës të departamentit, rezultoi se njësia bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe jep informacion të detajuar për cilësinë e programit të studimit dhe përmbajtjen e tij ndaj studenteve. Secili pedagog i programit të studimit në fillim të semestrit rishikon syllabus-in e lëndës, i cili më pas shqyrtohet nga përgjegjësi i departamentit për zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p> <p>Përcaktuar edhe nga ligji i arsimit të lartë, Departamenti që ofron programin e studimit është përgjegjës për gjithë cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe të të nxëniet që ai ofron. Njësia bazë mbështet dhe nxit proceset, të cilat synojnë rritjen e vetëdijes për rëndësinë e cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare më konkretisht Zv Dekani për anën akademike, Drejtuesi i Departamentit si dhe Drejtuesi i Grupit Mësimor Inxhinieri Mekanike dhe Navale, janë përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personelit akademik, i cili është i angazhur në ofrimin e lëndëve të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në Inxhinieri Mekanike dhe studentëve të cilët ndjekin këtë program studimi.</p> <p><i>EVIDENCA III-19_Analizë dhe rekomandime mbi raportin e pyetësorit të studentëve.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Zhvillimi i trajnimeve për metodat e mësimdhënies, është tregues i nxitjes së njësisë bazë për përdorimin e metodave të reja. Njësia bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik. Nga takimi me GVB, me përgjegjës të departamentit, rezultoi se njësia bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe jep informacion të detajuar për cilësinë e programit të studimit dhe përmbajtjen e tij ndaj studenteve.</p> <p>Aktualisht në Universitetin “Ismail Qemali” është miratuar dhe formalizuar “Udhëzuesi mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit. Staf i akademik në Departamentin e Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare është gjithmonë i vëmendshëm në marrjen e informacionit të përditësuar në lidhje me metodat inovative të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me drejtuesin e departamentit përgjegjës për këtë program studimi, dhe pedagogët u konstatua se stafi akademik kualifikohet në mënyrë të vazhdueshme sipas fushave të kërkimit shkencor individual. Në kontekstin e kërkimit shkencor stafi i Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare ka arritur të mira. Kjo pasqyrohet përmes treguesve dhe raporteve mbi artikujt shkencorë të botuar në revista të huaja, pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare të organizuara brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të mësimdhënies, dhe = të kërkimit shkencor në Universitetin e Vlorës. janë një sërë dokumentash dhe rregullore si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullore e Etikes dhe kërkimit shkencor,



	<ul style="list-style-type: none"> • Strategjia për Trajnimin e vazhdueshëm të Kërkuesve të rinj. • Strategjia e kërkimit shkencor FSHT, • Strategji e kërkimit shkencor DITD 2017-2022 <p><i>EVIDENCA III-21_Strategjia e kërkimit shkencor FSHT.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA III-22_Strategji e kërkimit shkencor DITD 2017-2022.pdf</i></p>										
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Nga takimet me stafin akademik u vu re një prirje e vazhdueshme për rritjen e cilësisë së mësimdhënies si dhe për përputhjen e tij me objektivat e programit të studimit. I gjithë stafi, dhe vecanërisht ai i ri, trajnohet me mënyrën e funksionimit të cilësisë. Mobiliteti i stafit akademik realizohet në kuadër të: projekteve të zhvillimit të kapaciteteve të arsimit të lartë si projekti Erasmus +.										
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	GVJ gjatë vizitës në institucion konstaton se personeli ndihmës akademik, është i angazhuar për të kryer detyrat, angazhimi i pedagogëve nga departamentet e tjera të Fakulteti i Shkencave Tekniket dhe bashkëpunimi në vazhdimësi për të siguruar nevojat e programit të studimit është një element pozitiv për këtë program studimi. Në ndihmë të personelit akademik i cili bën përpjekje të konsiderueshme për të realizuar programet mësimore, angazhohet stafit ndihmës akademik i cili ka nevojë për trajnim të vazhdueshëm në ofrimin e shërbimit. Nga konsultimi me RVB-në theksohet që mbështetja e institucionit nuk është prezente sa duhet <i>EVIDENCA I-1_Programi dhe rregullorja e programit në Bsc Inxhinieri Mekanike, Kurrikula e programit mësimor shoqëruar me abstraket e lëndëve_compressed.pdf</i>										
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Gjatë takimit që GVJ pati me stafin akademik u theksua se prej tyre synohej një mësimdhënie dhe komunikim interaktiv duke shmangur në maksimum mësimin tradicional ku lektorët janë folës dhe studentët dëgjues. Sipas tyre, kjo mënyrë e mësimdhënies ishte më efektive sepse shmangte monotoninë dhe rriste vëmëndjen dhe përfshirjen e studentit në orën e mësimi										
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Shkalla e përbushjes së standardit</th> <th>Plotësisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Shkalla e përbushjes së standardit	Plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X	
Shkalla e përbushjes së standardit	Plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht							
			X								

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Nga takimi I GVJ me studentet të cilët ndjekin programin e ciklit të parë të studimit “Bachelor” në Inxhinieri Mekanike, ata u shprehën së njihen me këto rregullore: <ul style="list-style-type: none"> • Rregulloren e universitetit, e cila është e publikuar on-line në faqen zyrtare të universitetit (https://univlora.edu.al/rregullorja/);

	<ul style="list-style-type: none"> • Rregulloren e Programit të Ciklit të Parë të Studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekanike neni 9 dhe 11”; • Rregullore e Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare. [Evidenca I.6] <p>Specifikisht me atë pjesë të secilës rregullore që është e dedikuar vetëm për studentët, qysh në ditën e parë të shkollës në vitin e parë të frekuentimit, si dhe orientohen se ku mund t’i gjejnë këto rregullore të publikuara.</p> <p>Mënyrë tjetër për prezantimin dhe njohjen e studentëve me kriteret dhe mënyrën e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale është edhe prezantimi i syllabusit. Syllabuset e lëndëve prezantohen prej pedagogut të lëndës qysh në orën e parë të çdo lëndë / modul.</p> <p>Të gjithë dokumentat e sipërpërmendur publikohen në website-in e UV-së</p> <p><i>EVIDENCA I-1_Programi dhe rregullorja e programit në Bsc Inxhinieri Mekanike, Kurikula e programit mësimor shoqëruar me abstraket e lëndëve_compressed.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA I-6Rregullore e Departamentit DITD-së .pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA I-10_Syllabuset e lëndëve.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit:</p>	<p>Referuar “Rregullores së Programit të Ciklit të Parë të Studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekanike” të ofruar në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë”, rezulton se janë të parashikuara dhe të përcaktuara mënyrat e vlerësimit të studentëve si dhe për detyrimin e studentëve për nivelin e frekuentimit të programit. Kontrolli i dijes për studentët, realizohet nëpërmjet vlerësimit semestral.</p> <p><i>EVIDENCA I-1_Programi dhe rregullorja e programit në Bsc Inxhinieri Mekanike, Kurikula e programit mësimor shoqëruar me abstraket e lëndëve_compressed.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Skema e vlerësimit për çdo komponent të kontrollit të dijes përcaktohet në syllabus. Kështu në shumicën e lëndëve elementët e skemës së vlerësimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrja në leksione dhe aktivizimi në seminare • Kontrolli i ndërmjetëm • Detyra e kursit • Provimi përfundimtar <p>Referuar rregullores së programit, syllabuseve dhe informacionit të siguruar nga stafi akademik dhe studentët, rezulton se specifika të provimeve, pesha (përqindja) e secilit provim apo detyre në vlerësimin përfundimtar, detyrat e kursit, projektet individuale, apo forma të tjera të vlerësimeve gjatë vitit, përcaktohen në syllabus-in e lëndës të hartuar nga pedagogu dhe u bëhet i ditur studentëve që ndjekin atë kurs në fillim të procesit mësimor në syllabus janë parashikuar format e vlerësimit, masa e vlerësimit të çdo komponenti.</p> <p><i>EVIDENCA I-1_Programi dhe rregullorja e programit në Bsc Inxhinieri Mekanike, Kurikula e programit mësimor shoqëruar me abstraket e lëndëve_compressed.pdf</i></p>

	<i>EVIDENCA I-6 Rregullore e Departamentit DITD-së .pdf</i>			
	<i>EVIDENCA I-10_Syllabuset e lëndëve.pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	<p>Është në politikën e institucionit vlerësimi i përgatitjes akademike në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë vitit shkollor. GVJ referuar burimeve alternative, syllabuseve, stafit akademik dhe studentëve, konkludon se vlerësimi është semestral, me komponente të tillë si detyra individuale, detyra kursi, provime të ndërmjetme dhe provimi final. Të gjithë komponentët reflektohen në vlerësimin final.</p> <p>E përmbledhur është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Provimi përfundimtar (55-65%) e vlerësimit të përgjithshëm, • Provimi i ndërmjetëm (25-30%) e vlerësimit të përgjithshëm, • Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive në seminare, punë laboratorike, detyra/projekte kursi (10-15%) e vlerësimit të përgjithshëm. <p><i>EVIDENCA I-10_Syllabuset e lëndëve.pdf</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Aktualisht, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, nuk ka në zbatim një sistem elektronik testimi dhe vlerësimi të studentëve avantazhet e të cilit do të rrisin transparencën dhe mundësonin reduktimin në maksimum të abuzimit dhe subjektivitetit në vlerësimin e studentëve.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	<p>Nga komunikimi me stafin akademik dhe drejtuesin e njësisë bazë, rezulton se testimi përfundimtar realizohet nga një komision, i cili rezulton se ka jo më pak se 2 anëtarë.</p> <p>Këto komisione, përcaktohen prej Drejtuesit të Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, në zbatim të rregullores së këtij programi studimi dhe bëhen publike përpara datës së përcaktuar për kontrollin e dijes (i pjesshëm/përfundimtar), në kohën e parashikuar prej Rregullores së Universitetit.</p>
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, nuk zhvillohet në mënyrë anonime. Pedagogu i lëndës është përgjegjës për mbarëvajtjen e provimit deri në shpalljen e rezultateve për studentët. Rregullore e UV-së parashikon procedura strikte në lidhje me afatet e editimit të rezultateve të provimit në sistemin UVMS. Po ashtu, institucioni siguron infrastrukturën e posaçme të monitoruar me personel (komision për zhvillimin e procesit të provimit).
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale	Pas përfudimit të çdo provimi apo formave të tjera të kontrollit të dijeve, rezultatet editohen në UVMS jo më larg se 48 orë nga dita e zhvillimit të tij.

<p>shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Një ditë pas shpalljes së rezultateve, studentëve të cilët ndjekin studimet e ciklit të parë në programin “Bachelor në Inxhinieri Mekanike”, u jepet e drejta:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shikojnë individualisht tezat e korrigjura prej pedagogut, duke parë në këtë mënyrë vlerësimin për secilën përgjigje të tyre (edhe komentin me shkrim nga ana e pedagogut në tezën e provimit sa herë ai e shikon të nevojshme dhe të arsyeshme për t'i bërë); • të paraqesin ankesat e tyre në lidhje me saktësinë e korrigjimit dhe vlerësimin nga ana e pedagogut; <p>Kjo e drejtë e studentëve garantohet në rregulloren e universitetit.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>GVJ bazuar në rregulloren e institucionit, në rregulloren e programit të studimit por edhe RVB, evidenton se pedagogu i lëndës/modulit apo komisioni i provimit, si hallka e parë në sigurimin e respektimit të Kodit të Etikës në procesin e kontrollit të dijeve brenda UV-së, bëjnë të mundur shmangien dhe zvogëlimin e mundësisë për plagjiaturë, kopjim në provime dhe detyra dhe njëkohësisht përcjellin për procedura të mëtejshme pranë autoriteteve, njësitë përgjegjëse për ndjekjen e zbatimit të Kodit të Etikës dhe marrjen e masave përkatëse.</p> <p>Për evidentimin dhe kontrollin e plagjiaturës GVJ nuk evidentoi ndonjë informacion nëse institucioni disponon një program për kontrollin e saj</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Nga takimi me studentët e këtij program studimi, rezulton, se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale jepen në kohë sipas procedurës së parashikuar në rregulloren e Universitetit dhe rregulloren e programit të studimit. Në seancën e fundit mësimore studentët informohen për vlerësimet gjatë semestrit. Këto vlerësime janë komponentë të vlerëimit final.</p> <p>Nga ky takim për GVJ, rezulton se perceptimi i tyre është për vlerësim mbi bazë të meritës dhe jo nëpërmjet ofrimit në cilëndo formë, privilegj, përfitim, ndërhyrje, favorizim, pagesa apo dhurime, vetë apo nëpërmjet personave të tjerë, me qëllim marrjen e rezultateve të larta, apo favorizime të tjera, të cilat lektori apo anëtarë të tjerë të personelit të Universitetit mund t'i kryejnë për shkak të detyrës.</p> <p><i>EVIDENCA I-1_Programi dhe rregullorja e programit në Bsc Inxhinieri Mekanike, Kurikula e programit mësimor shoqëruar me abstraket e lëndëve_compressed.pdf</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerëimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerëimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të depozituar nga UV-ës por edhe takimeve me studentët e programit, studenti ka të sanksionuar të drejtën për tu njohur me vlerësimin, me menyrën e korrigjimit, për të qenë i qartë për gabimet/mungesat në përgjigje dhe për vlerësimin sipas meritës. Në rast se studenti edhe pas marrjes së rezultateve nuk është i bindur për saktësinë e vlerëimit atëherë ai ka të drejtë që brenda afateve të parashikuara në rregullore të paraqesë një kërkesë me shkrim drejtuesit të departamentit që mbulon kursin përkatës brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni dekanin.</p>

	<i>EVIDENCA I-1_Programi dhe rregullorja e programit në Bsc Inxhinieri Mekanike, Kurikula e programit mësimor shoqëruar me abstraket e lëndëve_compressed.pd</i>			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	GVJ referuar Rregullores së institucionit, konstaton se studenti ka të drejtë të ankimojë në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Ankesa i paraqitet me shkrim Drejtuesit të Departamentit brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni dekanin. Dekani, brenda 48 orësh nga marrja dijeni për ankesën nga Drejtuesi i Departamentit, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit. Ndryshimet në rezultatet e studentëve pasqyrohen në procesverbalin të ri të firmosur nga komisioni, i cili i bashkëlidhet procesverbalit të mëparshëm dhe pasqyrohet në sistemin elektronik UVMS. Kjo procedurë parashikohet në rregulloren e universitetit dhe atë të programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekanike”.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekanike” është konceptuar si një bashkësi dijesh në fushën e inxhinierisë mekanike, ku lëndët e programit mësimor kategorizohen në përputhje me VKM 41 datë 24.01.2018, “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë”. Veprimtaritë formuese që karakterizojnë këtë program studimi ndahen: mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore), studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitje e tezës së diplomës, etj) Lëndët karakterizuese që formojnë anën profesionale, janë përzgjedhur që mundësojnë njohuri teorike e praktike në lëmin e zbatimeve të inxhinierisë mekanike dhe krijon premisa për thellimin e njohurive në studimet në nivelin master ose në aktivitetin e tyre në tregun e punës. <i>EVIDENCA I-1_Programi dhe rregullorja e programit në Bsc Inxhinieri Mekanike, Kurikula e programit mësimor shoqëruar me abstraket e lëndëve_compressed.pd</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe	Programi i ciklit të parë të studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekanike” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, gjuhëve të huaja, manaxhimit etj.

ndërveprimet (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Përfshirja e lëndëve karakterizuese dhe me karakter ndërdisiplinor e integrues mundëson zhvillimin e aftësive në drejtim të zbatimeve të thjeshta industriale, teknologjisë mekanike, standardet etj. Krijimi i aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit do të kërkonte ndryshime thelbësore në kurrikul.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Sipas takimeve me stafin e studentët, zhvillohen diskutime dhe analizohen kompetencat që fitojnë studentët nga seicila lëndë, por për këtë çështje nuk ka evidencë. Për herë të parë këtë vit, kompetencat profesionale u diskutuan në një tryezë të përbashkët midis studentëve, pedagogëve dhe biznesit Eorskshop, datë 18/12/2019, tema “Studentët dhe tregu i punës”. <i>EVIDENCA III-23_workshop, datë 18-12-2019, tema “Studentët dhe tregu i punës”.pdf</i>
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Takimi me studentët dhe pedagogët konfirmoi se në përgjithësi, në fund të lëndës, pedagogët zhvillojnë seanca konsultimi me klasën në lidhje me evidentimin e çështjeve më të rëndësishme të lëndës dhe orientojnë studentët në përgatitjen për provim apo implementimin e tyre në praktikë.
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga ana DITD në bashkëpunim me Drejtorinë e Komunikimit dhe Burimeve njerëzore, është organizuar orë e hapur mësimore me lektor të huaj, që zhvilloi leksion mbi zhvillimet e reja në fushën e shkencës, (leksione të hapura nga pedagogë të huaj të ardhur me projekte të ndryshme dhe pedagogëve tanë. <i>EVIDENCA III-25_Leksione të hapura nga pedagoge të huaj të ardhur me projekte të ndryshme dhe pedagogë tanë.pdf</i>
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Mësimdhënia me lëndët e planit mësimor për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor në Inxhinieri Mekanike”, realizohet prej stafit akademik mbi bazë kompetencash, në mënyrë të veçantë për lëndët të cilat u japin studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë. Studentët duhet të testohen t’i aplikojnë këto kompetenca në laboratorë kompjuterikë (si p.sh. për lëndët Informatikë, Kimi, Aplikime kompjuterike në Inxhinieri). Studentët materializojnë dijet e fituara në detyra apo projekt kurs, ku qëllimi është testimi i kompetencave të fituara. Për zhvillim më të mirë të kompetencave profesionale, DITD duhet të gjejë mjetet e nevojshme dhe burimet e financimit për ngritjen dhe plotësimin gradual me laboratorë për të gjithë lëndët profesionale.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/ çështjeve të caktuara.	Takimi me studentët tregoi se pedagogët zhvillojnë diskutime dhe organizojnë punë në grup për studentët në kryerjen e detyrave të kursit apo zgjidhjen e problemeve të caktuara nga fusha e studimit të lëndëve konkrete.
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Pedagogët krijojnë ambient të përshtatshëm jo vetëm për diskutimin e çështjeve të caktuara teknike, por edhe në zhvillimin e ideve innovative që studentët mund të marrin si nxitje nga praktikat profesionale në grup apo individuale. Studentët mbështeten me literature shtesë apo referenca teknike për studim të pavarur.

Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Mbështetja financiare e institucionit për zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore deri më tani ka qenë për stafin akademik, ndërkohë që përfshirja e studentëve në këto projekte bëhet jo prej fondeve të vetë UV por me fonde të projekteve në të cilat UV ka qenë partner. <i>EVIDENCA I-4 _ Listë e bashkëpunimeve të DITD-së në kuadër të projekteve me Universitete të Huaja (Tempus, Erasmus, etj)_compressed.pdf</i>			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Personeli akademik në UV DITD priret të unifikojë metodat e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese jashtë vendit me qëllim që të mundësojë mobilitet studentësh. Gjatë viteve akademike 2017-2018 dhe 2018-2019 janë realizuar 8 mobilitete studentësh nga DITD, gjë që tregon një ecuri të mirë në këtë drejtim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	DITD ka procedure diplomimi për studentët e programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekanike”, e cila shpjegohet në rregulloren e programit të studimit dhe të DITD. Këto rregullore gjenden në faqen ëeb të UV dhe studentët kanë dijeni për këtë. Diplomimi i studentëve bëhet me provim final ose me temë diplome, gjë që përcaktohet në rregullore bazuar mbi notën mesatare. Rregullorja përcakton kohën e aplikimit dhe kufirin minimal të krediteve të fituara që duhet të ketë studentit për të fituar të drejtën e aplikimit për diplomim në sekretarinë mësimore.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Pedagogët e DITD që mbulojnë programin e studimit dhe stafi i sekretarisë mësimore informojnë studentët dhe iu vënë në dispozicion material për provimin final të diplomimit apo për temat e diplomave. Provimi final i diplomimit bazohet tek lëndët karakterizuese, sipas peshës në kredite që ato kanë në planin mësimor.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	DITD ngre komision të posaçëm për provimin e diplomimit, i cili mund të zhvillohet si provim me shkrim ose si mbrojtje e nje teme diplome. Në rastin e provimit me shkrim, testimi përmban njohuri nga lëndët karakterizuese të zhvilluara gjatë 3 viteve të studimit dhe pasha e tyre në provim është në përputhje me peshën që ka lënda përkatëse në planin mësimor.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Për temat që trajtohen në provimin final të diplomimit, studentët njihen nëpërmjet udhëzimeve që marrin prej pedagogëve 3 muaj para provimit. Për studentët që përgatiten për provimin final, pedagogët organizojnë edhe konsultime.

	Studentët me mesetare mbi 9 fitojnë të drejtën e diplomimit me temë diplome. Edhe këta studentë marrin orientimet e nevojshme prej pedagogëve si në përzgjedhjen e temës ashtu edhe në zhvillimin e saj.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Studentët që punojnë për mbrojtjen e temës së diplomës, asistohen prej DITD duke iu vënë në dispozicion laboratorët apo bibliotekën e FSHTN si dhe ndihmën e subjekteve bashkëpunëtoresh të saj për rastin kur objekti i temës së diplomës nuk mund të zhvillohet (matjet, analizat, testet) në ambientet e UV
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Udhëheqësi i diplomës, bazuar në rregulloren e programit të studimit, asiston studentin diplomant në çdo hap të zhvillimit të saj, duke filluar me përzgjedhjen e literaturës, kontrollin e matjeve ose simulimeve, udhëzon për strukturën e shkrimit të tezës dhe saktësisht e vlefshmërinë e rezultateve. Në fund të procesit të hartimit të tezës, ai shprehet me shkrim për cilësinë e punimit dhe aprovon paraqitjen e temës para komisionit të mbrojtjes së diplomave. Vlerësimi i pedagogut udhëheqës është një element i rëndësishëm në vlerësimin me notë të studentit prej komisionit. <i>EVIDENCA III-30_Fletë detyre me vlerësimin e pedagogut udhëheqës.pdf</i>
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë. Për rastin e provimit final, nota vendoset nga pikët e grumbulluara nga gjithë pedagogët e komisionit të provimit që vlerësojnë ushtrimet nga lëndët përkatëse. Në rastin e mbrojtjes së temës, nota vendoset nga mesatarja e notave që vendos secili prej anëtarëve të komisionit. <i>EVIDENCA I-1_Programi dhe rregullorja e programit në Bsc Inxhinieri Mekanike, Kurikula e programit mësimor shoqëruar me abstraket e lëndëve_compressed.pdf</i> <i>EVIDENCA III-27_Rregullore e Diplomimit të FSHT.pdf</i>
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet financiare dhe kanë fituar 180 kredite, pajisen me diplomë dhe suplementin e diplomës që hartohen në përputhje me kërkesat e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. Përmbajtja dhe forma e Diplomës është në përputhje me udhëzimet e MASR. Diploma e Programit të Ciklit të Parë të studimeve Bachelor në Inxhinieri Mekanike shoqërohet me listën e notave (në listën e notave që shoqërojnë diplomën pasqyrohen vetëm notat përfundimtare kaluese ≥ 5 të çdo lënde) dhe me suplementin e diplomës. <i>EVIDENCA III-31_Diplomë e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike & Suplementi i diplomës për programin e studimit Bachelor në Mekanike..pdf</i>
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Pas përfundimit të studimeve, studentëve që paraqesi kërkesë në sekretarinë mësimore, iu vihet në dispozicion kundrejt pagesës : lista e notave, suplementi i diplomës dhe programi i plotë i studimeve. Programi i plotë i studimit në gjuhën shqipe ose anglisht vihet në dispozicion të studentit me kërkesë të tij. Tarifa e kësaj pagese përcaktohet me Vendim të Senatit Akademik të UV. Kjo kopje zyrtare i dorëzohet kërkuarit jo më vonë se 10 ditë nga kërkesa.

Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	UV ruan në sekretarinë mësimore këto të dhëna për studentët: <ul style="list-style-type: none"> • Regjistrin themeltar me të dhënat personale • Regjistrin e notave të marra gjatë programit të studimit • Regjistrin e lëshimit të diplomave e çertifikatave. <p>Këta regjistra janë sipas formateve të miratuara nga MASR. Këta regjistra ruhen për kohë të pacaktuar. Përveç tyre, sekretaria ruan edhe provimet e studentëve deri në fund të semestrit pasardhës. Temat e diplomave ruhen në Bibliotekë për një periudhë të pacaktuar.</p> <p>Nëse kërkohet, sekretaria mësimore i jep studentit informacion në lidhje me dokumentat që ka në ruajtje dhe i arkivon për periudhë të pacaktuar.</p>			
	Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.	<p>Përgjegjës në UV për menaxhimin e vazhduar të burimeve njerëzore duke përfshirë dhe personelin akademik është Sektori i Burimeve Njerëzore dhe të Protokoll-Arkivës, si pjesë e Drejtorisë së Komunikimeve dhe Burimeve Njerëzore [Evidenca III.2]. Ky sektor është gjithashtu struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programet e studimit (http://univlora.edu.al/administrata/; http://univlora.edu.al/en-organigrama). Struktura e detajuar e UV jepet në Evidencën III.12.</p> <p>Në kontratat individuale të punës, UV ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas funksioneve të stafit përbërës të tij.. Bashkangjitur me kontratën është edhe përshkrimi i punës për çdo punonjës. Përgjegjësitë për çdo funksion janë të përcaktuara edhe në rregulloren e FSHT dhe DITD [Evidenca I.5 dhe Evidenca I.6] si dhe në statusin dhe rregulloren e UV [Evidenca A dhe Evidenca C]. Detyra të tjera specifike për stafin përcaktohen në dokumenta të tjerë si: Rregullore programit të studimit, rregullore diplomimit, rregullore praktikave profesionale, etj.</p>

	<p>Sektori i Burimeve Njerëzore dhe të Protokoll-Arkivës [shih: neni 89 i Evidencës C] disponon një dosje të plotë, për secilin prej anëtarëve të personelit akademik të brendshëm, të përgjegjës të programit, të stafit ndihmës akademik. Këto të dhëna përditësohen prej vetë stafit akademik duke plotësuar informacionin në lidhje me karrierën apo titujt e fituar në kohë. Ky informacion është pjesë integrale e detyrës së Përgjegjës të Sektorit, i cili përgatit një informacion të detajuar për evidencat e punonjësve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Punësimi i personelit akademik dhe ndihmës akademik bëhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për arsimin e lartë si dhe me dokumentat bazë të UV, si: Statuti dhe Rregullore e UV [Evidencat A dhe C]. Departamenti në fillim të çdo viti akademik analizon nevojat dhe kërkesat për stafin akademik për mbulimin e lëndëve të ofruara në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Mekanike duke përpiluar një dokument të planit të ngarkesave mësimore për stafin actual [Evidenca II.6]. Me hartimin e këtij dokumenti, departamenti parashikon se cilat janë nevojat për staf. Këto nevoja për staf përcillen në rektorat në zbatim të Rregullores së Universitetit [Evidenca C, neni 29]. Pas vlerësimit të kërkesave [Evidenca A, neni 51] në referencë të nevojave të mësimdhënies e kërkimit shkencor bëhet publikimi i vendeve të lira të punës në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen web të universitetit:</p> <p>(http://univlora.edu.al/2019/10/21/personel-akademik-me-kohe-te-pjesshme-ne-grup-lendet-e-inxhinierise-navale-dhe-mekanike/).</p> <p>[Evidenca IV.1]. Përgjegjës për ndjekjen e të gjitha procedurave në lidhje me rekrutimet e reja është Sektori i Burimeve Njerëzore [Evidenca C, neni 27, 28], duke filluar me koordinimin e punës me DITD [Evidenca III.10], si Njësia Bazë përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi, më pas me shpalljen e vendit të punës në buletin e Njoftimeve Publike, hartimin e ofertës së punës, kriteret e pranimit, ngritjen e komisioneve të vlerësimit, vlerësimin e dosjeve, zhvillimin e konkursit, dhënien e informacionit përfundimtar dhe shpalljen e vendimit. Kjo drejtori është përgjegjëse, në bashkëpunim me departamentin, për plotësimin e nevojave të programit të studimit për staf akademik si dhe për procesin e përzgjedhjes së stafit akademik të ftuar. Vlerësojmë se gjithë këto procedura janë në përputhje me bazën ligjore në fuqi, satutin dhe rregulloren e Universitetit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e posaçme për rekrutimin e personelit janë të përcaktuara në Statutin e UV [shih: Evidenca A, neni 38, pika e, f, j, neni 51, neni 52; Evidenca C, neni 28, 29 dhe Evidenca III.10]]. Statuti dhe Rregullorja e UV janë publike në faqen web të UV:</p> <p>(https://univlora.edu.al/statuti/) ; https://univlora.edu.al/rregullorja .</p> <p>Rregullorja e rekrutimit të stafit akademik dhe ndihmës akademik janë konform gjithë kuadrin ligjor për arsimin e lartë [Ligji 80/2015, neni 59]. Konkretisht, procedura fillon me përcaktimin e nevojave për staf akademik (duke specifikuar kategorinë) prej vetë njësisë bazë (grupit mësimor Inxhinieri Mekanike dhe Navale) dhe propozimin për kriteret specifike në përputhje me nevojat konkrete për staf, të cilat miratohen në mbledhjen e departamentit, e më pas përcillen për miratim të mëtejshëm tek Dekani,</p>

	<p>Rektori e Senati Akademik [Evidenca III.10]. Së bashku me kriteret e përgjithshme të diktuar nga baza ligjore në fuqi, këto kriteret publikohen prej vetë universitetit në Buletin e Njoftimeve Publike dhe në faqen ëeb të universitetit [Evidenca IV.1]. Duke respektuar të gjitha afatet e përcaktuara e të bëra publike, ndiqen hapat e plotë për të përfunduar procedurën e rekrutimit. Çdo hap i kësaj procedure duke filluar me identifikimin e nevojës për staf prej Njesisë Bazë, miratimin e kriterëve, publikimin, procesin e vlerësimit të kandidatit dhe vendimi i marrjes në punë janë të dokumentuara në dosjen e personelit në Zyrën e Burimeve Njerëzore të universitetit [shënime nga vizita monitoruese në UV].</p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Siç e vërejtëm në vlerësimin e kriterit të mësipërm procedurat e rekrutimit dhe të vlerësimit të stafit akademik bëhen mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura paraprakisht dhe në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi dhe aktet rregullatorë bazë të UV (Statutin dhe Rregulloren e UV). Kriteret e përgjithshme përshkruhen tek Statuti dhe Rregullorja e UV ndërsa dhe kriteret specifike propozohen prej Njesisë Bazë, në reference të specifikeve e kërkesave të lëndës/grup lëndëve për mbulimin e të cilave kërkohet ky staf [Evidenca III.10] si dhe bëhen publike në Agjensinë përkatëse të prokurimeve publike por dhe në faqen ëeb të UV: (http://univlora.edu.al/2019/10/21/personel-akademik-me-kohe-te-pjesshme-ne-grup-lendet-e-inxhinierise-navale-dhe-mekanike).</p> <p>Përcaktimi i kriterëve specifike duke ndjekur këtë logjikë dhe duke u përcaktuar nga DITD si njësi që ka këto neoja garanton përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Si rezultat i investimeve të bëra prej vetë universitetit në ambientet e godinës C, janë krijuar ambiente komode pune për stafin akademik, për stafin ndihmës akademik e administrativ, Drejtuesit e Njësive Bazë e të Njesisë Kyresore. Në këtë godinë zhvillohet dhe procesi mësimor për të gjithë studentët të cilët ndjekin programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Mekanike, duke mundësuar krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale [shënime nga vizita monitoruese në UV].</p> <p>DITD për zhvillimin e procesit mësimor ka në dispozicion një numër sallah leksionesh/seminarësh në përputhje me nevojat e parashikuar në planin mësimor. Këto ambjente mësimi ndodhen në godinën C, të cilat shfrytëzohen njëkohësisht edhe nga njësitë e tjera të UV. Përgjithësisht, sallah e leksioneve janë të pajisura me mjetet e domosdoshme për zhvillimin</p>

	<p>në formë tradicionale të mësimdhënies [shënime nga vizita monitoruese në UV].</p> <p>DITD zotëron një sallë laboratorike (Laboratori salla C 201) e paisur më bazë kompjuterike dhe me softeve inxhinierike të tillë si CATIA, MaxSurf, SAP, Simulatorin e dhomës së motorrit etj. të Inxhinierisë Mekanike dhe Navale. Në këta laboratorë ndodhen pajisje dhe mjete për përgatitjen teorike dhe praktike të studentëve të DITD [shënime nga vizita monitoruese në UV]. Laboratori i DITD-së C 201 mundëson realizimin e procesit mësimor për disa lëndë.</p> <p>Sipërfaqja e ambienteve plotëson normën e sipërfaqes së shfrytëzueshme prej 3.8-4 m²/student dhe 7.5-8 m²/staf të përcaktuara nga standartet shtetërore të cilësisë [Evidenca IV.2]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Detyrimi i universitetit në mbështetjen e stafit akademik për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit është e shprehur dhe në dokumentat bazë të UV si Statuti, Strategjia dhe Rregullore e UV [Evidenca A; B dhe C]. Ndihma ka qënë konkrete, e konsiderueshme dhe e vazhdueshme, vecanërisht në realizimin e mobiliteteve të ndryshme për periudha të shkurtra kohore, në kuadër të programt Erasmus+ apo mundësive të tjera siç janë projekte të ndryshme [Evidenca I.4]. Në funksion të kësaj, është hartuar dhe është duke u zbatuar strategjia e ndërkombëtarizimit e universitetit dhe një strategji pesë vjecare për kërkimin shkencor 2017-2022 [Evidenca D].</p> <p>Mbështetja financiare është e konkretizuar edhe përmes mbështetjes financiare nga buxheti i UV për pjesmarrje në projekte kërkimore, zhvillimore, për realizimin e punës shkencore (pjesmarrje në konferenca shkencore e publikime në revista shkencore), e cila të ofrohet për secilin prej anëtarëve të stafit akademik [Evidenca IV.5].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Stafi i UV dhe i DIOTD në veçanti inkurajohet të përdorë metoda të larmishme të mësimdhënies në funksion të arritjes së objektivave të programit të lëndës. Ata janë të interesuar në njohjen dhe aplikimin e metodave bashkëkohore të arritjeve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Këtu vlen të theksohet dhe organizimi i mësimit on-line në kushtet e pandemisë së Covid-19 [Evidenca III.17]. Kualifikimi mëtejshëm i stafit akademik parashikohet në dokumentat e zhvillimit strategjik si: “Plani Strategjik 2018-2024” të UV [Evidenca B, faqe 24], Planit strategjik të DITD-së [Evidenca I.3], ku UV synon të jetë një institucion aktiv në implementimin e dijes, gjenerimin e ideve krijuese dhe nxitjen e shkencës në territorin e Shqipërisë nëpërmjet një mësimdhënie bashkëkohore sipas të gjitha standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>DITD si pjesë e UV-së synon të jetë pjesë aktive e strategjise së UV në përmirësimin e metodave inovative të mësimdhënies duke mbështetur në mënyrë të vazhdueshme financiarisht dhe jo vetëm, personelin akademik në kualifikimin e tij profesional brenda dhe jashtë vendit [Evidenca IV.5 dhe Evidenca 5].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të</p>	<p>Me qëllim përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Mekanike, stafi akademik i DITD-së dhe jo</p>

<p>burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>vetëm, dëshmojnë për një angazhim optimal në arritjen e këtij qëllimi. Kjo tregohet përmes kohës vjetore të punës për secilin anëtar të stafit, që është e shpërndarë në të tre elementët përbërës së saj: realizim i procesit mësimor, kërkimit shkencor dhe transferimit të dijeve (sipas kuadrit ligjor në fuqi) [Evidenca II.6]. Ndarja e ngarkesës mësimore prej Drejtuesit të DITD-së, për secilin anëtar të stafit akademik bëhet në përputhje të plotë me kompetencat profesionale të secilit pedagog dhe prioritetet për punën kërkimore që secili parashikon individualisht dhe në nivel Grupi Mësimor / Departamenti / Fakulteti apo Universiteti, në fillim të çdo viti akademik [Evidenca II.2; Evidenca II.3 dhe Evidenca II.4]. Kjo çon në një shpërndarje optimale të ngarkesës së punës dhe specifikisht të ngarkesës mësimore ndërmjet stafit duke e orientuar në përmbushjen e objektivave të këtij program studimi.</p> <p>Rezultat konkret në këtë angazhim e tregon dhe marrja e çmimit “Ekselencë për Burimet Njerëzore në Kërkim” (në datë 4 dhjetor 2017, HR Excellence in Research) i dhënë nga Komisioni Evropian [Evidenca J, faqe 23].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Sik përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.3


Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>DITD dhe FSHT si njësi përgjegjëse për menaxhimin e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike disponojnë auditore mësimi, ambiente laboratorike, ambiente për personel akademik, ambiente për personel administrativ, ambiente për bibliotekën e fakultetit e cila shërben edhe si sallë kompjuterash dhe studimi për studentët, midis të cilëve edhe studentët e këtij program [shënime nga vizita monitoruese në UV]. Këto mjedise, duke përfshirë sallat e leksionit, seminarit dhe laboratorit, janë të mjaftueshme në raport me numrin e studentëve të cilët ndjekin këtë program studimi në të tre vitet dhe grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të këtij programi studimi dhe moduleve përkatëse të tij. Konkretisht sipërfaqja e ambienteve plotëson normën e sipërfaqes së shfrytëzueshme prej 3.8-4 m²/student dhe 7.5-8 m²/staf të përcaktuara nga standartet shtetërore të cilësisë [Evidenca IV.2].</p> <p>Megjithatë DITD ka vështirësi në vendosjen e paisjeve të reja laboratorike të blera, të cilat vazhdojnë të jenë gjendje (të pa vendosura në punë) pranë Qendrës së Kërkimit Shkencor të Fakultetit. Kjo ndodh për shkak të mungesës së mjediseve të cilat duhet të kthehen në laborator [shënime nga vizita monitoruese në UV].</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të</p>	<p>Përgjithësisht mjediset që shërbejnë për realizimin e mësimin janë të paisura me mjetet standarte për një klasë mësimi. Ambientet janë të rinovuara së fundmi dhe me dritë, por mungon ngrohja në dimër dhe ajri i freskët në verë. Kjo bën që të vështirësohen kushtet e mësimin në këto përudha si për studentet</p>

<p>teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>edhe për stafin akademik. Laboratorët dhe disa klasa janë të pajisura me pajisje multimediale dhe kompjutera ndërsa një pjesë tjetër jo [shënime nga vizita monitoruese në UV]. Pranë Fakultetit është edhe një bibliotekë shkencore e cila, përvec librave, është e pajisur me kompjutera e pajisje multimediale, e cila është në dispozicion të të gjithë studentëve dhe stafit akademik.</p>		
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>DITD ka një laborator të pajisur me kompjutera dhe pajisje multimediale. Kompjuterat janë të programuar me softuerë inxhinierike të tillë si CATIA, MaxSurf, SAP, Engine Room etj, që shërbejnë për laboratorë të ndryshëm apo praktika në programet e Inxhinierisë Mekanike dhe Navale [shënimë nga vizita monitoruese në UV]. Aktualisht ka mungesë me salla për ndërtimin e laboratorëve të tjerë, sic janë ato të materialeve, paisjet e të cilave kanë ardhur dhe janë të vendosura në QKSH të Fakultetit. Nevoja për laboratorë të ndryshëm mbetet një sfidë e vazhdueshme e UV dhe DITD. Kontribut në pasurimin e bazës laboratorike ka padyshim stafi i DITD-së, i cili është përfshirë në projekte dhe gjithmonë është përpjekur në sjelljen e paisjeve të ndryshme laboratorike, produkt i të cilit është laborator i vetëm i DITD-së.</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>FSHT disponon disa salla të teknologjisë së informacionit (të paisuara me kompjutera dhe softere përkatës), të cilat janë në dispozicion të studentëve, në të cilat ata marrin njohuritë sipas programit mësimor dhe syllabuseve të lëndëve mbi programe informatike specifike të fushave të ndryshme. Çdo sallë informatike ka të paktën 30 vënde. Këto ambiente ndodhen në godinën C, godinë që, gjithashtu, shfrytëzohet nga FSHT [shënimë nga vizita monitoruese në UV]. DITD ka një laborator të pajisur me kompjutera dhe pajisje multimediale. Kompjuterat janë të programuar me softuerë inxhinierike të tillë si CATIA, MaxSurf, SAP, Engine Room etj, që shërbejnë për laboratorë të ndryshëm apo praktika në programet e Inxhinierisë Mekanike dhe Navale [shënimë nga vizita monitoruese në UV].</p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>DITD nuk ka ambiente të mjaftueshme për realizimin e praktikave mësimore në të cilat duhet të përfshiheshin laboratorë apo ambiente të tjera të pajisura me paisjet e domosdoshme [shënimë nga vizita monitoruese në UV]. Për të kapërcyer këtë mangësi janë lidhur marrëveshje të ndryshme që Departamenti/ Fakulteti apo Universiteti ka me kompani shtetërore apo private të cilat zhvillojnë aktivitete në fushat që përputhen me programin mësimor [Evidenca I.17].</p> <p>Përgjithësisht ambientet e FSHT dhe UV, janë mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor për studentët e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Mekanike.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>DITD nuk disponon një bibliotekë të vetën, por studentët e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike shfrytëzojnë bibliotekën e FSHT që ndodhet në godinën C si dhe bibliotekën e UV që ndodhet në godinën A. Sallat janë të paisura me libra si dhe me mjediset e përshtashme për të lexuar apo për kërkim shkencor si karrige, tavolina, kompjutera, etj. Megjithatë ato nuk plotësojnë dot nevojat e studenteve duke qënë me një numër të kufizuar vendesh [shënimë nga vizita monitoruese në UV].</p> <p>UV ka në dispozicion të studentëve, stafit akademik dhe studiuesve të këtij Institucioni të arsimit të lartë 3 (tre) biblioteka me 3 (tre) salla leximi, me personel 4 (katër) vetë, me vendndodhje: Biblioteka qendrore, në Godinën A (Rektorati), që mbulon Fakultetin të Ekonomisë me personel 2 (dy) specialistë, Biblioteka B, në Fakultetin e Shkencave Humane me 1 (një) specialist (që mbulon edhe Fakultetin e Shëndetit Publik) dhe Biblioteka e re në godinën C, në Fakultetin e Shkencave Teknike me 1 (një) specialist/e [Evidenca IV.4].</p> <p>Studentët orientohen nga pedagogët për literaturën në syllabuset përkatëse të lëndëve, ku përvec teksteve në shqip, ju sugjerohen studentëve edhe tekste në gjuhë të tjera dhe kryesisht në anglisht.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Literatura [Evidenca B, pika 2.6, faqe 17] e ofruar nga institucioni përmes Bibliotekës së tij është multidisiplinare, kjo për vetë natyrën e UV. Në këtë Bibliotekë gjenden tituj nga 10 fusha të ndryshme studimi të cilat janë të klasifikuara sipas Klasifikimit Dhjetor Universal (KDHU) [Evidenca IV.3]. Biblioteka që ndodhet në ambientet e godinës A dhe C, godinë në të cilën zhvillojnë edhe procesin mësimor të gjithë studentët të cilët ndjekin programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Mekanike, është e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës dhe specifikës të këtij programi studimi [Evidenca III.15].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Ashtu si në gjithë universitetet shqiptare edhe në Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, mbështur prej MASR dhe Rrjetit Akademik Shqiptar, është bërë e mundur për stafin dhe studentet shërbimi pa pagesë i bibliotekës on-line (https://ulibrary.rash.al/) “ULIBRARY”. Në faqen web të universitetit, personeli akademik dhe studentët kanë mundësi të aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit duke ndjekur udhëzimet e manualit (https://ulibrary.rash.al/manual.pdf) përkatës i cili gjendet po në këtë faqe. Ky shërbim ofrohet pa pagesë për studentet dhe stafin akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Aktualisht biblioteka e FSHT që ndodhet në ambientet e godinës C, godinë në të cilën zhvillojnë edhe procesin mësimor të gjithë studentët të cilët ndjekin programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Mekanike, nuk është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike [shënime nga vizita monitoruese në UV]. Për të ofruar këtë mundësi për studentët dhe stafin akademik, Senati Akademik i unversitetit së fundmi ka marrë vendim për dixhitalizimin e bibliotekës [Evidenca III.14]. Ky vendim do t'i hap rrugën edhe investimeve në infrastrukturën e nevojshme teknologjike për krijimin e</p>

	mundësive të shfrytëzimit pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve dhe stafit akademik.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	UV çdo vit, përpara hartimit të buxhetit vjetor, kërkon prej Njësive Bazë të përcjellin nevojat për pasurimin e literaturës në fondin e bibliotekës, duke përditësuar fondin ekzistues me botime të kohës. Me përcjelljen e këtyre nevojave prej stafit akademik, në buxhet dedikohet një zë i vecantë për këtë investim [Evidenca IV.5].			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka që ndodhet në ambientet e godinës C, godinë në të cilën zhvillojnë edhe procesin mësimor të gjithë studentet të cilët ndjekin programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Mekanike, vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj [shënime nga vizita monitoruese në UV]. Këto orare dhe stafi (https://univlora.edu.al/biblioteka/) që shërben në bibliotekë, bëhen publike në vetë ambientet e bibliotekës dhe në faqen web të universitetit. Gjithashtu dhe amjentet e bibliotekës qendrore të UV vihen në dispozicion të studentëve sipas orareve të caktuara dhe të përshtatshme [Evidenca IV.3]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Në zbatim të kuarit ligjor për arsimin e lartë UV mban në formë të shkruar [Evidenca III.32 dhe shënime nga vizita monitoruese në UV]:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Regjistrin themeltar të studentëve, ✓ Regjistrin e arritjeve akademike ku hyn dhe procesverbali i çdo provimi apo detyrimi tjetër akademik, ✓ Regjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave. <p>Sekretaritë mësimore të departamenteve i plotësojnë këto tre regjistra edhe në formë elektronike.</p> <p>Prej sekretarisë mësimore administrohen edhe</p> <ol style="list-style-type: none"> a. dosjet e regjistrimit të studentëve me dokumentacionin sipas kërkesave të MASR, b. dosjet me procesverbalet e vlerësimeve të studentëve sipas viteve akademike c. dosjet e transferimeve të studimeve dhe ç' regjistrimeve. <p>Ndërkohë UV ka krijuar dhe një sistem kompjuterik për menaxhimin e proceseve të ndryshme të tij UVMS (https://uvms.univlora.edu.al/user/login) Ky sistem është krijuar me vendim të Senatit Akademik Nr. 101, datë</p>

	<p>06.12.2017 [Evidenca IV.4], dhe është një sistem modular i cili operon mbi bazën e moduleve të ndryshme, duke mundësuar shërbimet e nevojshme për çdo grup përdoruesish. Secili përdorues pajiset me një kod llogarie dhe një fjalëkalim fillestar, më pas secili përdorues e menaxhon në mënyrë të pavarur llogarinë e tij. Secili grup përdoruesish është i autorizuar ta përdor në mënyrë të përgjegjshme sistemin, çdo input dhe veprim i paligjshëm dhe në kundërshtim me rregulloren e UV-së është i dënueshëm me ligj. Çdo input informacioni në sistem shoqërohet me shkresa përkatëse sipas procedurave të UV të përcaktuara në rregulloren e UV-së [shënime nga vizita monitoruese në UV].</p> <p>UVMS mundëson shërbime për këta grupe përdoruesish: Zyra IT, Përgjegjës Departamenti, Sekretare, KryeSekretare, Studentë, Pedagog, Rektor.</p> <p>UVMS është një platformë digjitale moderne, e cila u ofron mundësi, së pari studentëve që të kenë në çdo kohë, një pasqyrë të qartë orientuese, ndihmuese dhe transparente për ofertën akademike, administrative, sociale, kulturore e sportive të UV, brenda dhe jashtë procesit mësimor [Evidenca IV.4].</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi UVMS administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit [Evidenca IV.4].</p> <p>Konkretisht DBNJ nëpërmjet specialistit të zyrës së burimeve njerëzore menaxhon dokumentacionin personal të punonjësve si dhe plotëson rregjistrin themeltar. Ndjek procedurat për kontratat e punës për të gjithë punonjësit e UV. Hedh të dhënat e çdo punonjësi në rregjistrin themeltar. Nxjerr të dhëna nga dosjet e personelit kur kërkohen, bazuar në ligjin e mbrojtjes së të dhënave personale [shënime nga vizita monitoruese në UV].</p> <p>Sekretaria e DITD-së, mban, ruan dhe administron, në përputhje me rregullat zyrtare, të gjithë dokumentacionin e departamentit si njësi administrative, ashtu edhe ato të stafit akademik që lidhen me procesin mësimor dhe administrative, sipas akteve ligjore dhe nënligjore. Drejtuesi i departamentit plotëson dhe nënshkruan realizimin e ngarkesës mësimore, semestrale dhe vjetore të anëtarëve të departamentit, miraton planet mësimore kalendarike dhe marrëveshjen e punës, miraton tezat e provimeve, organizon aktivitete të ndryshme shkencore ose veprimtari të tjera që lidhen me funksionimin administrativ të departamentit dhe të procesit mësimor si dhe angazhohet për të lidhur marrëveshje me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit [shënime nga vizita monitoruese në UV].</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Ndër të tjera sistemi menaxhimit UVMS siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Mekanike. Secili përdorues pajiset me një kod llogarie dhe një fjalëkalim fillestar, më pas secili përdorues e menaxhon në mënyrë të pavarur llogarinë e tij [Evidenca IV.4 dhe shënime nga vizita monitoruese në UV].</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe</p>	<p>Sistemi menaxhimit UVMS është një sistem modular i cili operon mbi bazën e moduleve të ndryshme, duke mundësuar shërbimet e nevojshme për çdo grup përdoruesish. Çdo input informacioni në sistem shoqërohet me shkresa përkatëse sipas procedurave të UV-së të përcaktuara në rregulloren e UV-së [Evidenca IV.4]. UVMS mundëson shërbime për këta grupe përdoruesish:</p>

shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Zyra IT, Përgjegjës Departamenti, Sekretare, KryeSekretare, Studentë, Pedagog, Rektor [shënime nga vizita monitoruese në UV].			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sistemi kompjuterik UVMS i UV, garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët [shënime nga vizita monitoruese në UV].			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	UV ka një faqe web (https://univlora.edu.al/) të dedikuar në të cilën publikohen informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	UV miraton çdo vit tarifat e shkollimit për çdo cikël studimi, por jo më shumë se VKM e miratuar nr. 638 dt 22.07.2015 i ndryshuar. Për tarifat e shkollimit mjafton të klikohet tek http://univlora.edu.al/bordi-i-administrimit/vendimet . Struktura përgjegjëse për raportimin financiar në UV, harton në mënyrë periodike raportin financiar të institucionit i cili paraqitet për miratim si pjesë e raportit vjetor pranë Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Në këtë analizë financiare pasqyrohen kostot financiare mesatare për student në nivel universiteti. Nëpërmjet planifikimit të buxhetit për çdo vit pasardhës, i cili realizohet në mënyrë periodike, si rregull në përfundim të vitit, kjo strukturë ndër të tjera harton edhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të vitin pasardhës si dhe harton buxhetin afat mesëm, i cili mbulon një periudhë tre vjecare, cka jep mundësinë për një plan mbështetjeje financiare për të paktën një cikël të plotë studimi [Evidenca IV.5; Evidenca IV.6].
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve	Nga ana e UV vihen në dispozicion për një program studimi të gjitha burimet njerëzore dhe asetet e nevojshme për realizimin e tij. UV mbështet stafin akademik në ngritjen e tyre profesionale duke i mbështetur në

<p>njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>pjesmarrjet e tyre në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare apo në lidhje të marrveshjeve bashkëpunimi me universitete të tjera ndërkombëtare.</p> <p>UV nuk ka të hartuar një plan financiar të dedikuar një programi studimi specifik, por ky plan vjen si pjesë integrale e planit financiar të vetë institucionit dhe si rregull përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij [shënime nga vizita monitoruese në UV].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>UV si një institucion publik i nënshtrohet auditit financiar të jashtëm dhe të brendshëm. Auditit i jashtëm kryet nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit. Raportet financiare përmbajnë tabelën për të ardhurat dhe ndarjen e burimeve financiare, të cilat janë të detajuara për çdo vit dhe të miratuara nga organet kolegjiale. Këto raporte mund t'i gjeni të certifikuar dhe nga Dega e Thesarit Vlorë në faqen zyrtare të www.univlora.edu.al; eëë.panel.u-trasparenca.al të detajuara në raporte mujore me përshkrimin: Akt rakordimi i të ardhurave; Situacionin e shpenzimeve. Referuar organigramës (https://univlora.edu.al/en-organigrama/) së UV ka në strukturën e tij edhe Sektorin e Auditit, i cili është nën varësinë e drejtpërdrejtë të Bordit të Administrimit [Evidenca III.12]. UV kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar i cili realizohet në mënyrë periodike, përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. Ky raport paraqitet prej Administratorit të universitetit pranë Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit [shënime nga vizita monitoruese në UV].</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>UV harton çdo vit projekt buxhetin afatmesëm (3 vjecare) [Evidenca IV.6]. Këto projekt buxhete janë të detajuara në bazë të kërkesave të Fakulteteve, Departamenteve [Evidenca IV.5] si dhe në përmbushjen e qëllimit, misionit dhe vizionit të UV-së. Institucioni ndjek ecurinë financiare me qëllim realizimin e objektivave të fakulteteve. Dokumenti i analizës financiare të bërë prej universitetit në fund të çdo vit, miratohet e më pas protokollohet e ruhet në arkivën e vetë universitetit, në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore për arkivë –protokollin. Vlen për t'u theksuar se kjo analizë nuk përshkruan vetëm periudhën korrente, por ka edhe një natyrë krahasuese për shumicën e zërave të buxhetit me periudhat ushtrimore të shkuara, cka do të thotë se të jep mundësinë për të gjykuar mbi raportet financiare të tre viteve të kaluara akademike dhe të planifikojë ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të secilit program studimi për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij [shënime nga vizita monitoruese në UV].</p>





<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>UV çdo vit harton buxhetin, mbështetur në kërkesat buxhetore të fakulteteve, të cilat përfaqësojnë nevojat e strukturave të Universitetit me qëllim arritjen e objektivave strategjike si dhe realizimin e misionit të tij [Evidenca IV.5 dhe Evidenca IV.6].</p> <p>Burimet e financimit të UV, si institucion publik janë dy: Grandi që akordohet prej MASR, Fondet e vetë universitetit të cilat sigurohen nëpërmjet studentëve si tarifat e regjistrimit, tarifat e shkollimit, si dhe të ardhurat nga shërbime të tjera që ofron institucioni [Evidenca I, Evidenca J]. Me qëllim mirëmenaxhimit të këtyre fondeve dhe sigurimit të një qëndrueshmërie financiare, gjatë analizës financiare vjetore shqyrtohet edhe realizimi i treguesve mbi zbatimin e politikës financiare të vetë institucionit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	
		<p>X</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	
		<p>X</p>		

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE



Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Procedurat dhe kriteret e pranimit në programin e studimit “Bachelor” në Inxhinieri Mekanike, janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me politikat e institucionit. Pranimi i studentëve në Programin e Ciklit të Parë të studimeve “Bachelor” në Inxhinieri Mekanike, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” (neni 74), në udhëzimet e përvitshme të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në kriteret e parashikuara të rregullores së UV, si dhe në kritere të propozuara nga Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare (DITD) dhe të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Vlorës.</p> <p>Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm, si dhe plotëson disa kritere të vendosura në DITD. Kohëzgjatja normale e studimeve në programin bachelor në Inxhinieri Mekanike është 3 vite akademike. Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe i vlerësuar me kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të</p>

	<p>Krediteve (ECTS). Studenti në përfundim të programit të studimit duhet të ketë grumbulluar 180 kredite.</p> <p>Nga takimi I GVJ me sekretarinë mësimore dhe materialet e vendosura në dispozicion rezulton për V.A 2019-2020 kuota të kërkuara për “Bachelor” në Inxhinieri Mekanike Shuma e kuotave 63, të regjistruar total 37 (28 student dege e parë + 2student me transferime + 7 veta degë e dytë).</p> <p>Në varësi të mesatarës së studentit përgjat tre viteve të studimit procesi i diplomimit të studentit përfundon me mbrojtjen e temës së diplomës përpara një komisioni ad-hoc pedagogësh të departamentit ose nëpërmjet provimit të diplomës Nota mesatare e tre viteve që studentit duhet të ketë për të realizuar punim diplome është 9. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës</p> <p><i>Rregullore e UV neni Neni 39 _Pranimi i studentëve</i></p> <p><i>EVIDENCA II-5 _Kuotat dhe kriteret e pranimit të studentëve.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA I-1 _Programi dhe rregullorja e programit në Bsc Inxhinieri Mekanike, Kurikula e programit mësimor shoqëruar me abstraket e lëndëve _compressed.pdf, neni 17 dhe 18.</i></p> <p><i>EVIDENCA V-1 _Vendim i Senatit Nr. 9-2017.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e UV neni Neni 66 _Pajisja me diplomë</i></p> <p><i>EVIDENCA III-31 _Diplomë e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike & Suplementi i diplomës për programin e studimit Bachelor në Mekanike..pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat për hyrjen dhe ndjekjen e programit i referohen dhe respektojnë barazinë dhe të drejtat për çdo student. Të gjitha procedurat e shoqërojnë studentin përgjatë programit.</p> <p>Të gjitha këto procedura janë të pasqyruara edhe në rregulloren e institucionit si edhe në rregulloren e programit të studimit dhe procesi ndiqet në të gjitha njësitë përkatëse për miratim (njësi bazë, njësi kryesore, rektorat, senat akademik, MASR) dhe janë në dispozicion të publikut në faqen elektronike zyrtare të UV (https://univlora.edu.al/2019/08/27/listat-e-fituseve-Për-raundin-e-pare/). Pranimi i kandidatëve të rinj konform udhëzimeve të MARS, pasi i janë nënshtruar konkursit përkatës në Maturën Shtetërore garanton në hyrje të drejta të barabarta për të gjithë kandidatët për studentë, ndërsa barazia dhe të drejtat e njëjta për studentët e programit të studimit garantojnë nga Rregullorja e UV-së. Regjistrimi i studentëve në programin e ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në Inxhinieri Mekanike kryhet pranë sekretarisë së Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare</p> <p>Rregullorja e DITD-së përmban në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikën e trajtimit të studentëve që nga regjistrimi e deri në përfundim të studimeve, apo transferimit të tyre, gjë që garanton qartësisht politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit bachelor në Inxhinieri Mekanike. Këto politika / procedura sigurojnë, informim për kriteret, procedurat dhe afatet e aplikimit, si edhe tarifën përkatëse të programit.</p>

<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p><i>Evidenca V-2_Proçedurë e regjistrimit të studentit.pdf</i></p> <p>Para fillimit të vitit akademik, institucioni i dërgon për miratim MASR-së kuotat si edhe kriteret për programin e studimit. Kriteret e pranimit miratohen me vendim të Senatit Akademik të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, bazuar në propozimet e departamentit përgjegjës të programit dhe Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore. Kriteret dhe kuotat, publikohen në faqen elektronike zyrtare të UV.</p> <p>Nga takimi i GVJ me studentët, ata u shprehën se referuar rregullores së programit të studimit “Bachelor” në Inxhinieri Mekanike, njohja e plotë dhe e pjeshme e krediteve të studentëve që vijnë me transferim nga programe të tjera studimi brenda ose dhe jashtë UV-së, është transparente dhe e kuptueshme për ta.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë harton dhe publikon përpara fillimit të çdo viti akademik (përpara periudhës së plotësimit të formularit prej maturantëve) kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve të ciklit të parë të studimeve, të propozuara nga njësitë bazë dhe të miratuara prej Senatit Akademik.</p> <p>Në takimin që GVJ pati me drejtuesin e departamentit, por edhe me studentët e këtij programi studimi, u konstatua se pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm, si dhe që plotëson:</p> <ol style="list-style-type: none"> Kriterin e meritës (mesatare e shkollës së mesme) e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Kriterin e rëndësisë (koeficienti i përcaktuar për shkollën nga vjen, sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në DITD). Notës mesatare të lëndës me zgjedhje në fushat përkatëse. Kuotave të paracaktuara. <p><i>EVIDENCA II-5_Kuotat dhe kriteret e pranimit të studentëve.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike të pranimit të studentëve në programin e ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në Inxhinieri Mekanike janë kriteret të përcaktuara në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, VKM nr. 295, datë 10.05.2019 mbi përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve, Udhëzimit të përvitshëm të MASR nr. 10, date 15.05.2019 si dhe Maturës shtetërore, Vendimit të përvitshëm të Senatit Akademik të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë me propozim të Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare.</p> <p>Nga takimi I GVJ me sekretarinë mësimore dhe materialet e vendosura në dispozicion rezultojnë se kuotat e pranimit të studentëve në këtë program studimi, të propozuara prej DITD-së dhe të miratuara prej Senatit Akademik, miratuar me VKM, parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve sipas kategorive në kuota për:</p> <ul style="list-style-type: none"> Kandidatë brenda vendit; Kandidatë nga trojet (Kosovë, Maqedoni e Veriut, Mal i Zi, Preshevë, Medvegja, Bujanovci);

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kandidatë shtetas të huaj; ▪ Kandidatë me statusin e personit me aftësi të kufizuar; ▪ Kandidatë me statusin e jetimit; ▪ Kandidatë romë dhe egjiptian; ▪ Kandidatë që aplikojnë për transferim studimesh; ▪ Kandidatë që aplikojnë për program të dytë studimi. <p><i>EVIDENCA V-3_Vendim Senati Nr.19-2018.pdf</i></p>								
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi I GVJ me sektorit të Këshillimit dhe Karrierës, Alumnit dhe grupeve të informimit të maturantëve në fakultete u evidentua se përpara plotësimit të formularëve të aplikimit prej maturantëve, UV organizon takime promovuese me kandidatët për studentë në ambientet e gjimnazeve të Qarkut Vlorë dhe më gjerë, në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore përkatëse, si dhe takime pranë Qëndrave Rinore për të informuar të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programeve të studimit, të cilat ofrohen në këtë universitet, duke shpërndarë njëkohësisht broshura e fletë-palosje informative dhe informacion të detajuar për çdo program studimi, ku dhe DITD ka pedagogët e vetë përfaqësues.</p> <p>UV organizon gjithashtu pranë ambienteve të tij aktivitetin “Open day” në të cilin njësitë bazë dhe ato kryesore, përfshirë këtu edhe DITD-në në FSHT, prezantojnë ofertën e tyre formuese didaktike.</p> <p><i>EVIDENCA V-4_Plani i aktivitetve për promovimin e UV-së. Informim i maturantëve.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA V-5_Fletë palosje DITD-FSHT.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA V-6_Fushata promovuese.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA V-7_Open day.pdf</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nëk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nëk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nëk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me drejtuesin e departamentit përgjegjës për këtë program studimi, u konstatua se studentët e këtij programi studimi, informoheshin në mënyrë të vazhdueshme për programin e studimit, objektivat e tij si dhe kompetencat e pëfituara në përfundim të tij.</p> <p>Kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin janë të përcaktuara në Rregulloren e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë. Sistemi informativ UVMS (https://uvms.univlora.edu.al/user/login) i përdorur prej studentëve, u ofron atyre akses të plotë mbi procedurat e përparimit akademik në çdo kohë, si</p>


	<p>dhe marrjen e shërbimeve të tjera, sic është prenotimi i një provimi. Listën e notave, vërtetimet studenti mund të aplikojë në sekretari.</p> <p>Në fillimin e vitit akademik, përpara fillimit të procesit mësimor, Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare shpall në ambiente publike orarin mësimor, në të cilin janë të përcaktuara qartë: kodi dhe emërtimi i lëndës, ngarkesa e lëndës, dita, ora, salla dhe pedagogu i lëndës për semestrin përkatës Për çdo kurs hartohet programi mësimor (syllabusi), i cili u prezantohet studentëve nga pedagogu i lëndës në fillim të kursit.</p> <p><i>Rregullore e UV neni Neni 75, 76 dhe 77</i></p> <p><i>EVIDENCA II-7_Orari mësimor- Orari i provimeve.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA I-10_Syllabuset e lëndëve.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Nga takimi I GVJ me studentet dhe më konkretisht me studentë të cilët kishin kryer transferimet në këtë program studimi u shprehën se procedura e ndjekur njoftimi dhe njohja e krediteve ishte bërë konform rregullores së programit të studimit “Bachelor” në Inxhinieri Mekanike. Transferimet lejohen brenda të njëjtut cikël studimi dhe në fusha studimi të njëjta ose të përafërta, vetëm në fillim të vitit akademik.</p> <p><i>EVIDENCA II-8_Procedura e transferimit të studentëve të ciklit të parë të studimit Bachelor në Ing. Mekanike.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Nga takimi I GVJ me studentet dhe pedagogët që mbulojnë lëndët e programit mësimor “Bachelor” u evidentua se informimi i studenteve në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit realizohej nëpërmjet prezantimit të syllabusit. Sikunder studentët mund t’i sigurojnë informacionet e mësipërme edhe nëpërmjet Sekretarisë mësimore të DITD-së, e cila vendos në dispozicion të tyre këtë informacion mbështetur në Rregulloren e programit të studimit dhe Rregulloren e UV të publikuara në faqen e internetit të universitetit, ku përcaktohen qartësisht procedurat dhe kriteret për vlerësimin e dijeve të studentëve në lëndë të ndryshme të programit të studimit, përsa i përket sistemit të vlerësimit, formës së vlerësimit, formës së kontrollit të dijeve, kushteve për hyrjen në provim, sezonet e provimeve, organizimin e tyre e deri tek ankimimet.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Nga takimi I GVJ me studentet, ata u shprehën se ishin në dijeni të kriterëve dhe procedurave për punimin e diplomës në programin e studimit “Bachelor” në Inxhinieri Mekanike.</p> <p>Departamenti informon studentët përmes stendave të tij, faqes së internetit, apo edhe takime me studentët, për kriteret që kërkohet të plotësohen për procedurat e punimit të diplomës. Kriteret janë publike në çdo kohë, por intensifikohet komunikimi në mes të semestrit të parë të vitit të tretë. Studenti plotëson një formular tip, ku specifikohet emri i studentit, fusha e studimit të kërkuar, propozimi për profesorin udhëheqës, pasi është marrë edhe aprovimi i tij. Ky dokument dorëzohet në departament i cili organizon një mbledhje për miratimin e temave dhe propozimeve të studentëve. Studenti diplomohet në 2 mënyra:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Me punimin e një teme diplome, nëse studentit ka mesatare më të madhe se 9. Nëse nuk ka studentë që plotësojnë këtë kusht, atëherë 3

	<p>studentët me mesatare më të lartë mund të marrin temë diplome prej DITD. Punimi i Diplomës duhet të plotësojë kushtet që specifikohen në rregulloren e diplomimit.</p> <p>2) Me provim formimi , nëse ka mesatare më të vogël se 9.</p> <p>Punimi i diplomës është një punim i pavarur shkencor i studentit. Nga ana tjetër departamenti publikon informacion në lidhje me mënyrën e përpunimit të tezës me të gjithë studentët e vitit të tretë bachelor.</p> <p><i>EVIDENCA III-30_Fletë detyre me vlerësimin e pedagogut udhëheqës.pdf</i></p>								
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë dhe konkretisht Drejtoria e Edukimit për Ciklin I dhe II, përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, koordinon aktivitetet ndërmjet njësive kryesore të UV-së dhe palëve të treta. Për informimin e kandidatëve për student dhe gjithë të interesuarve mbi programet e studimit që ofrohen nga UV, organizohen aktivitetet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Open day; <i>EVIDENCA V-7_Open day.pdf</i> ▪ Welcome day <i>EVIDENCA V-6_Fushata promovuese.pdf</i> ▪ Takime për këshillim karriere; <i>EVIDENCA V-8_Ëellcome day_faqja 8.pdf</i> ▪ Panairë pune; <i>EVIDENCA V-9_Panairi i punës.pdf</i> ▪ Njoftime punësimi intership; ▪ Vizita nga zyrat “peer to peer”; ▪ Udhëzues ose fletëpalosje me shërbimet e UV-së. <i>EVIDENCA V-5_Fletë palosje DITD-FSHT.pdf</i> 								
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="536 1176 751 1249">Përbushet</th> <th data-bbox="758 1176 970 1249">Përbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="976 1176 1189 1249">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1195 1176 1383 1249">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Nga takimi I GVJ me studentet ata u shprehën se informohen lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregulloren e programit të studimit • Sekretarisë mësimore të DITD-së, që prej momentit të regjistrimit dhe fitimit të statusit të studentit dhe në vazhdimësi përgjatë gjithë ciklit të studimit; • Takimit informues që organizohet me studentët ditën e parë të fillimit të çdo viti akademik;

	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtuesin e Departamentit, Përgjegjës të grupit mësimor dhe pedagogët e DITD-së; • Koordinatorit për marrëdhëniet me studentët ([Evidenca A], neni 77) për këtë program studimi; • Specialistit për shërbimin ndaj studentëve të Fakultetit të Shkencave Teknike (Sektori i Kurrikulave dhe shërbimit ndaj studentëve). <p><i>Statuti UV_Neni 77_Koordinatori për marrëdhëniet me studentët.</i></p> <p><i>EVIDENCA V-8_Welcome day_faqja 8.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konfirmon se institucioni jep informacion, lidhur me programet e studimit, lëndët dhe përmbajtjen e tyre në mënyrë të hollësishme në rregulloren e programit të studimit, syllabuset e lëndëve, nëpërmjet takimeve me stafin akademik dhe ndihmës. Ky informacion gjithashtu gjendet edhe në faqen eeb të institucionit (https://uvms.univlora.edu.al/).</p> <p>Ky informacion gjendet gjithashtu edhe në Suplementin e Diplomës “Bachelor” në Inxhinieri Mekanike [Evidenca III.31], me të cilën studenti pajiset në përfundim të studimeve.</p> <p><i>EVIDENCA V-5_Fletë palosje DITD-FSHT.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA I-7_Guida e Studentit.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA III-31_Diplomë e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike & Suplementi i diplomës për programin e studimit Bachelor në Mekanike.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Nga takimi I GVJ me studentet dhe pedagogët që mbulojnë grupin e lëndëve mekanike, doli në pah roli i madh informues i pedagogëve mbi mundësitë e punësimit të studentëve të këtij programi studimi në tregun rajonal. Kjo, si pasojë e bashkëpunimit të tyre të vazhdueshëm me organizatat publike dhe bizneset e sektorit përkatës (nëpërmjet pjesëmarrjes në seminare, ëorkshope, projekte dhe aktivitete të tjera të lidhura me industrinë/turizmin/transportin etj.). Ndërsa, në nivel institucional këtë funksion e përmbush Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, të cilët realizojnë aktivitete me qëllim prezantimin e mundësive të reja të punësimit.</p> <p><i>EVIDENCA V-9_Panairi i punës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në takimin që GVJ pati me drejtues të institucionit, përgjegjës të departamentit etj, konstatoi se studentët e këtij programi studimi, informohen në mënyra të ndryshme për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, nëpërmjet stafit akademik, sekretarisë, mediat sociale si edhe faqe eeb të UV. Informimi i studentëve në lidhje me sallat e mësimit, bibliotekën e gjithçka tjetër që lidhet me realizimin e programit të studimit bëhet në fillim të vitit akademik</p>
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë</p>	<p>Informacioni në lidhje me programin e studimit bëhet i aksesueshëm nga studentët nëpërmjet postës elektronike dhe nga publikimet në faqen elektronike zyrtare të UV.</p> <p>Sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit UVMS (https://uvms.univlora.edu.al/user/login) ka funksionuar shumë mirë dhe</p>

<p>lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>realizon bashkëpunim e komunikim interaktiv në distancë midis pedagogëve/studentëve dhe stafi ndihmësakademik (sekretaritë).</p> <p>Të gjithë studentët “Bachelor në Inxhinierinë Mekanike” mund të informohen lehtësisht në distancë atje dhe mund të marrin informacion të përditësuar edhe në lidhje me procesin mësimor: oraret me klasat ku zhvillohen leksionet, njoftimet për zëvendësimet e leksioneve, etj</p> <p>Në kuadër të situatës së pandemisë globale COVID-19 që preku edhe Shqipërinë, u aplikua mësimi online nëpërmjet platformës Google Classroom. Ky sistem menaxhohet nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të UV-së dhe është duke realizuar procesin mësimor në distancë. Sistemi është krijuar në mënyrë të tillë që të përshtatet dhe aksesohet nga të gjithë studentët në distanca të ndryshme.</p> <p><i>EVIDENCA V-10_Tutoriali i Google classroom për studentët etj..pdf</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Katë përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet si dhe diplomimet në strukturat përkatëse. Këto të dhëna disponohen nga Sekretaria mësimore e DITD-së, e cila i percjell ato te koordinatori i programit të studimit dhe në zyrën e ALUMNI.</p> <p>Statistikat vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për këtë program studimi pasqyrohen edhe në Raportin e përvitshëm të analizës vjetore të DITD-së dhe Raportin e analizës vjetore të UV-së.</p> <p><i>EVIDENCA I-8_Analizat Vjetore 2017, 2018, 2019.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Informacioni lidhur me statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve për ciklin e parë “Bachelor” në Inxhinieri Mekanike menaxhohet nga Sekretaria mësimore e DITD-së. Nga takimi I GVJ me sekretarinë mësimore këto të dhëna ruhen në formë të shkruar dhe në formë elektronike në regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave sipas mënyrës së përcaktuar në Statutin e universitetit. Statistikat vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për këtë program studimi pasqyrohen edhe në Raportin e përvitshëm të analizës vjetore të DITD-së dhe Raportin e analizës vjetore të UV-ës.</p> <p>Të dhënat për këtë program studimi janë:</p>

Numri i studentëve të regjistruar	Për herë të parë	Nota mesatare
2017-2018	46	6.81
2018 -2019	39	6.74
2019-2020	28	7.2
2020-2021	46	6.97

Statuti UV_Nenet 78 dhe 79

EVIDENCA I-8_Analizat Vjetore 2017, 2018, 2019.pdf

Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimitë deri në diplomimin e tyre.

Nga takimi I GVJ me sekretarinë mësimore të DITD-së u evidentua që ajo është përgjegjëse dhe mban gjithë informacionin lidhur me ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimitë deri në diplomimin e tyre për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në Inxhinieri Mekanike. Këto të dhëna ruhen në formë të shkruar dhe në formë elektronike dhe në regjistrin e arritjeve akademike sipas mënyrës së përcaktuar në Statutin e universitetit. Ruajtja dhe përpunimi i këtyre të dhënave personale të studentëve kryhet bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Këto të dhëna përftohen nga sekretaritë mësimore të DITD/FSHT-së, të cilat administrojnë dokumentacionin mësimor, si më poshtë:

- (i) regjistrin themeltar të studentëve, i cili është dokument që vërteton rregjistrimin e studentëve, ku secili prej tyre pajiset me një numër individual matrikullimi deri në përfundim të studimeve. Ky regjistër plotësohet manualisht dhe në rrugë elektronike.
- (ii) regjistrin e arritjeve akademike, si një dokument i cili vërteton rezultatet e arritura nga çdo student gjatë ciklit të studimit. Ky regjistër plotësohet manualisht dhe në rrugë elektronike.
- (iii) regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave, i cili është dokument që vërteton emërtimin e tyre prej UV-së, tërheqjen e diplomës dhe suplementin e diplomës.

Departamenti të gjitha këto statistika i bënë pjesë të Analizës vjetore të Departamentit.

EVIDENCA III-32_Regjistri themeltar i sekretarisë.pdf

EVIDENCA I-8_Analizat Vjetore 2017, 2018, 2019.pdf

Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Të dhënat statistikore të studentëve të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë menaxhohen në formë elektronike përmes sistemit të brendshëm të informacionit UVMS. Këto të dhëna janë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Ruajtja dhe përpunimi i këtyre të dhënave personale të studentëve kryhet bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të



Raporti vjetor me të gjithë elementet përbërës të tij, hartohet bazuar në evidencat dhe raportet e njëjësive kryesore/bazë dhe rektoratit përmban profilin dhe cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve si dhe shkallën e

studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.			
	Gjurmimi i punësimit të studentëve edhe pse është bërë, duhet të jetë më periodik dhe i vazhduar për të pasur një tablo më të plotë të cilësisë së punësimit të tyre. Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, Drejtorja e Edukimit për ciklin e I dhe të II-të, Sektori i kurrikulave dhe Shërbimit ndaj studentëve ka një personel të dedikuar në pozicionin e Specialistit të Rregjistrimit dhe Statistikave. Raporti vjetor shoqërohet me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të të gjithë treguesve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<p>Në zbatim të Ligjit Nr. 80, 2015, si dhe Statutit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë parashikohet përfshirja dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese të universitetit.</p> <p>Nga takimi I GVJ me studentet ata u shprehën se jan pjesë e:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senatit akademik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, i cili ka në përbërje të tij dy përfaqësues të studentëve (https://univlora.edu.al/komisionet/); • Bordit të Administrimit të Universitetit, i cili ka në përbërje të tij një përfaqësues të studentëve (https://univlora.edu.al/bordi-i-administrimit/); • Komisioneve të përhershme, të cilët kanë në përbërjen e tyre 1 student. <p><i>EVIDENCA V-11_Vendim Senati Nr. 54-2017.pdf</i> <i>Statuti UV_Nenet 74_Këshillat e studenteve</i></p>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<p>Përfaqësuesit e studentëve në senatin akademik përfshihen në mënyrë aktive në cdo vendimarrje në lidhje me procesin mësimor e më gjerë. FSHT dhe Departamenti DIDT-së i marrin gjithmonë në konsideratë dhe propozimet dhe ankesat e studentëve, si personale dhe kolektive. Disa nga mënyrat e përfshirjes së studentëve në FSHT në vendimarrje dhe adresim të vlerësimit të tyre mbi procesin akademik janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përfshirjen e kërkesave të studentëve në Buxhetin e UV. • Zbatimin e rekomandimeve të pyetësorit të studentëve. • Përzgjedhjen e studentëve në bazë të vendimmarrjes së tyre

	<ul style="list-style-type: none"> • Adresimi i kërkesave të studentëve <p>Angazhimi i tyre në proceset e vendimarrjes, këshillimit apo vlerësimit të institucionit, i garantuar nëpërmjet akteve rregullatore të UV-së, është real e i mbështetur në evidenca dhe rezultate të matshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> - UV i përfshin studentët në vlerësimin real dhe konkretë prej tyre të procesit akademik bazuar në rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme përmes marrjes së mendimit të studentëve të UV-së me pyetësorët që përgatit dhe organizon NJBSCVI për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. - Studentët përfshihen në grupin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit si dhe të vlerësimit institucional. - Studentët janë pjesë e pandarë e komisioneve të ndryshme ad-hoc, të ngritur me qëllim hartimin apo përmirësimin (Urdhër i Rektorit Nr. 123 datë 19.12.2019) e instrumenteve për sigurimin e cilësisë në UV, apo komisioneve. <p><i>EVIDENCA III-19_Analizë dhe rekomandime mbi raportin e pyetësorit të studentëve.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Ndryshimet, përmirësimet e programit “Bachelor” në Inxhinieri Mekanike në vite janë bërë në referencë të ndryshimeve të Bazës ligjore (VKM nr. 41, dt. 24.1.2018), si dhe të përshtatjes së programit të studimit me nevojat e tregut. Në të gjitha rastet, ndryshimet janë bërë duke patur parasysh mostejkalimin e 25 orëve javore si ngarkesë akademike të studentëve në këtë program studimi, të ndara në grupe leksioni, seminari e laboratore. Programi mësimor është i organizuar në module lëndore, të cilat janë të vlerësuara në kredite ECTS.</p> <p>Vetë përmbajtja e këtij plani mësimor (lëndët/ modulet dhe programi lëndor shoqëruar) e mundëson realizimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentit përgjatë programit, duke krijuar mundësi për njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme të studentëve. Kjo vërtetohet më së miri prej procedurave të ekuivalentimit dhe njohjes së lëndëve dhe krediteve për studentët që transferohen (vijjnë nga jashtë universitetit dhe lëvizin brenda FSHT duke ndryshuar degë), si edhe studentëve që marrin pjesë në projektet Erasmus +.</p> <p><i>EVIDENCA III-7_Procedurë riorganizimi të programit të studimit “Bachelor” në Inxhinieri Mekanike 2016-2019.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA II-8_Procedura e transferimit të studentëve të ciklit të parë të studimit Bachelor në Ing. Mekanike.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Nga takimi I GVJ me përfaqësues të Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit Institucional u evidentua se: Raporti i Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve të përgatitur nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional, për secilin prej programeve të studimit të ofruara në këtë universitet si dhe për secilën lëndë/modul të këtyre programeve, është objekt diskutimi dhe reflektimi mbi përfundimet e dala nga ky raport në njësinë bazë dhe që përfaqëson një feedback me</p>

	kontributin e studentëve gjatë procesit të rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit për të cilin është kryer pyetësori.			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Studentëve të këtij programi studimi gjat takimit me GVJ u shprehën se u mundësohet të japin mendim mbi ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve. Mundësia e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës u garantohet studentëve nga Rregullorja e Universitetit dhe Rregullorja e programit të studimit “Bachelor” në Inxhinieri Mekanike.			
Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	<p>Nga takimi i GVJ me përfaqësues të Drejtoria e Edukimit për Ciklin I & II u informua se kjo drejtori ka në përbërje dy sektorë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sektori i Kurrikulave dhe shërbimit ndaj studentëve (çdo fakultet ka një Specialist për shërbimin ndaj studentëve); ▪ Sektori i Këshillimit të Karrierës, ALUMNI dhe aktiviteteve kulturore-sportive. <p>Procedurat e ndjekura prej këtyre njësive në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve janë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të vetë universitetit.</p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, pjesë përbërëse e të cilit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sekretaria mësimore e Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare; ▪ Koordinatorin për marrëdhëniet me studentët për ciklin e parë të studimit në DITD; ▪ Sektorin e Kurrikulave dhe shërbimit ndaj studentëve (Specialisti për shërbimin ndaj studentëve në Fakultetin e Shkencave Teknike) ▪ Sektorin e Këshillimit të Karrierës, ALUMNI dhe aktiviteteve kulturore dhe sportive (Specialisti i Zyrës së Studentit) (https://univlora.edu.al/sektorit-i-keshillimit-te-studenteve-dhe-alumn-i/).

<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Sektori i Këshillimit të Studentëve dhe ALUMN-it shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, duke krijuar kontaktet e duhura me punëdhënësit potencial, me qëllim promovimin e studentëve dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit.</p> <p>Ky sektor i mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke u ofruar atyre informacionet dhe orientimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Specialistët këshillojnë studentët në procesin e regjistrimit dhe fillimit të shkollimit; ▪ Asistojnë studentët përmes njohjes së legjislacionit, për mundësinë e përzgjedhjes së programeve të studimit, pjesëmarrjen në organizime studentore, mundësinë e përfitimeve financiare, etj; ▪ I këshillojnë studentët në procesin e aplikimit, konkurrimit, regjistrimit dhe fillimit të shkollimit. Asistojnë tek ata gjatë gjithë periudhës së studimit për t'u njohur me legjislacionin universitar (Ligji, Statuti, Rregulloret e programeve të studimit, Udhëzimet e MASR, si dhe Urdhërat e Rektorit); ▪ Asistojnë dhe këshillojnë studentin për përfitimin e bursave dhe kredive studentore, organizimeve studentore etj; ▪ Janë ofruesit kryesor të shërbimeve për studentët lidhur me studimin dhe mësimin, aplikimin dhe pranimin në programe për të studiuar, kurse akademike, progresin akademik dhe përfundimin e studimeve; ▪ Zyra e Shërbimeve (specialistët) ndaj studentit përgjigjen për jetën studentore, për këshillimin e karrierës dhe veprimtarinë e klubeve, organizimeve e aktiviteteve studentore, ndjekin dhe organizojnë çështjet e karrierës të studentëve në UV; ▪ Zyra e Shërbimeve (specialistët) ndaj studentëve është përgjegjëse për lidhjen e universitetit me studentët potencial; ▪ Mbështet, inkurajon dhe asiston jetën kulturore, artistike, kulturore e sportive të studentëve dhe organizimet e tyre në këtë fushë. Në funksion të kësaj përgjegjësie hartojnë projekte të përbashkëta me studentët dhe realizojnë veprimtaritë e parashikuara; ▪ Janë mbështetësit në dispozicion të studentëve për çështjet sociale, kulturore, artistike.
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Sektori i Këshillimit të Studentëve dhe ALUMN-it (https://univlora.edu.al/alumni/) është struktura përgjegjëse që siguron të dhëna për studentët pas diplomimit, që përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. Database që ky sektor ka aktualisht (https://univlora.edu.al/alumni/) pasurohet vazhdimisht me të dhëna që sigurohen edhe nga ofrimi i mundësisë për plotësimin online të Formularit të Regjistrimit UV Alumni për çdo student të diplomuar në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.</p>


Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Niveli i përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion të GVJ evidentohen sa më posht vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> Në Statutin e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, sanksionohet garantimi i të drejtës së studentëve dhe stafit akademik për të zhvilluar lirisht dhe në mënyrë cilësore procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke vënë në dispozicion infrastrukturën adekuate për këtë qëllim. Në Statutin e Institucionit janë parashikuar strukturat dhe parimet e funksionimit të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Po ashtu në Statut përshkruhen kompetencat e Komisioneve të Përherëshme të Sigurimit të Cilësisë së Brendëshme për cdo Njësi Kryesore/ Departament (KSCBF), Komisionet e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Institucional (KSBCI) Komisioni i Marrëdhënies me Studentët në Fakultet (KMSF) dhe Komisioni i Marrëdhënies me Studentët në Institucion (KMSI), ku pasqyrohen në mënyrë të hollësishme mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve detyrat dhe përgjegjësitë. <p>Vlen të evidentohet nga GVJ së paralel janë hartuar dhe përpiluar planet strategjike në nivel institucional (Planin Strategjik 2018-2024 të UV-së miratuar me vendim Bordi Administrimi nr. 26, datë 08.11.2018) dhe Planin Strategjik të Departamentit 2018-2022, 2018-2024.</p> <p><i>Statuti UV_Neni 5_Parimet e Funksionimit</i></p> <p><i>Statuti UV_Kreu 8_Sigurimi I cilësisë</i></p> <p><i>Statuti UV_Neni 22_Komisionet e përherëshme</i></p> <p><i>EVIDENCA I-3-1_Plani Strategjia e Zhvillimit të DITD-së_2018-2020_compressed.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA I-3-2_Plani Strategjik i Zhvillimit të DITD-së_2018-2024.pdf</i></p>


	<p>Në këto plane theksohet rëndësia e respektimit të standarteve europiane të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Standardet Europiane të Edukimit ESCO Standards dhe indikatorët për matjen e tyre janë instrumenti bazë për sigurimin dhe garantimin e cilësisë në programet mësimore, të cilat shkojnë paralelisht me zhvillimin e Setit të Kompetencave Profesionale dhe Interpersonale (SPC – Set of Profesional Competences) and (SIC – Set of Interpersonal Competences).</p> <p>Krahas dokumentave të mësipërme, në mënyrë të vazhdueshme organet kolegjinale të institucionit kanë miratuar procedura të posatshme për sigurimin e brendshëm të cilësisë si:</p> <p>Vendim Senati nr.21, datë 08.05.2018 “Për procedurën e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e cdo programi studimi në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë [Evidenca VI.1] në të cilën përshkruhet në mënyrë të hollësishme procedura e përmirësimit të programeve të studimit, duke filluar që prej analizimit të rezultateve të pyetësoreve deri në planin e masave që propozohet për përmirësim.</p> <p>Vendim Senati nr 51, datë 20.09.2019 “ Për miratimin e Pyetësorit për Studentët për Vlerësimin dhe Përmirësimin e Cilësisë së Shërbimeve të ofruara prej Stafit Administrativ dhe Ndhimës/akademik në UV” Qëllimi i përdorimit të këtij instrumenti është vlerësimi dhe monitorimi i cilësisë së shërbimeve që studentët marrin gjatë jetës studentore në UV prej strukturave mbështetëse për programet e studimit.</p> <p>Vendim Senati nr.52, datë 20.04.2017 “Për miratimin e formularit për vlerësimin e performancës së personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme” dhe Vendim nr.53, datë 20.04.2017 “Për miratimin e formularit për vlerësimin e performancës së personelit ndihmës/akademik me karakter akademik dhe administrativ me kohë të plotë dhe të pjesshme”</p> <p>Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare (DITD) në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë, mbështetet në politikat, procedurat dhe strukturat e sipërpërmendura, në vendimet e mësipërme të senatit, si dhe në dokumentat ligjore dhe strategjike të sipërpërmendur.</p> <p><i>EVIDENCA VI-1_Vendim Senati 21-2018.pdf</i> <i>EVIDENCA VI-2_Vendim Senati 51-2019.pdf</i> <i>EVIDENCA VI-3_Vendim Senati 52-2017.pdf</i> <i>EVIDENCA III-3_Vendim Senati Nr.53, datë 20.04.2017.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorët e ekspertët të jashtëm.</p>	<p>Në funksion të Sigurimit të brendshëm të cilësisë DITD operon në koherencë të plotë me procedurat e Fakultetit të Shkencave Teknike FSHT, i cili nga ana e tij respekton procedurat që janë përcaktuar nga strukturat e nevojshme në nivel institucioni, në të cilat garantohet dhe përfshirja e stafit dhe studentëve.</p> <p>Nga takimi i GVJ me drejtuesin e departamentit, pedagogët dhe studentët, u evidentua se strukturat e sipërpërmendura janë struktura relativisht të reja, jo plotësisht të konsoliduara në praktikën e punës, por me përpjekje serioze në drejtim të vlerësimit të cilësisë në nivel të njësisë bazë, e më tej fakultetit. Si struktura të reja ato janë në proces përmirësimi, plotësimi me anëtare, përpilimi të rregulloreve dhe strategjive përkatëse. Krijimi dhe implementimi i këtyre</p>

dokumenteve përbëjnë njëkohësisht edhe një prej objektivave strategjik të institucionit.

- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJSBCVI) së fundmi është riorganizuar si një sektor pjesë e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve (DSBCP) me Vendim Senati nr.8 datë 14.02.2018. NJSBCVI e ushtron aktivitetin e saj duke u mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 531. Datë 11.09.2018, Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, Statutin e Institucionit- Neni 82; në vendime të Senatit, urdhëra të Brendshëm, planin e punës të vitit akademik respektiv miratuar prej titullarit të institucionit.
- NJSBCVI në procesin e konsolidimit të aktivitetit të saj është duke punuar për hartimin e një draft rregulloreje për sigurimin e cilësisë, përcaktimin e indikatorëve për vlerësimin cilësor, planin e monitorimit të këtyre indikatorëve dhe instrumentat për kryerjen e këtij monitorimi. Në Universitetin e Vlorës, për herë të parë Njësia e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë së institucionit ka startuar aktivitetin e vet me Vendimin Senati Nr.84, datë 12.12.2016
- Komisionet e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë për çdo njësi Kryesore dhe në nivel Institucioni respektivisht (KSCBF), (KSBCI), (KMSF) operojnë në një sistem jo të konsoliduar dhe me staf jo të kompletuar. Plotësimi me anëtarë dhe funksionimi aktiv i tyre është një nevojë imediate për të zbatuar politikat e UV-së, për garantimin e përfshirjes së aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë si dhe ngritjen e kulturës së cilësisë në UV.
- Ndryshimi i strategjisë së zhvillimit të universitetit nga ai me zhvillim vertikal në zhvillim me qendër studentin i ka vendosur këta të fundit në fokusin kryesor të strategjisë së zhvillimit të institucionit. Parë në këtë këndvështrim opinioni i tyre mbi programet e studimit dhe lëndët që ata ndjekin, cilësinë e mësimdhënies, cilësinë e zhvillimit të praktikave profesionale, cilësinë e shërbimeve mbështetëse etj, janë një burim shumë i rëndësishëm infomacioni për rritjen e cilësisë së shërbimeve akademike/ ndihmës akademike dhe të programeve mësimore që ofron universiteti.
- Në komisionet e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë (KSCBF) për çdo Njësi Kryesore dhe në nivel institucioni, studentët përfaqësohen me një anëtar në çdo komision. Ata gjithashtu janë anëtarë në komisione të ndryshme ad-hoc, të ngritura me qëllim hartimin apo përmirësimin e instrumentave për sigurimin e cilësisë në UV.
- Si pjesë e strategjisë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, është edhe përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm, nëpërmjet organizimit të tryezave të rumbullakta me pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm publikë, privatë, përfaqësues të biznesit etj. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është përmirësimi i

	<p>kurrikulave dhe përshtatja e vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës nëpërmjet ndarjes së eksperiencave me ta</p> <p><i>EVIDENCA III-12_Struktura e universitetit.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA III-2_Vendim Senati Nr.8 datë 14.02.2018.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA III-1_Vendimin Senati Nr.84, datë 12.12.2016.pdf</i></p> <p><i>Statuti UV_Neni 21_Asambleja e personelit akademik</i></p> <p><i>Statuti UV_Neni 22_Komisionet e përherëshme</i></p> <p><i>EVIDENCA III-23_workshop, datë 18-12-2019, tema "Studentët dhe tregu i punës".pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Dy prej instrumentave kryesore të jashtëm për sigurimin e cilësisë në UV janë Akreditimi Institucional si dhe Akreditimi i programeve të studimit, të cilat janë dhe detyrim ligjor për cdo IAL (neni 104 Ligji i Arsimit të Lartë nr.80/2015).</p> <p>Në Maj 2017, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë ishte objekt i vlerësimit të jashtëm institucional me qëllim vlerësimin e shkallës së përbushjes së Standarteve Shqiptare Shtetërore të Cilësisë, që kanë hyrë në fuqi në vitin 2011. Procesi i akreditimit të parë institucional të UV-së përfundoi me vlerësimin përfudimtar pozitiv dhe akreditimin institucional me kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh akademike.</p> <p>Në konsolidim të cilësisë dhe në përbushje të rekomandimeve të dhëna nga GVJ, institucioni përpiloi Plan Veprimin 2018 - 2024 me synim jo vetëm përbushjen e rekomandimeve të lëna prej Bordit të Akreditimit, por edhe për implementimin e 9 linjave strategjike të Planit Strategjik Institucional. Plani i Veprimit është miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 29 datë 22.05.2018, dhe përcjellë më datë 27.06.2018, nr. 857 Prot, pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë dhe Arsimit të Lartë.</p> <p>Plani i Veprimit 2018-2024 është kontribut i drejtëpërdrejtë në rritjen e standardeve të cilësisë, pasi përcakton qartësisht jo vetëm veprimet që do të ndërmeren, por edhe instrumentat që do të përdoren, indikatorët sasiorë dhe cilësorë për monitorimin e tyre, përgjegjësitë dhe kompetencat, afatet kohore, kostot financiare për përbushjen e sejcilit prej tyre.</p> <p>Gjithashtu, UV përveç akreditimit institucional iu nënshtroi në muajt Prill-Maj 2019 dhe vlerësimit nëpërmjet sondazhit kombëtar të studentëve, rezultatet e të cilit priten të dalin së shpejti dhe të bëhen publike prej ASCAL</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjsteve</p>	<p>Në Kreun VIII të Statutit të UV-së përshkruhen qartë procedurat e posacme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen.</p> <p>Po ashtu dhe në rregulloren e UV-së, në nenin 86 të saj parashikohen instrumentat e kërkimit dhe procedurat që duhet të ndjehen institucioni me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet një sërë instrumentash.</p> <p>Në mënyrë periodike nëpërmjet NJSBCVI në fund të çdo semestri përpara sezonit të provimeve, organizohet pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. Për këtë qëllim me Vendim të Senatit Akademik është miratuar procedura e përmirësimit të programeve të</p>


përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	studimit, duke filluar që prej analizmit të rezultateve të pyetësoreve deri në planin e masave që propozohet për pëmirësim. Këto politika dhe procedura synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit duke garantuar përfshirjen e gjithë aktorëve të brendshëm të UV-ës. <i>EVIDENCA VI-1_Vendim Senati 21-2018.pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	<p>UV ka ngritur një sërë strukturash/sectorësh me qëllim monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit. Si strukturë e posaçme për monitorimin dhe mbështetjen e programe mësimore në nivel institucioni si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë, me një sektor të dedikuar: Sektori i Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentit, • Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJSBCVI). • Komisioneve të Sigurimit të Cilësisë së Brendshme (KSBCI) dhe (KSCBF) • <i>Statuti UV_Neni 22_Komisionet e përherëshme</i> <p>Në nivel fakulteti ekzistojnë gjithashtu Zv. Dekanët për anën akademikë, të cilët në mungesë të funksionimit të komisioneve të përherëshëm në nivel fakulteti në bashkëpunim me dekanatin e tij mbështesin dhe orientojnë politikën për zhvillimin e monitorimin e programeve të studimit që ofrohen prej fakultetit respektiv.</p>
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	<p>Nga takimi i GVJ me drejtuesin e departamentit, pedagogët dhe studentët, u evidentua se disa nga mekanizmat apo proceset që përdoren në UV për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Raportet vjetore të veprimtarisë institucionale të cilat përmbledhin analizën e procesit mësimor me të gjithë komponentët e tij si dhe raportin e analizës së kërkimit me të gjithë komponentët e vlerësimit të tij • Në Departamentin e DITD, procedura për ndryshime, miratime në programet e studimit bëhet referuar ndryshimeve në bazën ligjore (ndryshime në ligj, VKM, Urdhëra, Udhëzime prej MASR) apo ndryshime të diktura nga koha dhe kërkesat e tregut të punës. Në të gjitha rastet, si

	<p>praktikë këto ndryshime kanë ndjekur procedura standarte dhe të dokumentuara.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Edukimit për ciklin e parë dhe të dytë është drejtoria e cila vlerëson në nivel institucional propozimet mbi ndryshimet e mundshme të programit mësimor dhe i përcjell më tej në Senatin Akademik për miratim dhe sipas rastit (nëse janë ndryshime më pak se 20% apo më shumë se 20%) është njoftuar ministria ose është përcjellë kërkesa për marrjen e miratimit prej saj. • Pyetësi studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi, në fund të cdo semestri, para sezonit të provimeve, në përfundim të të cilit hartohet dhe zbatohet një plan masash për përmirësimin e mëtejshëm të programeve mësimore. <p><i>EVIDENCA I-8_Analizat Vjetore 2017, 2018, 2019.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA I-1_Programi dhe rregullorja e programit në Bsc Inxhinieri Mekanike, Kurikula e programit mësimor shoqëruar me abstraket e lëndëve_compressed.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Praktika e ndjekur tashmë prej dy vitesh konsiston në zhvillimin e anketimit të studentëve nga ana e NJSBCVI, me qëllim vlerësimin e cilësisë së programeve mësimore, si dhe matjen dhe vlerësimin e mësimdhënies duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikat më të mira.</p> <p>GVJ thekson se, institucioni për rrjedhojë edhe njësitë bazë të tij departamentet nuk kanë një metodologji të strukturuar të vlerësimit të cilësisë të bazuar në indikatorë sasiorë dhe cilësorë, instrumenta matëse dhe vlerësuese, plane monitorimi dhe vlerësimi periodike.</p> <p>Metodologjia e studimit ka qenë e strukturuar dhe instrumenti i përdorur është pyetësi i miratuar me Vendim të Senatit Akademik.</p> <p>Pyetësi është i përbërë prej 14 pyetje të mbyllura dhe 2 pyetje të hapura. Opinionet e studentëve mbi pyetjet e hapura janë dhënë për çdo pedagog që ka dhënë mësim në programin e studimit të ciklit të parë dhe të dytë. Pjesëmarrës në studim kanë qenë të gjithë studentët të cilët ndjekin këto programe studimi, të cilët kanë një llogari personale në sistemin elektronik të Universitetit dhe që kanë frekuentuar qoftë dhe një lëndë të vetme përgjatë vitit akademik. Një student vlerëson të gjitha lëndët ku ai ka marrë pjesë gjatë semestrit të parë dhe të dytë të vitit.</p> <p>Duke qenë se Raporti i Analizës së Pyetësorit është përpiluar për dy vite rresht, në vitin akademik 2018-2019, krahas përpunimit statistikor të pyetjeve të mbyllura të pyetësorit, realizohet gjithashtu një analizë krahasuese si midis përgjigjeve të studentëve në lëndë të ndryshme brenda të njëjtës pyetje edhe midis rezultateve të vitit akademik 2017-2018, duke evidentuar ato pyetje ku ka ndryshime të dukshme.</p> <p>Rezultatet e këtij pyetësi shërbejnë si një instrument i rëndësishëm për Njësitë Kryesore për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore aty ku shihet e nevojshme.</p> <p>Një tjetër instrument i miratuar rishtazi është Pyetësi i Studentëve për vlerësimin e cilësisë së Shërbimeve të ofruara prej stafit ndihmës akademik</p>

	dhe administrativ, i cili do të implementohet për herë të parë në përfundim të vitit akademik 2019-2020. <i>EVIDENCA VI-3_Vendim Senati 52-2017.pdf</i>			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Duke marrë në konsideratë Procedurën e Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për Lëndët e çdo Programi Studimi në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, miratuar me Vendim Senati Nr. 21, datë 08.05.2018, NJSBCVI përpos Raportit të Analizës përpilon dhe projekt propozimet dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë, duke e përcjellë me tej pranë strukturave përkatëse të parashikuara në procedurën e analizës së pyetësorëve. <i>EVIDENCA VI-1_Vendim Senati 21-2018.pdf</i>			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Referuar procedurës së sipërcituar raporti i rezultateve të pyetësorëve si dhe rekomandimet e përpiluara prej NJSBCVI-së ju përcillen Njësitë Kryesore të cilat realizojnë më tej një diskutim të gjerë në cdo departament me stafin akademik. Ky raport nuk diskutohet me studentët dhe rezultatet e anketimit nuk iu bëhen të ditura atyre. Pra, edhe pse ka perpjekje pozitive transparenca dhe gjithëpërfshirja kërkojnë një angazhim të drejtëpërdrejtë në informimin e studenteve dhe pedagogëve, debat të hapur dhe diskutim me ata. Pavarësisht kësaj Njësitë Kryesore diskutojnë rezultatet respektive duke dhënë propozime përkatëse, të cilat më pas diskutohen në Mbledhjen e Rektoratit. Në këtë të fundit përpilohet Plani i Masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në Programet e Studimit dhe Mësimdhënien i cili përcillet për miratim pranë Senatit Akademik të institucionit. <i>EVIDENCA VI-4_Vendim Senati 17-2019_Plani i masave nga rektorati për përmirësimin e cilësisë të programeve të studimit.pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Jo e përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Nga takimi i GVJ me drejtuesin e departamentit dhe pedagogët u evidentua që Komisionet e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë në Njësitë Bazë/ Departamentet (KSCBF) janë ende struktura jo të plota dhe të konsoliduara në praktika. Në nivelin e Njësitë Bazë/Departamenti i Mekanikës dhe Teknologjisë Detare DITD ka materializuar vlerësimin e brendshëm të programeve të saj në Raportin e Vetvlerësimit të përpiluar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm 2017, në kuadër të procesit të akreditimit.

<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Në kuadër të politikave të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë për sigurimin e brendshëm të cilësisë, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standarteve të cilësisë, NJSBCVI përpilon raportin e analizës së pyetësorëve i cili ka për qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikat më të mira. Të dhënat e pasqyruara në këtë raport shërbejnë si një instrument i rëndësishëm për Njësitë Kryesore/Bazë për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore aty ku shihet e nevojshme.</p> <p>Referuar natyrës dhe specifikës së kërkimit (vlerësimi i cilësisë së programeve akademike), për kryerjen e vlerësimit, Universiteti ‘Ismail Qemali’ Vlorë, ka përdorur metodën sasiore dhe cilësore si një metodë e përshtatshme dhe instrumenti i përdorur është pyetësori (sqaruar më hollësisht në Standardin VI.2 Kriteri 3).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në fillim të vitit akademik Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me stafin akademik të departamentit kontrollon dhe vlerëson përmbajtjen e syllabuseve. Syllabuset diskutohen në department, por aprovohen nga titullari i njësisë bazë.</p> <p>Përgjegjësi i Departamentit realizon vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së leksioneve/seminareve etj, praktikë që verifikon kryerjen e procesit të mësimdhënies nga pikpamja sasijore (Orët leksion, seminare, laboratore). Përgjegjësi i Departamentit nuk disponon asnjë praktikë ligjore të miratuar nga Senati për grumbullim të dhënash cilësore.</p> <p>Një praktikë e konsoliduar që sjell në përfundim të dhëna cilësore që mund të merren në konsideratë, është praktika e mbrojtjes së diplomave nëpërmjet zhvillimit të punës kërkimore-shkencore të studenteve përpara një komisioni të përbërë nga 5 anëtarë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë përdor edhe metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, të tipit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informacioni i përpunuar prej Sektori i Këshillimit të Studentëve dhe Alumn-it (https://univloro.edu.al/alumni/) Statistikat mbi punësimin e studentëve dhe lloji i punës (pozicionit drejtues) dhe karriera e tyre, janë një tregues mbi cilësinë e programeve të Studimit të ofruar prej këtij universiteti. Vjelja e informacionit prej ALUMNI nuk realizohet plotësisht. Mungon një sistem gjurmimi për të diplomuarit, që do të krijonte mundësinë e vlerësimit të diplomave të dhëna në tregun e punës, peshës specifike që kanë ato në këtë proces. Në Planin Strategjik të Universitetit, në skenarin Universitet SMART parashikohet ngritja e një sistemi gjurmimi të të diplomuarve, bazuar në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (aplikacion ICT) • Organizimi i takimeve me bashkëpunëtorë, ekspertë të jashtëm dhe Alumni. Shembull i këtyre takimeve është takimi i organizuar më datë 18.12.2019 prej NJSBCVI në bashkëpunim me Drejtorinë e Edukimit, Drejtorinë e Komunikimit dhe Burimeve Njërezore dhe




	<p>Fakultetet respektive, të cilët organizuan ëorkshop-in me temë “Studentët dhe tregu i punës”. Qëllimi i këtij workshop-i ishte përmirësimi i kurrikulave dhe përshtatja e vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës nëpërmjet ndarjes së eksperiencave midis bashkëpunëtorëve, ekspertëve të jashtëm dhe Alumni. Si bashkëpunëtor dhe ekspertë të jashtëm të ftuar në këtë tryezë ishin kryesisht biznese, institucione publike e private si punëmarrësit kryesorë të studentëve të Universitetit të Vlorës.</p> <p><i>EVIDENCA III-17_Manuali i përdorimit të UVMS si pedagogë.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA III-23_Ëorkshop, datë 18-12-2019, tema “Studentët dhe tregu i punës”.pdf</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Pa përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Nga materialet e vendosura në dispozicion të GVJ rezulton se parashikohet përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit, bazuar në Statutin e UV-ës, Rregulloren e UV-s dhe në Planin Strategjik 2018-2024 të UV-ës.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Njëkohësisht në këto dokumente përcaktohen qartë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Komisioni i fakultetit është angazhuar të funksionojë më aktivisht për të zbatuar politikat universitare, për garantimin e përfshirjes së të gjithë aktorëve për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Nga takimi i GVJ me drejtuesin e departamentit dhe pedagogët evidentohet fakti që këto komisione për sigurimin e cilësisë në nivel fakulteti ende nuk janë ngritur, por rolin e tyre e ka luajtur Dekanati i cili mbështet dhe orienton politikat për zhvillimin e monitorimin e ofertës akademike të fakultetit dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Njëkohësisht një tjetër tregues që dëshmon përfshirjen e studentëve është pyetëtori i organizuar prej NJSBCVI-së në fund të cdo semestri për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për cdo lëndë. Në këtë proces studentët përfshihen jo vetëm në plotësimin e pyetësorit por edhe si aktorë aktiv në procesin e ngritjes së kulturës së cilësisë duke i angazhuar në fushatat informuese dhe promovuese mbi rëndësinë e përfshirjes së studentëve në politikat e vlerësimit të UV-së, duke marrë pjesë aktivisht në

	<p>plotësimin e Pyetësorëve të Studentëve për Vlerësimin e Cilësisë së Mësimdhënies, Sondazhin Kombëtar të studentëve si dhe në grupe të ndryshme të ngritura me qëllim përpilimin ose rishikimin e instrumentave të vlerësimit të Brendshëm.</p> <p>https://www.ascal.al/sq/informacione/aktivitete/sondazhi-kombetar-i-studenteve-takimet-informuese-dhe-udhezuese-me-date-27-mars-2019</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni përfshin aktorë të brendshëm në vlerësimin e programit, stafin që lidhet me direkt me programin e studimit në fjalë, sikurse edhe student në strukturën e NJBSC, duke shmangur gjithashtu diskriminimin apo pabarazinë ndërmjet tyre.</p> <p>Kontrolli i procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies ka garantuar bazarinë e plotë midis anëtareve të stafit akademik si dhe midis studentëve.</p> <p>Në DITD nuk ka asnjë praktikë ankimimi nga ana e studentëve apo stafit akademik dhe administrativ në shërbim të tyre për diskriminim dhe pabarazi.</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion, pjesë aktive e procesit të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm janë stafi akademik dhe studentët. Për këtë proces nuk ka bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm. Në RVB, sikurse edhe në takimin që GVJ pati me përgjegjësin e departamentit përgjegjës për këtë program studimi, nuk u evidentua ndonjë një praktikë periodike vjetore e marrjes së feedback-ut nga ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit, duke përfshirë biznesmenë, institucione publike dhe private ku të diplomuarit e një program studimi janë punësuar.</p> <p>DITD po punon për hartimin e një Marraveshjeje Bashkëpunimi me biznesin, institucionet publike, NGO-të pjesë e secilës do të jetë edhe konsolidimi i praktikave të vlerësimit të programeve mësimore prej tyre</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, i bën transparente dhe publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit, politikën, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit, nëpërmjet postimit në faqen zyrtare elektronike https://univlora.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-raportit-te-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve/ të Universitetit (Statuti, Vendime të Senatit Akademik, Vendime të Bordit të Administrimit, Raportet e analizës së rezultateve të pyetësorëve të anketimit të studentëve, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë etj) si dhe nëpërmjet shkresave zyrtare tek</p>

	të gjitha Njësitë Kryesore, Njësite Bazë duke krijuar kështu një universitet të hapur e transparent me të gjithë aktorët e brendshëm e të jashtëm të tij.			
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.531, datë 11.09.2018 “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Standarti VI.5, Kriteri.2 është përpiluar Raporti i Analizës së Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për çdo Lëndë të çdo Programi Studimi.</p> <p>Informacioni i publikuar në raport respekton lirinë dhe etikën akademike si dhe Ligjin Nr.9887 datë 10.03.20008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Raporti publikohet në nivel Njësie Kryesore, të cilët përmbajnë raportet përkatëse të cdo departamenti.</p>			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<p>Referuar Procedurës së Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për Lëndët e çdo Programi Studimi në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, miratuar me Vendim Senati Nr. 21, datë 08.05.2018, NJSBCVI përpos Raportit të Analizës përpilon dhe projekt propozimet dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë duke e përcjellë me tej pranë strukturave përkatëse të parashikuara në procedurën e analizës së pyetësorëve.</p> <p><i>EVIDENCA VI-1_Vendim Senati 21-2018.pdf</i></p> <p>Në përfundim të zbatimit të gjithë fazave të parashikuar në procedurën e më sipër përmendur përpilohet Plani i Masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në Programet e Studimit dhe Mësimdhënien i cili përcillet për miratim pranë Senatit Akademik të institucionit. Pas miratimit prej këtij të fundit Plani Masave, publikohet në faqen UV-ës dhe monitorohet zbatimi i tij prej Zv Rektorit, Dekanëve dhe NJSBCVI.</p> <p>https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2019/05/vendim-nr-17.pdf</p>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p>Bazuar në RVB, sikurse edhe në takimin që GVJ pati me përfaqësues të NJSBC, evidentoi se në rast të vlerësimeve negative, synohet shqyrtimi i tyre dhe marrja e masave për përmirësim.</p> <p>Synimi i vazhdueshëm i Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, është efektiviteti i veprimtarivë në kuadër të përmirësimit të cilësisë si edhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Tanimë ka nisur procedura me Urdhër të Rektorit Nr. 123 datë 19.12.2019.</p>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p>Në RVB theksohet se Institucioni organizon aktivitete dhe veprimtari periodike për informimin dhe ndërgjegjësimin për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë dhe që në këto veprimtari marin pjesë edhe përfaqësi nga studentët. Por GVJ, në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në vizitën në institucion nuk evidentoi ndonjë evidencë në lidhje me këtë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI			X	
---------------------------------------------------	--	--	---	--

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri Mekanike", "Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë."

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Eksperienca 13 vjeçare e UV në ofrimin e programit të studimit.
2. Stafi i kualifikuar akademik që ofron programin e studimit.
3. Sistemi menaxhimit UVMS.
4. UV ka ndërtuar struktura institucionale me përkushtim të lartë në drejtim të promovimit të programit të studimit.
5. UV ka realizuar marrëveshje me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit duke krijuar mundësi të mira mobiliteti për stafin akademik dhe studentët.
6. Në nivel rajonal ku mungon prezenca e Universiteteve me program të ngjashëm me "Bachelor në Inxhinieri Mekanike", si rrjedhim mund të përfitojë në tërheqjen e studentëve relativisht më të mirë me interes në këtë fushë.

Pika të dobta:

1. Baza e dobët laboratorike (mungesa hapësirash dhe laboratorësh për lëndët karakterizuese të programit).
2. Tendeca në rënie e hyrjeve në vitin e parë të programit studimeve.
3. Programi i studimit "Bachelor në Inxhinieri Mekanike" nuk ka vazhdimësi në ciklin e dytë të studimeve në UV.

Rekomandime:

1. UV duhet të shikojë mundësinë e investimeve në lidhje me ngritjen dhe forcimi bazës laboratorike për lëndët karakterizuese të programit.
2. UV duhet të tentojë rritjen e cilësisë së studentëve në hyrje të programit të studimit "Bachelor në Inxhinieri Mekanike".
3. UV duhet të gjejë mundësitë për kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik efektiv si një domosdoshmëri për rritjen e cilësisë në mësimdhënie.

Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle, Bachelor in "Mechanical Engineering" of the "Ismail Qemali" University, Vlorë"

Strengths and affirmations:

1. "University "Ismail Qemali" Vlorë" with 13 years of experience in providing the study program in the higher education.

2. Qualified academic staff offering his/her expertise in all the subjects of the study program.
3. UVMS management system.
4. UV has built institutional structures with high commitment in terms of promoting the study program.
5. UV has realized agreements with counterpart institutions inside and outside the country, creating good mobility opportunities for academic staff and students.
6. At the regional level where there is no presence of Universities with a program similar to the "Bachelor in Mechanical Engineering", as a result it can benefit in attracting relatively better students with interest in this field.

Weaknesses:

1. Weak laboratory base (lack of space and laboratories for the characteristic subjects of the program).
2. Declining trend of admissions in the first year of the study program.
3. The study program "Bachelor in Mechanical Engineering" has no continuity in the second cycle of study programs as Professional Master or Master of Science in this field at UV.

Recommendations:

1. UV should look at the possibility of investment in connection with the establishment and strengthening of the laboratory base for the characteristic subjects of the program.
2. Declining trend of admissions in the first year of the study program.
3. UV should find opportunities for further qualification of effective academic staff as a necessity for increasing the quality of teaching.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Pa përmbushje	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X

IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X